

# Shkrimtarët mbi Amerikën



15  
Refleksione



# Përmbajtja

fajqe 1

ELMAZ ABINADER

PAKSA LARG  
RRUGËS KRYESORE

*Kur isha e vogël, shtëpia ime kishte një derë magjike. Jashtë derës ndodhej qyteti i vogël i Pensilvanisë ku u rrita. Rruga Kryesore ndodhej përballë shtëpisë sonë me të gjitha tiparet e saj të qendrës së qytetit: një bankë, një stendë shtypi, një dyqan artikujsh shtëpiake, një dyqan për pjesë*

1

fajqe 10

SVEN BIRKERIS

FUQIA DETYRUESE E  
ËNDRRËS AMERIKANE

*Gjatë katër vjetëve të kaluara kam punuar me një memuar mbi periudhën e ardhjes sime në moshë, pika fillestare e të cilit ishte që të eksploroja se si një numër mundësish u bënë faktorë në ekuacionin e vjetër frojidian të dashurisë e të punës për të arritur në njëfarë kuptimi të pasionit*

3

fajqe 18

MAJKËLLSHABON

HARTA DHE LEGJENDA

*Në vitin 1969, kur isha gjashtë vjeç, prindërit e mi morën një kredi nga Administrata e Veteranëve dhe blenë një shtëpi me tri dhoma në një qytet imagjinar të quajtur Këlambia. Im atë, i lindur në Bruklin, pediatër në Shërbimin e Shëndetit Publik, para së gjithash ishte veteran i Rojës Bregdetare të Shteteve të*

5

fajqe 26

ROBERT KRILLI

AMERIKANI I AMERIKËS

*Megjithëse këtë poezi të pavdekshme e ka shkruar një anglez, ajo gjithësi është e tillë që mund të kishite pretenduar fare mirë për qytetarinë e nderit të SHBA për faktin se e mishëron qaq mirë ndjenjën kombëtare. «Ne jemi të fundit njerëz të parë» ka shkruar poeti Çarlz Olson në Astudimin e tij të ngjeshur Më Thirr*

7

fajqe 34

RIÇARD FORD

SI NDIKON TË QENËT  
AMERIKAN NË SHKRIMET  
E MIA?

*Sigurisht, kjo është një pyetje që më së pari rrotullohet rreth vetes, një gjëgjëzë letrare «pula-apo-veza.» Vetëm po ta shikojmë problemin më gjerë do të kuptohet se ku e kam fjalën: si ka ndikuar të qenët rus të Çehovi? Si ka ndikuar të qenët grua të Virxhia Ulfi?*

9

fajqe 5

XHULIA ALVAREZ

EDHE UNË I  
KËNDOJ AMERIKËS

*Unë nuk do të isha bërë kurrë shkrimtare në qoftë se familja ime nuk do të kishte emigruar në Shtetet e Bashkuara kur unë isha dhjetë vjeçe. E kalova fëmëninë në vitet 1950 në diktaturë, në një gjysmë ishulli të vogël në Republikën Dominikane. Megjithëse kultura jonë ishte një kulturë gojore mjaft e pasur*

2

fajqe 14

ROBERTOLEN BATLËR

«NJË KARTOLINË NGA  
AMERIKA»

*Kartolina e ilustruar ka lindur rreth nëntëdhjetë vjet më parë. Ajo është një fotografi origjinale e bërë nga një person me aparatit e saposhpikur Kodak Brownie dhe është stampuar në një copë kartoni të fortë me shpinë kartoline. Kjo ishte një praktikë e rëndomtë në Amerikën e fillimit*

4

fajqe 22

BILLI KOLINS

ÇKA AMERIKANE NË  
POEZINË AMERIKANE?

*Përpara se të shkoja në Angli disa vjet më parë për të bërë një cikël leximesh, unë kurrë nuk e kisha quajtur veten një poet veçanërisht amerikan. Turneun e organizova krejtësisht vetë dhe ai doli siç duhej. Në vargun e auditorëve të veçantë u përfshinë një klasë e gjashtë, një klub shazi në Brajton,*

6

fajqe 30

DEIVID IL DONALD

MBI TË QENIT  
HISTORIAN AMERIKAN

*Kur isha duke përfunduar biografinë time mbi Abraham Linkolnin, agjenti im letrar kontaktoi një sërë botuesish britanikë me synimin për ta botuar librin në Angli. Asnjëri nuk shprehu ndonjë interes të madh. Më në fund një nga shtëpitë botuese më me emër të Londrës pranoi që ta botonte librin,*

8

fajqe 38

LINDA HOGAN

PËR HIR TË JETËS

*Kam qenë një vajzë e ndrojtur, pa aspiruar kurrë për t'u bërë shkrimtare, pa menduar kurrë për të pohuar identitetin tim amtar, një identitet përherë i qartë kur motra ime dhe unë ndodheshim në Oklahomë me gjyshërit tanë nga fisi çikaso. Ne vijmë nga gjyshër-karrocierë dhe zanati i tyre vazhdoi deri vonë. Unë ende*

10

*faqe 42*

**MARK XHEKOBS**

**DY ANËT E KUFIRIT**

*Ekziston një lidhje e ngushtë mes të shkruarit dhe të qenët kokëngjeshur. Më kujtohet ndjesia e kënaqësisë që më pushtoi kur u zgjova nga ëndrra ime e parë trigjuhëshe. Kjo ndodhi pas kthimit nga Paraguaji, ku kisha kaluar dy vjet si vullnetar në Korpuset e Paqes duke jetuar në një fshat të izoluar ku mbillej*

11

*faqe 46*

**CARLZ XHONSON**

**NJË SHISHE QUMËSHTI AMERIKANE**

*Poshtë një globi të qelqtë në dhomën time të ndënjies ndodhet një kujtim nga historia e familjes sime katërshekullore në kontinentin e Amerikës së Veriut. Jam i sigurt se kushdo që e ka vizituar shtëpinë time duhet të ketë menduar se ai është një nga trashëgimet e eyera më të çuditshme, një copë e*

12

*faqe 50*

**BARATI MUKERNIH**

**MBI TË QENIT SHKRIMTAR AMERIKAN**

*Tregimin tim të parë e kam botuar në Kalkuta, kur isha adoleshente. Në të flitej për ditët e fundit të Napoleonit në Shën Helena. Ky tregim u pasua nga Mari Antoneta duke pritur gjyotinën dhe nga tregime të tjera që trajtonin figura nga historia romake. Këto «kallëza» të para qenë*

13

*faqe 54*

**NEJËMISHIBABNAI**

*KJO PATERICË QË DUA NË QENDËR TË SHITETEVE TË bashkuara, në mes të shekullit të 20-të, shumë njerëz kishin ardhur nga di-ku gjetkë dhe vrisnin mendjen se si t'i vinin gjërat në vijë. Kanadезët francezë kishin udhëtuar drejt jugut në St. Luis me një karrocë të madhe trapëllitëse të mbushur me fëmijë e triko. Një familje italiane*

14

*faqe 58*

**ROBERT PINSKI**

**NJË NDJESI PROVINCIALE PËR KOHËN**

*U rrita në një qytet të vogël, ku njëri nga gjyshërit e mi kishte një bar të mirënjohur përtej Bashkisë së Qytetit në të cilin politikanë e policë mbledheshin për të pirë. Kur isha dhjetë vjeç më kujtohet shefi i policisë së Long Brançit, një burrë që kishte qenë një nga punonjësit e gjyshit në*

15

15  
*Refleksione*

**Përmbajtja**

Ekipi Realizues

Kryeredaktor:

*George Clack*

Redaktor Përgjegjës:

*Paul Malamud*

Redaktorë Kontribues:

*Mark Jacobs, Michael Bandler*

Drejtor Artistik:

*Thaddeus A. Miksinski, Jr.*

Kërkues i Fotove:

*Maggie Sliker*

Përkthyes:

*Stavri Pone*

**Distributed by**

Public Affairs Section

Embassy of the United States of America

**Produced by**

Regional Program Office, Vienna

RPO 2003-166 Albanian

(Writers on America)

**Kreditet e Fotove**

Ballina: Clive Russ; Richard Howard; Bill Eichner – Bill Langford; Michael Nye; Juliet van Otteren – Red Diaz/Duende Publishing; Inye Wokoma/Colors NW Magazine; AP/Wide World – Diem Jones; Barry Fitzgerald; Me kortezinë e Jane Hogan – Penelope Creeley; Patricia Williams; Sigrid Estrada. Faqe 1: Diem Jones. 2: © 1997 Joe Sohm/Chromosohm. 5: Bill Eichner. 8–9: © Puzant Apkarian/Masterfile, (inset) IT Stock Int'l/eStock Photography/PictureQuest. 10: Richard Howard. 12: Robert Lackenbach/Time Pix. 14: Bill Langford. 16–17: © Universiteti i Shtetit të Floridës. 18: Patricia Williams. 20–21: © Roy Ooms/Masterfile, (inset, pas dritareve) © Ron Fehling/Masterlife. 22: Juliet van Otteren. 24: © Alan Schein/Corbisstockmarket.com. 26: Penelope Creeley. 28–29: Me



*Shkrimtarët mbi Amerikën*

kortezinë e Acton Historical Society – Mansell/TimePix; Biblioteka e Kolegjit Amherst; David Lees/TimePix; Mansell/TimePix. 30: Clive Russ. 32: © Gail Mooney/Masterfile. 34: J. Foley/Opale. 36–37: Vol. 9 Holidays & Celebrations PhotoDisc, (sfondi) Business & Occupation Photo Disc. 38: Me kortezinë e Jane Hogan. 40–41: Vol. 6 Nature, Wildlife & The Environment PhotoDisc (3). 42: Barry Fitzgerald. 44–45: (detaje të hartës) Vol. 14 Business & Transportation PhotoDisc; Vol. 5 Commerce & Travel PhotoDisc. 46: Inye Wokoma/ColorsNW Magazine. 48: Conceptual Still Life 2 Corbis CD. 50: AP Photo. 52–53: Courtesy Ballantine Books; Grove Press (2). 54: Michael Nye. 56: © Arts & Entertainment Disc Comstock Images. 58: Sigrid Estrada. 61: Business II Disc Comstock Images.



*Shkrimtarët mbi Amerikën*



# Hyrie

*Koha dhe hapësira nuk kanë të bëjnë – largësia nuk ka të bëjë,  
Unë jam me ju, burrat e gratë e një brezi, apo të shumë brezave,  
Ato që ndieni ju kur shikoni lumin e qiellin, ndiej edhe unë,  
Sikurse çdokush prej jush bën pjesë në turmën e gjallë, edhe unë  
kam qenë një nga turma,  
Siç çlodheni ju nga gëzimi i lumit dhe rrjedha e ndritshme,  
jam çlodhur edhe unë,  
Siç qëndroni e mbështeteni ju te parmakët dhe prapë nxitoni me  
rrymën e shpejtë, ashtu kam qëndruar e nxituar edhe unë,  
Siç shikoni ju direkët e panumërt të anijeve dhe oxhakët e trashë të  
avulloreve, ashtu i kam parë edhe unë.*

UOLLT UTTMAN, MARRË NGA «KALIMI ME TRAGETIN BRUKLIN,» 1856

Fillimi i këtij libri mori shkas nga një sugjerim interesant që bëri Mark Xhekobsi, nëpunës i shërbimit të jashtëm të SHBA në stafin tonë të Departamentit të Shtetit, i cili është njëherazi edhe romancier. Xhekobsi propozoi se sikur të pyesnim një grup poetësh, romancierësh, kritikësh e historianësh bashkëkohorë se ç’do të thotë të jesh shkrimtar amerikan, rezultatet do të nxirrnin në pah, në mënyrë interesante, një sërë vlerash amerikane – lirinë, larminë dhe demokracinë – të cilat mund të mos kuptohen si duhet në pjesët e tjera të botës.

Gjithçka që bëme, e bëme në frymën e një eksperimenti. Pasi përzgjedhëm 15 shkrimtarë që kanë arritur një status të caktuar në krijimtarinë e tyre, një grup që në tërësi pasqyron larminë e krijimeve të sotme letrare në Amerikë, porositem secilin që të shkruante një ese. Tema ishte: në ç’kuptim e shikoni ju veten si shkrimtar amerikan?

Në njëfarë mënyre, kjo metodë evokon një traditë të gjatë letrare të vetanalizës në Shtetet e Bashkuara. Mishel Gijom St. Xhin dë Krevkori ka mbetur i famshëm për pyetjen që ka shtruar në «*Letra nga një Fermer Amerikan*» (1782): «Pra ç’është amerikani, ky njeri i ri?» Më 1837, në fjalimin e tij «*Dijetari Amerikan*», Ralf Ualdo Emersoni bënte thirrje për një pavarësi intelektuale «nga muzat oborrtare të Evropës». Një shekull më vonë, Ernest Heminguei do ta

përkufizonte letërsinë amerikane me fjalët: «E gjithë letërsia moderne amerikane buron nga një libër i Mark Tuejnit, *Hakëlberi Fin.*» Në një kuptim, çdo autori i kërkuam që ta aktualizonte përgjigjen për pyetjen e Krevkorit në përshtatje me shekullin e 21-të.

Gjëja e parë që bie në sy lidhur me përgjigjet është larminia e madhe e tyre në këto ese. E parë në prizmin e këndvështrimeve të këtyre shkrimtarëve, Amerika nuk është një vend, por shumë. Ndofta nuk është për t’u habitur që përvoja «amerikane» e një njeriu ka të ngjarë të jetë krejt e ndryshme nga ajo e një tjetri. Nëse u bën të njëjtën pyetje 15 individualiteve krijuese të ndryshme, është e natyrshme të marrësh 15 përgjigje të ndryshme.

Megjithatë, në një shikim të dytë, në të gjitha esetë vihen re një sërë fijesh të përbashkëta. Së pari, karrierat e krijimtarisë së secilit i kanë rrënjët në kujtimet e gjalla të fëminisë së hershme, në një vend e kohë të caktuar, në një fshat apo fermë të vogël a në lagjen e një qyteti. «E gjitha politika është vendore» ka thënë dikur Tip O’Neill, ish-kryetar i Dhomës së Përfaqësuesve të SHBA. Shkrimtarët tanë do ta modifikonin kështu këtë shprehje: Gjithçka fillon te shtëpia. Për Elmaz Abinaderin shtëpia është aroma e bukës arabe që pjek nëna e saj në një qytet të vogël të Pensilvanisë. Për Robert Pinski janë historitë e dëgjua në fëmijëri në një vend pushimi buzë oqeanit në Nju Xhërsi. Majkëll Shaboni e gjen magjinë e rinisë në emrat e çuditshëm të qytetit me planimetri të re në të cilin u rrit. Historiani Deivid Herbert Donald i gjen vendin e tij si shkrimtar në traditat familjare të rrëfenjave të Jugut të Amerikës në fëmininë e tij.

Për këtë grup shkrimtarësh ndjenja e shtëpisë shpesh nënkupton një kulturë imigrantësh ku njëri prind apo gjysh është nga një vend tjetër. Rëndom ndodhin martesat e përzierat që bashkojnë fe apo etni të ndryshme në një familje për brezat e mëpasëm. Për imigrantin me rrënjë ende të reja duket se ekzistojnë dy rite kalimi: së pari, pranimi i dëshirës për t’u përfshirë në rrjedhën qendrore të Amerikës dhe pranimi i dallimeve të saj dhe së dyti, zbulimi i integri-

tetit të kulturës së vetë individit. Memuari i shkrimtarit Sven Birkerts është një përsiatje e zgjeruar mbi dalldisjen e tij rinore dhe tejet subkonshiente për Amerikën e Miduestit, e pasuar nga rizbulimi i trashëgimisë së tij letoneze në letërsinë e Evropës. Tregimi i Xhulia Alvarezit për udhëtimin e saj të gjatë nga diktatura dominikane në lirinë amerikane arrin kulmin në një këngë dykulturore ku në të njëjtën poezi përzihen spanjishtja dhe anglishtja.

Për shumë nga këta shkrimtarë, kryefjala për Amerikën është *e mundshmjia*. «Çdo gjë është e mundshme në Shtetet e Bashkuara,» shkruan Nejemi Shihab Nai për ndjenjat e të atit të saj palestinez për vendin e tij të adoptimit. «Kjo nuk ishte thjesht një fjalë në erë, por diçka e vërtetë. Ai nuk mund të pasurohej brenda natës, por mund të shiste siguracione, të importonte dhurata shumëngjyrëshe nga bota, të hapte dyqane të vogla dhe të bëhej gazetar. Ai mund të bënte çdo gjë.

Në të njëjtën kohë, autorët tanë pranojnë se shoqëria amerikane nuk ka qenë e përsosur dhe është larg së qeni e tillë. Abinaderi dhe Alvarezit nuk i harruan kurrë epitetet që përdornin për to shokët dhe shoqet e klasës në vitet e shkollës, paraardhësit imigrantë të të cilëve kishin ardhur prej kohe. Edhe pas tridhjetë e pesë vjetësh që nga lindja e qytetit Këlambia në Merilend, streha e feminisë së Shabonit, një qytet i themeluar pjesërisht si eksperiment i jetesës mes racash të ndryshme, thuhet se ende ka trazira «krimesh e konfliktesh racore.» Poetesa indiane Linda Hogan e përjeton thellë historinë e trishtuar të popullit të saj në duart e evropianëve që e kolonizuan këtë vend.

Megjithatë, thujse për të gjithë shkrimtarët e këtij libri e vërteta më e madhe për Amerikën do të përmbliidhej në besimin e xhaxhait të babait të romancierit afro-amerikan Çarlz Xhonson. I lindur në jugun rural më 1892, xhaxhai i madh i Xhonsonit, Uilli, u shpërngul në veri ku themeloi e administroi një sërë biznesesh duke predikuar pa reshtur vlerën e arsimit. Xhonsoni shkruan se «ai e kuptonte, dhe, përmes shembullit të tij vetjak, na bënte edhe neve të kuptonim se megjithëse zezakët kishin përjetuar shtypje të tmerrshme, Amerika ishte themeluar mbi parime, ideale e dokumente... që e detyronin atë që të bëhej një vetëkorrigjuese e përhershme. Ai e dinte se ajo ishte trualli që i rriti zezakët amerikanë. Mundësitë që iu mohuan atij tashmë do të ekzistonin për ne, thoshte ai. Por vetëm nëse ne do të arsimoheshim dhe do të ishim punëtorë të palodhur.»

Një tipar tjetër i përbashkët për grupin tonë të shkrimtarëve është kalimi përtej përvojave dhe bashkësive të tyre – madje përtej amerikanizmit të tyre – te një ndjenjë e fuqishme për të gjithëmbarrshmen. Barati Mukerxhi i quan shkrimtarët kudo që janë si «fis i një mendësie. Në rrafshin ndërkombëtar unë kam ndeshur shkrimtarë seriozë universalisht skeptikë ndaj autoritetit, ironikë e dashamirës ndaj të humburve e të hutuarve. Ata vëzhgojnë me kënaqësi kontradiktoren dhe absurden; ata nuk vonojnë të vlerësojnë veprën e tjetrit dhe të njohin forcat e ndryshme që e plazmojnë atë.»

Riçard Fordi përfytyron një shkrimtar të ri të panjohur në një vend të largët që është duke vlarë mendjen se ç’do të thotë të jesh shkrimtar. Fordi thotë: «Ai shkruan të njëjtat gjëra që kam shkruar edhe unë, ose më të mira. Bukur, them unë. Sepse në qoftë se të gjitha këto vite të të qenit amerikan më kanë përgatitur mua që të kuptoj se shembëlltyra ime, fafërsnia ime, kolegjaliteti im bashkë me dikë që unë nuk do ta njoh kurrë më kanë bërë të aftë që të përjetoj urtësinë më të çmuar të letërsisë – atëherë të qenit amerikan, dhe jo më pak shkrimtar, më kanë shërbyer vërtet mirë.»

Zëri që duket se ndodhet në sipërfaqen e shumë prej këtyre eseve është ai i poetit të madh amerikan Uollt Uitman (1819–1892). Poetët Robert Krili dhe Billi Kolins përmendin ndikimin e Uitmanit; Xhulia Alvarezit e përfundon esenë e saj duke shpërthyer në poezi me fjalët «Edhe unë i këndoj Amerikës», një aluzion ndaj vargut të paharruar të Uitmanit «Dëgjoj Amerikën duke kënduar.» Pak e kanë lidhur njëshin – shpirtin e individit – me shumicën, me shpirtin e të gjithë amerikanëve dhe të njerëzimit, me më shumë ngazëllim se Uitmani.

Romancieri Robert Olen Batlër e mbyll esenë e tij duke evokuar një lidhje që Uitmani e kishte ndër thellë. «Artistët e të gjitha vendeve të botës kalojnë çdo ditë përmes së pavetëdijshmes vetjake dhe hyjnë në thellësitë e së pavetëdijshmes kolektive,» shkruan Batlëri, «dhe këta artistë shfaqen me vizione të gjërave që na lidhin të gjithëve së bashku. Unë jam amerikan. Unë jam artist. Unë e mbaj shikimin te vendi im dhe kërkoj shpirtin njerëzor.» ■

— GEORGE CLACK,  
KRYEREDAKTOR





# Abimader



## **I. DUKE KAPËRCYER PRAGUN**

Kur isha e vogël, shtëpia ime kishte një derë magjike. Jashtë derës ndodhej qyteti i vogël i Pensilvanisë ku u rrita. Rruga Kryesore ndodhej përballë shtëpisë sonë me të gjitha tiparet e saj të qendrës së qytetit: një bankë, një stendë shtypi, një dyqan artikujsh shtëpiakë, një dyqan për pjesë

këmbimi automjetesh si dhe dyqane të tjera të shitjes me pakicë. Familjet shëtitnin nëpër rrugë, veçanërisht në fundjavë, duke parë mobiljet në vetrinën gjigante të Kaufmanit, afishet e filmave të vendosura prapa xhamit në kinemanë Reks si dhe manekinat pa duar apo gishta që ekspozonin veshjet e modës më të fundit në vetrinat dyqanit të rrobave të tezes sime. Në ato ditë të fillimit të viteve 1960, biznesi i vogël në një qytet si Mesëntauni plotësonte nevojat e bashkësisë për ushqime, veshje e strehim.

Edhe dyqanet e familjes sime ndodheshin në Rrugën Kryesore: Dyqani i Këpucëve Nader, Supermarketi Nader, Restoranti Modërneër. Në pamjen e jashtme bizneset tona dukeshin si gjithë të tjerët, por ne i plotësonim më së miri kërkesat e nënave të qytetit për këpucë fëmijësh të denja për në kishë, të baballarëve për puro të mira e gazeta dhe të rinjve që kërcenin në restorant, pranë xhukboksit, pas daljes nga shkolla. Im atë e im ungj rrinin në dyert e lokaleve të tyre të veshur mirë, me kostume bojëhiri, këmbisha të bardha e këpucë të lustruara.

Në ato çaste, duke qëndruar në prag të dyqanit me shikimin brenda tij unë nuk vija re ndonjë ndryshim mes tim

eti, tim ungj dhe njerëzve që kalonin aty pranë. Edhe shumë prej tyre i çonin fëmijët te Znj. Dafi për mësim pianoje, bënin pazar në A&P dhe më 4 Korrik piqnin mish në skarë në oborrin e pasëm. Shumë nga klientët e tim eti i çonin fëmijët në shkollën «Të Gjithë Shenjtorët» ku shkoja edhe unë. Vajzat e tyre kishin biçikleta të shkëlqyera me fjongo të lidhura te timoni. Vajzat më popullore, Xheni dhe Reni, vishnin çdo ditë këpucë të lustruara «Mary Jane» dhe diskutonin gjallërisht për koleksionet e tyre me kukulla Barbie që vinin duke u pasuruar. Unë dëgjoja si e magjepsur bisedat e tyre për një shtëpi për kukullën, për veturën dhe gardërobën e saj. Teksa përshkruante fustanin e ballos të Barbie-t, Xheni përdridhte në gisht një cullufe nga flokët e saj biondë bishtkali, kurse Reni, teksa na tregonte fotografitë nga udhëtimi i saj në Virxhinia Bijç, tërhiqte kaçurrelin dhe e bënte në formë C-je.

Në këto çaste të bisedave shoqërore, iluzioni i ngjashmërisë mes meje dhe vajzave të klasës sime fluturonte e pëlciste si fluskë. Megjithëse kisha të njëjtën uniformë shkollore me to, shkoja në të njëjtin grup të vajzave skaute, këndoja soprano në kor dhe isha e mirë në diktim, jeta ime dhe e tyre ndahej nga një derë magjike. Ndonëse shoqet e mia të klasës nuk e dinin se çfarë ndodhej prapa asaj dere, ato më rrethonin në sheshin e lojës dhe u thërrisnin «zeza-ke» gërshetave të mia duke u përpjekur që t'i shturnin, ose «majmunë» krahëve të mi me qime të errëta në lëkurën ngjyrë ulliri të zbehtë. Kjo më shkaktonte marramendje dhe stomaku më hidhej si ketër.

Atë ditë u çapita gjer në shtëpinë time me dërrasa bojëhiri në Rrugën Kryesore duke ndier peshën e çantës së librave dhe rëndesën e dallimeve mes meje e vajzave që hidheshin në litar përtej rrugës. Kur tërhoqa dorezën e alumintë ngjyrë argjendi të derës me rrjetë që të çonte në korridorin e shtëpisë, gishti i madh m'u bë me ndryshk. Kjo derë nuk kishte asgjë të veçantë që mund të kënaqte syrin, por kur hyra brenda, konteksti i botës ndryshoi.

Teksa kaloja nëpër korridor për në kuzhinë ndjeva të më tërhiqte një nga aromat e mia të parapëlqyera. Ishte e mërkurë, dita e javës kur mamaja e mbulonte me gazeta trye-

zën e madhe për tetë vetë, merrte dy kuti bojëqielli nga dollapi dhe gatiste fletët metalike të pjekjes së biskotave. Qysh kur hyra në shtëpi ndjeva aromën e bukës arabe dhe në tryezë pashë një mori rrotullamesh të fryra, të vendoura rresht njëra pranë tjetrës. Mamaja bënte trekëndsha me spinaq, role me kanellë dhe byrekë të mbushur me dardha të këputura nga pemët që ndodheshin në oborrin tonë. Përpara se të më përshëndeste, ajo ngriti sytë, ktheu nga unë fytyrën e lyer me miell e tha: «Janë 68 copë. Mund të marrësh një.»

Pranë meje erdhën motrat e mia dhe ne i kalonim shoqashoqes kutinë e marmelatës së mollës për të lyer copat e ngrohta të bukës. Kur del nga furra, buka arabe e mbushur me ajër duket si jastëk; kur ftohet, ulet e bëhet pak a shumë si ajo që amerikanët e quajnë «pite». Bukë tjetër rrallë hahej në shtëpinë tonë; edhe kur vinim salsiçe në skarë i futnim në gjysma buke «kohbe» dhe i lyenim me keçap.

Aroma ishte gjumëndjellëse dhe e zbuti melankolinë që kisha sjellë në shtëpi bashkë me mësimet që duhet të bëja atë natë. Hareja jonë mori fund shpejt pas darkës. Të gjithë ne gjashtë fëmijët kishim punë shtëpie. Tre vëllezërit shkonin në dyqan për të pastruar e rregulluar mallrat, kurse ne tri vajzat ndanim detyrat e punëve të shtëpisë e të kopshtit. Në verë hiqnim barishtet e këqija, ujtnim e mblidhnim perimet; në vjeshtë hynim në bodrum ku bënim konservimin e frutave, fasuleve, marmelatës dhe turshive. Ndërmjet këtyre sezoneve lanim pirqje me tesha, hekurosanim e mbanim pastër nëntë persona që mbushnin shtëpinë tonë të vogël. Kukullat Barbie, fletoret e ngjyrosjes apo sportet pas shkollës ishin botë që u përkisnin fëmijëve të tjerë, jo neve.

Prapa derës magjike edhe gjuha ndryshonte. Urdhrat e mamasë për ne vajzat jepeshin në arabisht, kurse detyrat e shtëpisë, bisedat dhe lutjet bëheshin në anglishten më të





saktë të mundshme. Tri gjëra sundonin në jetën tonë: për-kushtimi ndaj Zotit, bindja ndaj prindërve dhe notat e mira në shkollë. Një gabim i vockël në secilën nga këto fusha ndëshkohej menjëherë dhe ashpër. Reputacioni i familjes sonë mbështetej te përsosmëria dhe prindërit e mi nuk e kishin fare idenë se vajzat e tyre, që luftonin për arritjen e përsosmërisë, ishin objekte talljesh të pakëndshme nga shoqet e tyre.

Ndërveprimet tona shoqërore nga ana tjetër e derës peshonin shumë pak brenda shtëpisë. Ne kishim një bashkësi tjetër, pjesëtarët e së cilës mblidheshin në fundjavë dhe gjatë verës. Kushërinjtë nga qytetet nëpër Pensilvani e Ohaio mbushnin dhomën tonë të ndënjies e të ngrënies të ulur rreth tryezës plot me gatime arabe përralore: *hummus* (pure qiqrash), salcë me fasule dhe pulë, *baba ghanouj*, patëllxhane me susam, japrak me gjethe hardhie, shishqebap, *kibbee*, mish qengji i gjallë ose i skuqur, byreçka me bollgur gruri, kofshë qengji, gjel deti i mbushur me oriz e stafidhe si dhe plot garnitura në pjatanca. Buka e famshme arabe ngrihej kapicë nëpër pjata në anët e tryezës.

Pasi prifti, im ungj, bekonte tryezën, fillonin bisedat në arabisht ndërsa kushërinjtë ngjyenin bukën, ngjeronin sallatën *tabouleh* dhe shijonin me lezet bakllavanë. Kur darka vinte në të mbaruar, ne largoheshim paksa nga tryeza me pjata të zbrazura dhe im atë ia niste një historie për ditët e dikurshme; dikush lexonte ndonjë letër nga Libani; një tjetër ndizte një debat politik.

Ne vajzat ngrinin tryezën dhe nga gramafoni kumbonte muzika arabe. Shpejt dikush ia merrte një valleje në të cilën bashkoheshin të tjerë duke përplasur këmbë e duar sa buçiste shtëpia. Si fëmijë të papërtuar që ishim, ne nuk reshtnim së punuari, lanim pjatat apo u çonim të rriturve ndonjë gjë që donin apo qëndronim në këmbë dhe ata na nduknin faqet ose na ngrinin në ajër.

Këto skena familjare më mbushnin me gëzim dhe me ndjenjën e përkatësisë dhe e dija se për to nuk duhej të bëja kurrë fjalë në anën tjetër të derës. Ndryshe, avazi i sharjeve në oborrin e shkollës do të shtohej. Pamja ime e ndryshme mjaftonte për to; pasja e një babai me aksent të rëndë më nxirrte më në pah, kurse kërcimet në formë rrethi do të më damkosnin si të papranueshme nga shoqëria.

## II. RRUGA IMESISHKRIMTARE

Kur hyra në kolegji, një shkollë që kishte njëqind herë më shumë njerëz se qyteti im amtar, rrugën nëpër mjediset e tij e bëra si e magjepsur. Pasi kalova përbri rreshtit të drurëve ginko, hyra në Katedralen e Dijes në shumëkatëshin e Universitetit të Pitsburgut ku ndodhej Katedra e Anglishtes. Në katin e parë të kësaj ndërtese të bukur janë Klasat e Kombësive. Në bazë të dizenjove, destinacioni i këtyre dhomave ishte që të përfaqësonin nocione të ndryshme kulturore. Dhoma e Anglishtes i kishte bankat si ato të Dhomës së Përfaqësuesve, Dhoma e Hungarishtes përfaqësohej nga panele në ngjyrë speci me dizenjo lulesh të montuara në mur, kurse Dhoma e Kinezçes, që i kushtohej

Konfucit, lejonte që nxënësit të uleshin në tryeza të rumbullakëta pa kurrfarë hierarkie. Në këto mjedise bëmë disa mësim, shpesh të pakënaqur për shkak të rreptësisë së orendive ose të kujdesit që duhej të tregonim për pajisjet. Dhoma jonë mbyllej me çelës dhe atje mund të hyje vetëm me leje ose kur kishte vizitorë. Unë shikoja pllakëzën jashtë derës: *Dhoma Siriano-Libaneze*. Përsëri kisha të bëja me një derë që ndante botën e jashtme «amerikane» nga bota ime. E bëra si zakon që të hyja në dhomë duke ftuar shoqet e mia.

Në çastin kur hymë së pari, ngrimë në vend. Dhoma ishte shtruar me qilima me motive persiane dhe ishte pajisur me drita shumëngjyrëshe, tryeza bronzi dhe shilte të mbështetura në muret rreth e qark. Ajo dukej e stolisur dhe ekzotike dhe befas krenaria e të qenit e lidhur me këtë pallat zuri vend brenda meje. Përgjegjëse për identitetin tim në kolegji, unë e bëja të njohur prejardhjen time, shkruaja për gjyshen time, gatujta ushqime arabe për shoqet dhe shokët e mi dhe luaja muzikën e Oum Kaltumit kur ata mblidheshin në shtëpinë time.

Shumë shpejt kuptova se ekspozimi i arabizmit tim po shërbente për të më ekzotizuar. Në program nuk përfshihej asgjë nga letërsia arabe; në televizion, i vetmi njeri i lidhur me Libanin ishte Deni Tomas; kurse *Lawrence of Arabia* u përdor si sinonim për kulturën time. Njëherazi, ngjarjet në Lindjen e Mesme treguan qartë se në Shtetet e Bashkuara simpatitë nuk ishin proarabe dhe ndërsa unë rritesha, ndjenjat ndaj arabëve u bënë më negative e nganjëherë arrinin në mosbesim edhe te kolegjet e mi.

Unë nuk reshtja së shkruari. Herë një vjershë për nënën që ikte nga Libani për të ndërtuar një shtëpi në Shtetet e Bashkuara, herë një tregim për gjyshin që jetoi si refugjat gjatë Luftës së Parë Botërore; kurse aventurari e tim eti si tregtar gome në Brazil, kur kishte qenë i ri, u bënë temat e mia dhe këto tregime e vjersha i shpalosja intuitivisht, a thua se e gjithë historia që tregoja në to të kishte qenë e ndrydhur brenda meje si në një shishe.

**P**or krijimtaria ime kryhej *brenda* derës. Jashtë saj, në klasë, në programin tim të Bakalaureatit dhe të Masterit disa vjet më vonë, letërsia që lexoja ishte po aq e huaj për ndjeshmërinë time të natyrshme sa edhe kullat Barbie në mjedisin e fëminisë. Si modele shkrimtarësh merreshin një numër i konsiderueshëm autorësh meshkuj të identifikuar si evropianë që shkruanin me elokucencë për rrjedhën qendrore të kulturës amerikane. Kurse në qoshen e botës, ku unë krijoja, hidhja në letër ngjarje mbi fëmijët që kishin vdekur gjatë rrethimit të një fshati nga turqit otomanë në Liban. Në poezinë time ndihej një muzikë që tingëllonte e çuditshme për veshët e amerikanëve; imazhet e mia formonin një armaç të shndritshëm detajesh dhe ishin më të harlisura se ato që gjendeshin në krijimet e tjera të viteve 1970.

Jashtë derës nuk e ndjeva veten të mirëpritur.

Por nuk hoqa dorë. Në një nga udhëtimet e mia më ra në dorë një libër që ndryshoi shumë gjëra. Në fillim më tërhoqi titulli, *Gruaja Luftëtare*, kurse autori kishte një emër jo të zakonshëm: *Maksin Hong Kingston*. Brenda këtij libri ndesha një gjyshe që tregonte rrëfenja, bija që ishin më amerikane nga ç'do t'i donin familjet e tyre; një kulturë krejtësisht të huaj për njerëzit rrotull këtyre familjeve. Në thelb kjo shkrimtare e dinte se çfarë fshihej prapa derës dhe shkroi për të. Ky libër jo vetëm më bëri të njihesha me korpusin e letërsisë së lëvruar sipas kanunit kinezo-amerikan, por edhe të njihesha me shkrimtarë afro-amerikanë, hispanikë, amerikanë autoktonë, zërat e të cilëve u bënë jehonë të njëjtave tema: përkatësisë, identitetit, vetmisë kulturore, bashkësisë dhe ekzotizimit.

Tingujt e muzikës sime vërshonin në të çarat dhe fute-shin poshtë pragut dhe harbimi i vallzimit të tyre e shtynte derën krejt ndryshe nga e zakonshmjat. Kam dëgjuar se si Toni Morrisoni iu përgjigj një pyetjeje në një intervistë: «Ju shkruani për shkak të racizmit?» Ajo: «Unë shkruaj *paçarësisht* nga racizmi.» Shkrimtarët po e afirmonin vendin e tyre jo vetëm në letërsi, por edhe në perceptimin e historisë.

Për mua, pjesëmarrja aktive në veprimtari ka qenë pjesë e rëndësishme e qenies sime qytetare e Shteteve të Bashkuara. Vitet e mia mbajnë vulën e çështjeve politike për të cilat unë kam marshuar, protestuar, nënshkruar peticione, organizuar komitete. Tani kam filluar të kuptoj: si shkrimtare kam qenë edhe aktiviste. Tregimi i një historie interesante, shkrimi i një poezie të bukur krijojnë të lexuesi mbresa më të thella se çfarëdo shkrimi retorik.

Përveç kësaj, unë gjeta një bashkësi. Shkrimtarët dhe artistët amerikanë me ngjyrë shpesh përshkojnë të njëjtin terren si dhe unë, jetojnë në një botë shpirtërore të dyfish-të, japin e marrin atje ku kultura, së cilës unë i përkas, konfliktin me kulturën tjetër që është po imja duke kërkuar një vend që të jetë mikpritës për të gjithë ne.

Për arabo-amerikanët kohët kanë qenë të mbushura me sfida për arsye se vendet tona të origjinës shpesh kanë qenë të përfshira në konflikte e kundërshtitë politike. Sa më të vështira të bëhen gjërat, aq më shumë rritet roli që mund të luajë *tregimi im interesant dhe poezia ime e bukur* në perspektivën e ngjarjeve dhe të njerëzve. Përgjithësisht lexuesit i besojnë më shumë letërsisë se fjalimeve e artikujve dhe unë vë re se dashuria ime për të shkruar është e ndërthurur me përgjegjësinë për të shkruar.

Unë jam pjesë e një qyteti të ri të vogël. Ai nuk ndodhet posaçërisht diku, apo ndofta gjendet kudo. Në këtë qytezë njerëzit jetojnë me dyert të hapura, duke lëvizur para- mbrapa mbi pragun e asaj që dikur ishte përjashtuese dhe që një ditë mund të bëhet përfshirëse. Si shkrimtare, unë e kumtoj dhe e end jetën time në stofën e letërsisë. Si aktiviste shikoj me shpresë shkrimtarë të tjerë të rinj me ngjyrë dhe u bëj të ditur se ata mund t'i mbështetin shpatullat e tyre në atë derë, të rëndojnë në të me gjithë trupin e tyre dhe nëse e shtynë atë derë, ajo dikur do të hapet. ■

**E**lmaz Abinader është autore arabo-amerikane, poete dhe artiste skene, krijimtaria e së cilës është botuar dhe ekzekutuar në Shtetet e Bashkuara dhe në Lindjen e Mesme. Vëllimi i saj më i fundit, *Në Vendin e Ëndrrave të Mia... fitoi Çmimin 2000 Josephine Miles PEN Oakland për poezinë multikulturore. Drama e saj e parë, Vendi i Origjinës, ka fituar dy çmime «Drammies» në Rrethin e Dramës së Oregonit, kurse tani ajo është duke bërë një turne me pjesën e saj të dytë teatrale, Hëna e Ramazanit. Vepra e saj Fëmijët e Ruxhmes: Shtegtimi i një Familjeje nga Libani, libri i saj i parë (Norton, 1991; University of Wisconsin, 1997), është një memuar mjaft i suksesshëm që bën fjalë për emigracionin e një familjeje. Sot është pedagoge në kolegjin Mills, Ouklënd, Kaliforni.*

*Pas marrjes së gradës M.F.A (Mjeshtre e Arteve të Bukura) në poezi nga Universiteti Këlambia, ku studioi me Filip Levinin, dhe pasi mori gradën Ph.D. (Doktorë e Filozofisë) në Krijimtarinë Letrare, Abinaderi fitoi një bursë pasuniversitare në shkencat shoqërore dhe punoi me romancieren Toni Morrison për veprën Fëmijët e Ruxhmes. Në fillim të karrierës së saj si shkrimtare fitoi një çmim nga Akademia e Poetëve Amerikanë. Kohët e fundit ka qenë në Egjipt si studiuese shkencore me bursën Fulbright.*

*Për herë të parë poezia e saj u botua në vëllimin Gjethe Hardhie, Poezia Arabo-Amerikane gjatë një Shekulli, redaktuar nga Gregori Orfalea dhe Sharif Elmusa (University of Utah Press, 1988). Ajo ka vënë në skenë një sërë veprash të porositura: dy që përkujtojnë njëqindvjetorin e Gibran Khalil Gibranit dhe një tjetër për nder të veprës së muzikantit Marsel Khalife. Shumë nga veprat e saj janë përfshirë nëpër antologji.*

*Si mësuese e krijimtarisë letrare gjatë shumë vjetëve, Elmaz Abinader i është kushtuar krijimtarisë së shkrimtarëve të rinj me ngjyrë, veçanërisht falë pjesëmarrjes së saj në Hurston-Wright Writers' Week West dhe The Voice of Our Nations Arts Foundation.*





# Alvareza Xhulia



Unë nuk do të isha bërë kurrë shkrimtare në qoftë se familja ime nuk do të kishte emigruar në Shtetet e Bashkuara kur unë isha dhjetë vjeçe.

E kalova fëmëminë në vitet 1950 në diktaturë, në një gjysmë ishulli të vogël në Republikën Dominikane. Megjithëse kultura jonë ishte një kulturë gojore mjaft e pasur në rrefenja, prapë nuk ishte kulturë letrare. Unë u

rrita mes njerëzish që leximin e quanin një veprimtari anti-shoqërore, të tillë që mund të dëmtonte shëndetin dhe të hiqte kënaqësinë e të jetuarit.

Leximi/studimi nuk ishte një veprimtari që nxitej në familjen tonë, sidomos për ne vajzat. Gjyshja ime kishte mbaruar vetëm klasën e katërt dhe na tregonte se e merrte librin në dorë vetëm kur dëgjonte gomarin e mësuesit duke pallur tekta si ngjitej kodrës për në shtëpinë e saj.

Djemtë duhej të bënin *sacrificio* dhe të shkolloheshin për të fituar jetesën – por me masë. Tim kushëri e quanin të çuditshëm sepse ai jo vetëm që e dashuronte leximin, por edhe shkruante poezi në moshë adoleshente. «*Se va a enfermar,*» thoshte tezja ime duke tundur kokën sa herë që e gjente Huanin të ulur në karrige duke lexuar ndonjë libër. «Ai do të sëmuret.»

Por unë po rritesha edhe në një diktaturë shtypëse e të rrezikshme. Në një orë mësimi të shkencave shoqërore, një nxënës shkroi një ese në të cilën ai lëvdonte Truhillon, diktatorin, si babanë e vërtetë të vendit tonë. Mësuesi komentoi se sigurisht Truhilloja ishte një ndër etërit e vendit tonë, por kishte dhe të tjerë. Kur qe kthyer në shtëpi, djali, biri i

një gjenerali, duhet t'ia kishte treguar ndodhinë të atit. Atë natë mësuesi, e shoqja dhe dy fëmijët e tyre të vegjël u zhdukën. Intelektualët, njerëzit që lexonin dhe bënin pyetje, ishin të dyshuar. Edhe një libër në dorën e dikujt mund të quhej i jashtëligjshëm.

Në vitin 1960 u zbuluan veprimtaritë klandestine të tim eti kundër Truhillos dhe ne u detyruam të arratiseshim me nxitim nga vendi. Sapo vumë këmbë në truallin amerikan, u bëmë «spics», njerëz që e flisnin anglishten me akcent të rëndë, imigrantë pa para apo perspektivë. Brenda natës kishim humbur gjithçka, vendin, shtëpinë, familjen tonë të madhe, gjuhën tonë, pasi spanjishtja ishte gjuha jonë amtare, gjuha e la *familia*-s, e të kuptuarit tonë. Ne mbërritëm në Shtetet e Bashkuara në një kohë të historisë që ishte jo shumë mikpritëse për njerëzit që ishin të ndryshëm, lëkura e të cilëve kishte një ngjyrë tjetër, gjuha e të cilëve nuk tingëllonte si anglishtja. Për herë të parë në jetën time përjetova paragjykimet dhe keqtrajtimet në sheshin e lojës. Unë rropatesha me një gjuhë e kulturë që nuk i kuptoja. Isha e përmallur për vendin dhe zemrën e kisha të vrarë.

Si të reja që ishim, motrat e mia dhe unë u mobilizuam shpejt për t'i përballuar sfidat. Mësuam gjuhën e re, muzikën e re, mënyrat e reja të veshjes dhe gjithmonë silleshim mirë. Por sukseset tona në këto drejtime shpejt krijuan një lloj problemi të ri në familjen tonë. Familja jonë donte të na mbante me çdo kusht brenda standardeve të vjetra, por njëherazi donte edhe që ne të përparonim në këtë kulturë të re. Po si mund të mësonim ne për t'i marrë të gjitha notat «A», si mund të përparonim duke qëndruar kokulura e të bindura dhe Babi t'i merrte të gjitha vendimet? Si mund ta mbanim mend spanjishten kur qemë të detyruara të flisnim vetëm anglisht jashtë shtëpisë? Si mund ta mbanim gojën të mbyllur për shkak të *respeto*-s për prindërit kur në shkollë na mësonin që ta hapnim gojën dhe të debatnim me mësuesit nëse ishte nevoja? Si mund të shkonim mirë me shoqet tona pa shkuar kurrë në shtëpitë e tyre për festa, apo për të fjetur, vetëm sepse ato mund të kishin vëllezër më të mëdhenj apo prindër që i lejonin disa gjëra që prindërit tanë nuk i lejonin?

Motrat e mia dhe unë kishim ngecur mes dy botësh, dy sisteme vlerash, gjuhësh e zakonesh. Kjo ishte sfida jonë, një sfidë për shumë nga imigrantët në një botë të re e të ndryshme nga bota jonë e fëminisë: si të ruajmë lidhjen me traditat tona, rrënjët tona, por edhe të rritemi e të lulëzojmë në vendin tonë të ri? Si të gjejmë rrugë krijuese për të kombinuar botët tona të ndryshme, vlerat, pjesët tona konfliktuese e nganjëherë ndërlyftuese në veten tonë në mënyrë që të bëhemi qenie njerëzore më të gjera, jo më të ngushtuara?

Por problemi ishte se në atë kohë askush nuk mendonte në këtë mënyrë. E tillë ishte situata në Shtetet e Bashkuara në fillim të viteve 1960, kur vendi ndodhej ende i kapërtë nga luftërat për të drejtat civile, përpara lëvizjes së grave, përpara lëvizjes për të Drejta të Barabarta sipas Amendamentit, përpara studimeve multikulturore, përpara gjithçkaje tjetër përveç kazanit të shkrirjes, këtij modeli asimilues e mbizotërues. Këto ishin ditët kur modeli i imigracionit konsistonte në faktin se po erdhe në Amerikë, do të asimiloheshe, do t'i prisje lidhjet me të kaluarën dhe me zakonet e tua të mëparshme dhe ky ishte çmimi që paguajë për privilegjin e të qenit shtetas amerikan.

Por ndodh që pikërisht këto çaste të dhimbshme të kthehen në mundësi për zgjerim e vetëkrijim. Unë isha bërë një hibrid – siç jemi të detyruar të bëhemi të gjithë ne që udhëtojmë përtej një uni, një qyteti apo atdheu origjinal. Unë isha një vajzë amerikane tipike, por nuk isha më as një vajzë krejtësisht dominikane. Dhe përsëri doja me shpirt që t'i përkisja diçkaje. Ishte pikërisht kjo vetmi dhe dëshirë e theksuar për t'u lidhur me të tjerët që më çuan te librat. E përmallur për atdheun dhe e vetmuar në SHBA, shpejt zbulova se bota e imagjinatës që një atdhe portativ, të cilit i përkiste gjithkush. Fillova të ëndërroj se ndofta edhe unë mund të krijoja botëra në të cilat askujt nuk do t'i ndalohej të hynte.

Dhe kështu ndodhi: hyrja ime e vërtetë në këtë vend u bë përmes portave të hapura të letërsisë së tij. Duke lexuar Uollt Uitmanin dëgjova premtimin e Amerikës dhe rashë në dashuri me vendin tim të ri. «Dëgjoj Amerikën duke kënduar, dëgjoj këngët e larmishme të saj.» Sa për shkrirjen e diversitetit tonë në një model qendror, Z. Uitman nuk pajtohet: «Unë jam i gjerë, përfshij një mori njerëzish.» Ky vend është një komb kombesh, një kongregacion racash. «Jam i fortë përballë gjithçkaje, përveç përballë diversitetit tim.»

A lejohej kjo? Habitesha me vete e shikoja rrotull. A nuk ishte subversive? Mirëpo poezitë e Z. Uitman qenë shtypur në librin tim të anglishtes ku ai quhej «poeti i Amerikës.» Ai thoshte se çfarë mishëronte në të vërtetë ky vend. Megjithëse Amerika dukej se i kishte harruar premtimet e saj, shkrimtarët e saj i mbanin mend dhe na i kujtonin edhe neve.

Nigadalë dhe jo pa përpjekje Amerika filloi të dëgjonte. Kur vitet 1960 ikën dhe erdhën vitet 1970, vendi rreth meje nisi të ndryshonte. Nën trysinë e shtresave të marginalizuara të popullsisë dhe të numrit në rritje të imigrantëve, vendi po detyrohej të pranonte larminë e tij dhe të bëhej përfshirës. Shtetasit po e sfidonin Amerikën që t'i mbante premtimet e saj. Kur mora pjesë për herë të parë në një marshim në mbështetje të Amendamentit të Kushtetutës për të Drejta të Barabarta, gjë për të cilën kurrfarë policie e fshehtë nuk më kapi e nuk më torturoi në një qeli të errët burgu, kuptova se një vend i lirë jo patjetër do të ishte edhe pa probleme, pa pabarazi ose pa hipokrizi. Mangësi të tilla vinin për shkak të të qenit qenie njerëzore. Liria ishte një mundësi për ta plazmuar një vend, për të kontribuar në eksperimentin në vazhdim, të paprovuar kurrë më parë, për të formuar nga turmat një komb të pandarë me liri e drejtësi për të gjithë. Këto fjalë nuk ishin thjesht retorikë. Ishte e drejta dhe përgjegjësia jonë për t'i bërë realitet këto fjalë për vete e për të tjerët.

Ndërsa vendi ndryshonte, edhe letëria jonë filloi t'i pasqyronte këto ndryshime. Unë zbulova se ajo nuk kishte vetëm një Z. Uitman, por edhe një Z. Lengston Hju.

*Edhe unë i këndoj Amerikës*

*Unë, vëllai më lëkurzi.*

*Ata më çojnë për të ngrënë në kuzhinë,*

*Kur vjen shoqëria,*

*Por unë qesh*

*Dhe ha mirë*

*Dhe rritem i fuqishëm.*

*Nesër*

*Do të jem në tryezë,*

*Kur të vijë shoqëria.*

*Askush nuk do të guxojë*

*Të më thotë*

*«Shko ha në kuzhinë»,*

*Atëherë.*

*Veç kësaj,*

*Ata do të shohin sa i bukur jam*

*Dhe do t'u vijë turp –*

*Sepse edhe unë jam Amerikan.*

Oh, këto vargje qenë muzikë për veshët e mi! E kuptoja se ku e kishte fjalën Z. Hjuj: ai kërkonte të afirmonte vendin e tij në korin e këngës amerikane. Ky ishte një zë i rëndësishëm për veshët e një vajze të re me kulturë, gjuhë e prejardhje tjetër.

Por bota e botimeve nuk ishte fort mikpritëse. Në fillim të viteve 1980, kur fillova të dërgoja dorëshkrimet e mia, botuesit kryesorë dhe tregu mbizotërues nuk kishin qejf të rrezikonin me zëra të rinj. Kjo vazhdoi deri kur ata filluan të shikonin se letërsia afro-amerikane ishte bërë një komponent serioz në shumë programe arsimore në kolegje. Lexuesit blenin librat e Elis Uokerit, Toni Morrisonit, Oskar Hijuelosit, Sandra Sisnerosit, Meksin Hong Kingstonit, Emi Tenit apo Gish Xhenit. Portreti i letrarëve amerikanë kishte ndryshuar.

Më 1991, kur isha 41 vjeçe, pas rreth 25 vjet përpjekjesh, një botues i vogël, i gatshëm për të provuar shansin me një zë të ri, botoi romanin tim *Si e Humbën Aksentin e Tyre Vajzat Garcia*. Njëmbëdhjetë vjet më vonë ky libër u përshtat si tekst në shumë shkolla të mesme e kolegje. Tani edhe unë i këndoj Amerikës.

E tregoj këtë histori të luftës sime për t'u bërë shkrimtare amerikane sepse ajo ishte një luftë që e ndaja bashkë me një vend që edhe ai luftonte për t'u bërë një vend më përfshirës e më përfaqësues. Unë ndihem fatlume dhe e privilegjuar që kam qenë pjesë e këtij procesi historik. Amerika më dha dhuntinë që të arrija të zbuloja dhe të kultivoja talentin tim. Unë nuk do të isha bërë shkrimtare po të mos kisha ardhur në këtë vend në moshë të re në vitin 1960.

**P**or, siç tha presidenti Kenedi disa muaj pas ardhjes sonë në këtë vend, «Mos pyet se ç'mund të bëjë vendi yt për ty, pyet se ç'mund të bësh ti për vendin tënd.» Detyra ime ndaj vendit tim është që t'ua kaloj këtë mundësi edhe të tjerëve. «Funksioni i lirisë,», ka thënë Toni Morrison, «është që të çliroh dikë tjetër.» Puna dhe vota ime kontribuojnë në pasurinë e larminë e së tërës. Me praninë tonë aktive dhe të përkushtuar si qytetarë që u përkasim etnive, racave, traditave e gjuhëve të ndryshme, ne e sfidojmë Amerikën që të zgjerojë kuptimin dhe mirëdashjen e saj dhe kështu të rritet e fuqishme si vend. Ne fusim energji të reja në letërsinë e saj. Këndojmë ritme të reja, e pasurojmë të tërën me artikulime, tregime e tradita të reja.

Por përgjegjësia ime nuk mbaron brenda kufijve të Amerikës. Ndryshe nga modeli i vjetër i imigracionit, shumë nga ne imigrantët vazhdojmë të kthehemi atje nga ku kemi ardhur fillimisht. Me shpërnguljet dhe lëvizjet e mëdha të gjysmës së dytë të shekullit që kaloi, shumë prej nesh nuk u përshtaten më përkufizimeve të rrepta të identitetit në të cilin kemi lindur. Vitin e kaluar takova në Kaliforni një afro-dominikano-amerikan që ishte martuar me një japoneze dhe kishin një fëmijë të vogël. Djali i tyre është afro-dominikano-japono-amerikan. Motra ime dominikane është martuar me një danez dhe fëmijët e saj flasin danisht, angleisht e spanjisht dhe dihet që u pëlqen të hanë *arroz con*

*habichuelas* me harena të kripura. Ne po bëhemi një planet hibridësh racorë e kulturorë. Ne kemi nevojë për një mendje pa paragjykime, zemër të madhe e imagjinatë të dhembshur për t'u pajtuar me të gjitha kombinimet që po ndodhin me ne si komb e si familje njerëzore. Fjalët e Z. Uitman na kujtojnë: «Vetë Shtetet e Bashkuara janë poema më e madhe... Ne nuk jemi një komb, por një komb i stërmadh kombesh... dhe bardi amerikan do të jetë një kozmos... i lumtur për t'ia trashëguar gjithçka gjithkujt.»

Për të krijuar këtë lloj kombi ne duhet të paraqesim një model të botës së cilës të gjithë i përkasim. Por një Amerikë e tillë mund të arrihet vetëm nëse çdo njeri është i lirë të shpalosë pasurinë e kompleksitetin që përbëjnë qenien e tij. Neve na joshin rreziqet për reduktime, për t'u strukur në bunkerët tanë racorë e etnikë dhe për të harruar se nga *pluribus* duhet të bëjmë *unum*, një familje njerëzore.

Mund të shkoja edhe më tej duke thënë se për të shpalosur veten tonë në të gjithë kompleksitetin e pasurinë tonë si dhe për të shpalosur shumëfishin e vetes sonë në shoqëri – është sfida jonë jo thjesht si amerikanë, por si qenie njerëzore. Robert Desnos, poeti francez që vdiq në një kamp përqendrimi, ka thënë: «Sfida për të qenë një qenie njerëzore nuk është vetëm për të qenë vetja jote, por për t'u bërë gjithsecili.» Terrenci, skllavi romak që çliroi veten me shkrimet e tij, e ka shprehur këtë në një formë tjetër: «Unë jam një qenie njerëzore. Asgjë njerëzore nuk është e huaj për mua.» Duke arritur të bëhemi gjithë sa mundemi individualisht dhe duke mos harruar kurrë përgjegjësinë tonë për të ndihmuar njeri-tjetrin që të arrijmë të njëjtin qëllim, ne mund të krijojmë një komb e një botë së cilës gjithkush i përket dhe në të cilën gjithsecili nga ne mund të këndojë këngën e tij.

Në këtë frymë unë e shikoj veten përherë e më shumë si një shkrimtare amerikane jo thjesht në kuptimin kombëtar, por në atë hemisferik. Me rrënjët e mia në pjesën jugore të Amerikave (me tregimet, historinë, traditat, spanjishten e ritmet e mia karaibiane) si dhe me kualifikimin, përvojën dhe lulëzimin tim në pjesën veriore të hemisferës, unë jam vërtet një shkrimtare krejtësisht amerikane.



*Edhe unë i këndoj Amerikës.*

*E di që kjo është thënë më parë  
por jo me këtë zë  
të plátano-s  
dhe të mangos,  
marimba y bongó,  
jo me këtë sancocho  
të inglés  
con español.*


*Ay si,  
është radha ime  
për të thënë  
atë çka shoh,  
dhe t'i këndoj Amerikës!  
me të gjithë Amerikën  
brenda meje:  
nga shojet  
e Tokës së Zjarrtë  
gjer në belin e hollë  
të Kirikuisit  
gjer në shpinën e Misipit  
përmes prapatokës së jankive  
gjer në rrafshirën e Kanadasë –  
të gjithë ne  
i këndojmë Amerikës,  
të gjithë familia-s  
hemisferike  
duke mbajtur në brez canción-in tonë,  
duke i kënduar lëkurës sonë ngjyrë bronzi  
me atë këngë të bardhë  
dhe të kuqe e blu –  
me këngën e madhe  
që i këndon  
të gjithë Amerikës  
el canto  
que cuenta  
con toda América:  
un këngë e re!*

*Ya llegó el momento,  
momenti ynë  
nën diell –  
ese sol që shkëlqen  
mbi gjithkënd.*

*Pra, forca maestro,  
na jep ritmin latin,  
¡Uno-dos-tres!  
Një-dy-tre!  
Ay si,  
(dhe në dy gjuhë):  
Yo también soy América  
Edhe unë jam Amerika. ■*

---

Përzgjedhja e Lengston Hjuzit (Langston Hughes) është marrë nga *Përmbledhje Poezish të Lengston Hjuzit*, nga Lengston Hjuzi, Kopirajti © 1994 i trashëgimisë së Lengston Hjuzit. Përdorur me lejen e Alfred A. Knopf, degë e Random House. Leja është marrë edhe nga Harold Ober associates.



**M**e origjinë nga Republika Dominikane, Xhulia Alvarez erdhi në Shtetet e Bashkuara në moshë të re – por trashëgimia e saj në gjuhën spanjole e ka zbuluar krijimtarinë e saj letrare në anglisht. Alvarez thotë se falë një granti të marrë nga Phillips Andover Academy më 1980, «përfitova një leje krijuese gjatë verës për të provuar dorën në prozën artistike, pasi fo rmini im si banore e ishullit i kishte rrënjët thellë në traditën e rrëfenjave që doja t'i eksploroja në prozën time,» një vendim që e ndihmoi atë të bëhej romanciere, autore vargjesh që kanë fituar çmime dhe autore librash për adoleshentët.

Në botimet e saj përfshihen Si e Humbën Aksentin e Tyre Vajzat Garcia, roman (Chapel Hill: Algonquin Books, 1991); Në Kohën e Fluturave, roman (Algonquin, 1994); Ana Tjetër, poezi (Dutton, 1995); Kthimi në Shtëpi: Poezi të Reja e të Zgjedhura (New York: Plume, 1996) YO!, roman (Algonquin, 1997); dhe Në Emër të Salomesë, roman (Algonquin, 2000) si dhe shumë vepra të tjera.

Xhulia Alvarez ka marrë gradën Bakalaur në Shkencat Shoqërore (B.A.) në Kolejin e Midëllbërit, Vermont, 1971, dhe gradën Master në Krijimtarinë Letrare në Universitetin e Sirakuzës më 1974. Ajo ka mbajtur leksione në Bread Loaf Writers' Conference dhe ka qenë pedagoge në Akademinë Phillips Andover, në Universitetin e Vermontit; Universitetin Xhorxh Uashington dhe Universitetin e Ilinoisit në Urbanë. Sot është shkrimtare pranë kolegjit Midëllbëri.

Në vitin 2000 Alvarez u zgjodh «gruaja e vitit» nga revista Lattina Magazine. Po atë vit shkoi në Republikën Dominikane për të marrë pjesë në përrurimin e presidentit të ri në përbërje të delegacionit zyrtar të SHBA. Si e Humbën Aksentin e Tyre Vajzat Garcia u zgjodh nga Bibliotekistët e Nju Jorkut si një ndër 21 veprat madhore të shekullit të 21-të. Në vitin 1994, libri Në Kohën e Fluturave u zgjodh si Libër i Shquar nga Shoqata e Bibliotekave Amerikane dhe ishte libri i zgjedhur nga Klubi i Muajit për atë vit. Poezia e saj «Libërbërja» u botua në Poezia më e Mirë Amerikane 1991. Përveç shumë çmimeve e nderimeve, Zj. Alvarez është zgjedhur në Këshillin Kombëtar të Anëtarëve të Qendrës Amerikane PEN.

Alvarez shkruan se «Për shkak të angazhimit tim të tanishëm në një fermë bujqësore që ka një qendër letrare në malet e Republikës Dominikane, më ka lindur interesi për letërsinë për fëmijë.» Kohët e fundit ajo ka botuar «tre libra për lexues të rinj», përfshirë Gjurmët e Fshehta (New York: Knopf, 2000) dhe Si Mundi të Qëndronte Tia Lola (New York: Knopf, 2001).



*Me rrënjët e mia në pjesën jugore të Amerikave (me tregimet, historinë, traditat, spanjishten e ritmet e mia karaibiane) si dhe me kualifikimin, përvojën dhe sulëzimin tim në pjesën veriore të hemisferës, unë jam vërtet një shkrimtare krejtësisht amerikane.*



# Birkerts <sup>Sven</sup>



Gjatë katër vjetëve të kaluara kam punuar me një memuar mbi periudhën e ardhjes sime në moshë, pika fillestare e të cilit ishte që të eksploroja se si një numër mundësish u bënë faktorë në ekuacionin e vjetër freudian të dashurisë e të punës për të arritur në njëfarë kuptimi të pasionit tim si shkrimtar, por që doli, shumë më përtej nga ç'mund të

kisha përfytyruar, një pasqyrë e luftës sime me ndjenjën time të trashëgimisë, një zhbirim i mënyrës se si sistemi i rrënjëve të mia letoneze të rritura dendur munda të prodhonte një korije kaq dëshirueshëm amerikane. Dhe kur së fundi e mbarova memuarin duke ndier se kisha arritur t'i zotëroja çështjet madhore të formimit të identitetit tim dhe kur lejova prindërit, vëllezërit e motrat e mia që të lexonin njëfarë përfundimi që kisha arritur me vendosmëri në faqet e shkruara mbi domenin familjar – që është fusha e forcës së origjinës – zbulova se unë vetëm sa e kisha konfirmuar apostazinë time të shqetësuar. Çështja se si të qenët amerikan frymëzon jetën time si shkrimtar, në shumë drejtime mbetet aq e potencuar, sa ç'ka qenë.

Pak të dhëna biografike: jam lindur më 1951 në Pontiak, Miçigan, nga prindër letonezë që sapo kishin emigruar nga zonat e njerëzve të shpërngulur në Gjermani, ku ndodheshin në fund të luftës. Të dyja anët e familjes sime pretendonin se ishin me prejardhje artistësh. Babai i mamasë kishte qenë piktor peizazhi i shkolluar në Akademinë e Moskës, por edhe prindërit e babait kishin qenë intelektualë – e ëma folkloriste, filologe dhe mësuese, kurse i ati au-

tor i shumë librave të psikologjisë, sociologjisë dhe studimeve folklorike.

Ndonëse kultura letoneze dhe gjuha letoneze të veçanti ishin të shenjta në familjen tonë, prindërit mi, ndryshe nga bashkatdhetarët e tyre letono-amerikanë, nuk ishin fanatikë të kulturës. Më fort ata e shikonin veten si të kalëronin mbi një valë modernizmi të emancipuar dhe ishin mjaft të sinkronizuar me bashkëkohoren. Im atë, një arkitekt i ri tejet ambicioz, punonte në firmën legjendare Eero Saarinen në Blumfield Hillz krah për krah me projektues të rinj si Kevin Rosh, Robert Venturi, Sezar Pelli e Çarlz Imz. Ata kishin të bënin me biblën e një gjuhe të re ndërkombëtare për formën, të cilën im atë, nëse në njëfarë rrafshi nuk e kundërshtonte, në rrafshe të tjera e shpërfillte për shkak të një shtrese të rrënjësuar thellë në kulturën e fuqishme popullore të atdheut.

Sa për vete, unë nuk njihja ndarje besnikërisht – të paktën jo në mënyrë të ndërgjegjshme. Gjatë gjithë viteve të rritjes obsesioni im kryesor ka qenë që të fshija çdo gjurmë të huaj, të tjetërlllojshme, dhe të bëhesha një amerikan i kompletuar. Një rrugë nga e cila nuk u tërhoqa edhe pse vuajta thellë. Unë e dija mirë se ç'dëshiroja. Dëshiroja që të bëhesha kopje e fëmijëve rrotull meje, në lagje, në shkollë. Të isha një djalë i shpenguar sportiv me emrin Bob ose Mark ose me nofkën «Çipi», i qethur marinarçe (i kisha bezdi kaçurrelat e mia të dendura) dhe të kisha prindër normalisht të pranueshëm; doja një Ford të ri të shkëlqyer (prindërit e mi blenin makina joamerikane) dhe një dorashkë bejsbolli për të luajtur me kapje topi në oborr me Babin (që edhe pas kaq vitesh – tani ai është mbi 70 – nuk besoj se ka vënë ndonjëherë dorashkë të tillë në dorën e tij).

Jo se kërkoja qiçra në hell, si nëpër ëndrra, por do të kisha dashur të isha një luftëtar Ninja apo një kauboj i stepave të Argjentinës. Se sido që të dukeshin gjërat nga jashtë, nga pikëpamja ime e fiksuar ne as nuk mund të fillonim të përshtateshim. Ne ishim të huaj nga një vend i huaj. Emri i tim eti nuk ishte Xhek apo Ted, por Gunar, kurse i nënës Silvia. Mua më quanin, o Zot, Sven, ndonëse unë e kontestojta apelin çdo vit në ditën e parë të shkollës dhe thoshja se



më quanin Piter – «Pit» – që ishte emri im i mesëm. Unë s' bëja dot asgjë lidhur me faktin se në shtëpi flisnim letonisht dhe prindërve të mi as që u bëhej vonë pse flisnin në këtë gjuhë kur ishin në publik. Unë shkoja në shëtitjet familjare i mobilizuar paraprakisht për t' u ruajtur nga ndonjë shpërthim i mundshëm në gjuhën amtare. Sa për shtëpinë tonë, ajo ishte gjithë tehe e qelqe brenda saj, pa një kënd komoditeti. Unë i mbaja larg shokët.

Teksa rropatesha me gjithë qenien time për të përfutur një normalitet amerikan dhe skuqesha nga turpi, që s' mund ta fshihja, edhe për shenjën më të vogël të ndryshimit tonë, unë i kaloja ditët duke luajtur një rol, duke imituar miqtë e mi fatlumë, duke i vënë maskat njëra pas tjetrës, duke u shtirur edhe në zakonet e mia më të parëndësishme, në çdo zhargonizëm që mund të merrte biseda, pra merrja një natyrë që nuk ishte aspak imja. «Ej, Rik, a ke qejf me u vërdallis një fije këtejna?» «Jo, laco, se më kërkon babushi për ca punë ke shpia – ça me ba?» E gjithë kjo ishte një imitim qesharak që vazhdoi deri në fund të adoleshencës sime duke ndryshuar vetëm lakimet e saj më të holla, deri kur shpërthimi i papritur i kundërkulturës bëri të mundshëm, madje të dëshirueshëm, të qenët «i çuditshëm» e «i ndryshëm.»

Që në fillim, pra, ndjenja ime më e thellë për atë se ç' do të thoshte të ishte amerikan u plazmua nga këto fantazi për një tjetër të paarrtshëm. Nuk kishte asgjë ekumenike, asnjë kazan shkririje sado të largët për secilën prej këtyre fantazive, nuk kishte vend për asgjë tjetër përtej thjeshtësisë skematike: hyj të shkathët në fushën e bejsbollit, baballarë tifoze që vrapojnë me mikrobuzë për në ndeshje, nëna të hedhura që nderin çarçafë të sapolarë në telat e oborrit apo mbushin karrocëza psonisjeje me hamburgera e misra.

Vite më vonë, kur lexova *Ankimin e Portnoit* të Filip Rothit (1969) u befasova, pasi në fantazitë e Aleks Portnoit hasa të njëjtin kuptim të thellë për thelbin e kokëkrisjes të mishëruar në përfytyrimet e tij për patinatoren e përsosur shikse:

«E kush po pyet për karakterin? Unë dua Tereal Mëkoin! Me gëzofin e saj bojëqielli, me veshoret e kuqe e me dorashkat e mëdha të bardha, ajo është Miss Amerika mbi patina! E dua me veshullën e me pudingun e saj të kumbullës (a me ç' të jetë), me shtëpinë e saj me oborr me shkallë e parmakë, me prindër të urtë, të duruar e dinjitozë dhe me një vëlla Billi që di të zbërthejë motorët e të thotë »Ju detyrohem shumë« dhe që s' ka frikë nga asgjë...»

Dhe:

«Edhe unë dua të jem i dashuri i Debi Reynoldsit – është Edi Fisheri ai që shfaqet tek unë, kaq, dhe kjo është një dëshirë që e kemi ne djemtë zeshkanë çifutë për ato ekzotiket e shpëllara bionde që quhen shikse...»

Në rastin tim energjia e dëshirës ishte identike – kishte si objektiv atë gjithëkanë e përfytyruar që quhej amerikanizëm. Megjithëse, sigurisht, e imagjinuara, e fantazuara, është po aq e vërtetë në pasoja, sa edhe një sërë rrethanash konkrete.

Ç' ishte kjo dramë veturrejtjeje për etninë e Rothit, timen – ç' ishte, *kulturore*? Nga buronte vallë? Për mua ajo nuk kishte të bënte aq fort me përbuzjen e hapur për origjinën time – ndonëse për shumë vjet kam besuar se ka qenë pikërisht kjo – sesa me faktin se deri diku unë e besoja, e «haja», vërtetësinë e imazheve që derdeshin tek unë nga të gjitha drejtimet duke filluar nga afishet dhe reklamat e revistave deri te televizori bardhë e zi i sapoblerë me zbulimin e tij të vazhduar të përsosmërisë amerikane të pamundimshme, që tani të gjithë e njohim si pseudoarti i veprave *Ozi dhe Herrieti*, *Shou i Dona Ridit*, *Tre Djemtë e Mi* e kështu me radhë. Nëpërmjet bezdisë së përplasjeve të mia të përditshme me atë çka unë *nuk* isha, unë ndërtova tablonë e amerikanizmit tim autentik të ekzaltuar.

Kjo dëshirë imja për t' u asimiluar nuk ka shërbyer kushedi sa shumë për forminin tim letrar si shkrintar, përveç faktit se ka qenë e aftë për të thelluar intuitën time të vetë-lindur të ndryshimit dhe faktit se unë isha jo pak i huaj, se në të vërtetë nuk i zotëroja ato të drejta «të patjetërsueshme» të shpallura në Kushtetutë. Unë jam i bindur se më vonë kjo vetëdijë u bë shtrat i nxehtë për dëshirat e mia të larmishme të të shkruarit. Por ndjesia e të qenit i ndryshëm, veçanërisht kur je i ri, nuk të krijon ndjenjën e ngazëllimit. Ajo kërkon lidhje, mbështetje, gjithçka që do t' i kundërvihej ndjenjës së të qenit i ndarë. Dhe kur këto nuk gjenden lehtë në botën përçark nesh, kërkimi vazhdon për zëvendësueset e tyre. Dhe ato që kërkjoja i gjeta në libra thuajse që në fillim. Së pari nëpërmjet eskapizmit dhe shfrenimit të fantazisë – duke i jetuar tërthorazi jetët përsosmërisht amerikane të vëllezërve Frenk e Xhoi Hardi apo të atletëve e të heronjve të ndryshëm që mbushnin në mënyrë tërheqëse librat e fëmijëve që unë i përpija.

**P**or këto zhytje nuk qenë kurrjë në krahasim me atë çka ndodhi në vitet e hershme të adoleshencës sime kur bëra kthesën e parë. Leximet ndryshuan, u bënë letrare. Nëpërmjet romaneve *Shpëtimtari në Thekër*, pastaj *Një Paqe e Ndarë* e më pas *Juxhin Gant* të Tomas Ulfrit, unë ndesha zërin e adoleshencës së tëhuajtur. Duke qenë në kontakt me subjekte mirëfilli të ngjeshura, në orientimin tim mes gjërave po përjetoja një kthesë të madhe, një drejtim të ri. Duke dëgjuar zërin e Holden Kolfildit më dukej sikur kthehesha në shtëpi. Po kuptoja se nuk isha i vetëm në këndvështrimin tim për botën. Universi i shtypit u bë befasi i mbushur me mundësi. Të lexuarit, për zgjerim edhe të shkruarit, u bënë një mision shpëtimi.

Ndjenjat e mia të kundërshtisë e të ndryshimit lidheshin drejtpërdrejt me tëhuajsimin e heronjve të mi të letërsisë dhe kur kjo u gërshetua me ndryshimet tektonike në jetën kulturore amerikane – me daljen e rokenrollit, të hipive, të protestës e të gjithçkaje që do të ziente në një kazan me emrin kundërkultura e viteve të fundit të dekadës 1960 – unë përfutova një këndvështrim të ndryshëm mbi atë çka kishte qenë «ideali» im amerikan. Tashmë, i zhytur në zhgënjimin tim, në zemërimin e grumbulluar gjatë viteve të

*Jam lindur... nga prindër letonezë që sapo kishin emigruar nga zonat e njerëzve të shpërngulur në Gjermani, ku ndodheshin në fund të luftës.*



përjashtimit tim të ndjeshëm, unë përmbysa gjithçka. Amerikani nofullkator, mendjegjerë, ideali im i mëparshëm (heronjtë e mi ishin të gjithë meshkuj) u riformua menjëherë në mendjen time si mishërimi i mentalitetit të «skifterit» dhe u bë objektivi i përbuzjes sime më të thellë. Unë tallesha me personazhet që i kisha admiruar dikur aq me zjarr. Në të njëjtën kohë luftoja që t'u bëja vend të gjithë atyre që më parë i kisha shpërfillur – pakicat, të varfërit, të gjithë ata që qenë apostrofuat nga Allen Ginzbergu në «Ulërima», bibla ime revizioniste amerikane. Mua më tërhoqën librat *Njerëz Blu* të Lëroi Xhousit dhe *Të Mjerët e Tokës* të Frens Fanonit – të paktën për nga sugjestionimi i titujve.

Si ka ndikuar të qenët amerikan në mendimet e mia, në krijimtarinë time si shkrimtar? Më mirë mbase do të ishte të më pyesnin se si të qenët letonez ka ndikuar në kuptimin tim se ç'do të thotë të jesh amerikan. Në burrinë time të hershme, pas intervalit të gjatë e të tërbuar të viteve 1960, duke i lënë pas vitet formuese më të fuqishme të miat, besova se edhe zemërimi i dikurshëm kishte mbetur pas. Madje mund të thosha se kisha pushuar së menduari në atë kontekst, nuk më bënte më përshtypje të qenët letonez apo amerikan. Nuk kisha vend për gjeneralitete të mëdha. Isha shumë i zënë me ngutësitë e mia të mëdha për të gjetur punë, dashuri dhe mënyrën për t'u bërë shkrimtar. Shembja e kundërkulturës dhe ndjenja e mërzi së zgjatur që erdhi më pas bëri që secili të merrej me kopshtin e vet – të paktën kështu dukej.

Por, sigurisht, çështjet, pyetjet, nuk u zhdukën. Thjesht nuk po i shihja më. Kur u shfaqën sërish, kjo nuk u bë sheshit dhe u deshën vite që të kuptoja se çfarë po ndodhte.

Ndryshimi, zgjimi, erdhën kur unë po u afrohesha të tridhjetave. Jetoja në Kembrixh duke e përballuar jetesën me zor e duke punuar si punonjës librarie, thellësisht i vrarë nga shembja e një marrëdhënieje të gjatë dhe krejtë-

sisht i bllokuar në përpjekjet e mia për të shkruar letërsi artistike. Nëse në jetën time kishte sadopak dritë, sadopak kthjelltësi, ato qëndronin te leximi. Ndonëse lexues i përhershëm, gjatë kësaj periudhe iu kushtova leximit me një zjarr të vërtetë. Ditët, javët, muajt kalonin jashtë dritares ndërsa unë rrija në një karrige të rëndomtë me rripa në dhomën time të vogël në apartamentin e përbashkët me një poet të ri premtues duke pirë duhan e duke lexuar romane. Më saktë, lexoja romane të huaja, evropiane, të përkthyer. Lexova Knut Hamsonin, Tomas Manin, Maks Frishin, Henri Bëlin e nja dhjetë të tjerë, sa më të errët, aq më mirë. Më tërhiqnin fuqimisht mjediset e këtyre romaneve, gjendjet shpirtërore, gjithçka që i bënte të ndryshme nga proza vendase që kisha lexuar prej vitesh. Nuk di të më ketë tërhequr – me sa mbaj mend – ndonjë gjë ku të ndihej kultura e origjinës sime. Unë vetëm lexoja dhe e lija unin tim ëndërrues të ecte përmes këtyre atmosferave të një lloji të çuditshëm.

Pastaj erdhi hopi. Në këto inkursione ndesha në botën e jashtëzakonshme të epikës së madhe, në jetën vieceze të paraluftës të *Njeriu pa Glësi* të Robert Muzilit. Dhe tani, bashkë me ndjesitë e mia më familjare të afërsisë psikologjike erdhi diçka e re. Leximi më nxiti për të shkruar. Vetëm se nuk më nxiste më proza artistike, por përsiatjet. Përjetoja një nxitje të fuqishme për t'iu afuar, për t'iu qëndruar pranë ndjenjave e reagimeve të mia duke shkruar për to.

U ropata për javë të tëra mbi një ese për Robert Muzilin dhe për kryeveprën e tij të papërfunduar. Lexova libra mbi kulturën e Vienës në dekadat e para të shekullit. E futa veten me një intensitet të madh në atë botë duke përfytyruar rrugët e ngushta, lulishtet publike, kafenetë, jetën shoqërore të ritualizuar të borgjezisë vieceze. Më dukej se të gjitha rituallet dhe ngjyresat e asaj bote të vjetër i shikoja me qartësinë më të madhe. Gjëja e vetme që nuk shikoja ishte e dukshmja, gjë për të cilën nuk isha i vetëdijshëm derisa

disa dekada më vonë do të ndodhesha në fazën e fundit të shkrimit të memuarit tim.

E kam fjalën: duke jetuar kaq gjatë brenda kësaj bote të përfytyruar gjallërisht, në thelb u lidha me botën e tregimit me të cilën isha rritur. Viena e Muzilit – kohët, kultura, *mizanskena* baroke mbizotëruese – në shumë drejtime qenë një filtër për Rigën, për jetën e gjyshërve të mi dhe, në një shkallë më të vogël, të prindërve të mi në fëmininë e tyre të përfytyruar prej meje. Imazhet që evokoj qenë imazhet që kisha ruajtur, pa e ditur as vetë, nga ditët më të hershme të fëminisë sime. Ekzistonte një vazhdimësi, një rrjedhje e drejtpërdrejtë energjie midis gjithçkaje që unë kisha përveçësuar nga gojëdhënat familjare, nga fotografitë e kartolinat që kisha parë (pavarësisht nga dëshira ime e përhershme për t'u bërë një djalë i mirëfilltë amerikan) dhe mjedisëve apo atmosferave që më kishin pushtuar në romanin e Muzilit. Evropa ishte jashtëzakonisht familjare për mua, një ngopje intime që më nxiste në të gjitha drejtimet.

Shkrimi i asaj eseje të parë më çoi te të tjerat, shumë nga të cilat, në mos të gjitha, ishin me subjekte evropiane dhe një ditë – gjithnjë i vonuar në njohje të tilla – pashë se kisha piketuar një terren letrar të caktuar: unë isha kritik i që do të ndërmjetësoja mes kulturës letrare amerikane dhe pasurisë së madhe të letërsisë së përkthyer, kryesisht evropiane. Libri im i parë ishte *Një Shkretëtim Artificiale: Ese mbi Letërsinë e Shekullit të Njëzetë* i pasuar, dy vjet më vonë, nga *Jetë Elektrike: Ese mbi Poezinë Moderne*. Duhej të shkruaja librin e tretë *Energji Amerikane: Ese mbi Prozën Artistike* që të isha gati për të trajtuar shkrimtarët e kulturës sime.

Po zgjatet në rezymenë time letrare, sepse ajo përbën atë që shfaqet menjëherë si një pikë e dallueshme edhe pse për të kam qenë i pavetëdijshëm prej vitesh: se e gjithë rruga e jetës sime, përfshirë jetën si shkrimtar, ka qenë thellësisht e kushtëzuar, së pari nga refuzimi i vendosur dhe pastaj nga pranimi mjegull i kulturës së origjinës sime dhe se kjo dinamikë, në rrafshin më të thellë, ka qenë e kushtëzuar nga një njenjë e fuqishme, ndonëse e shtrembëruar, e asaj se çka do të thotë të jesh amerikan.

Po flas këtu për shtysën primitive, thujse paralogjike, që kam ndier si djali i imigrantëve të tanishëm për ta shkri-rë unin tim me botën që shikoja përqark meje, një botë që për shkak të rastësive (apo fateve) në vende e kohë mori një aspekt absolut. Megjithatë është interesante të shënojmë se ajo nuk ka qenë thjesht ëndrra ime. Amerika që kërkoja përputhej thujse për mrekulli me stereotipin që edhe sot e kësaj dite është i spikatur, në mos mbizotërues, në kulturën e imazhit global për të: amerikani i mirëfilltë i bardhë, i suksesshëm, sportiv, dinjitoz. Duke e «ngrënë» Ëndrën Amerikane, gjë që e kisha bërë me zell të madh, në të vërtetë kisha ngrënë një fantazi që kishte trilluar për mua Medison Evinuja.

U deshën vitet 1960 që të më shkundnin nga këto ndjenja vetëkënaqësie. Aso kohe, i nxitur nga energjitë kundër-vepruese emancipuese të kundërkulturës, nga përplasjet e

përvojës si dhe nga pranimi i njohjes përherë e më të thellë të realitetit global – unë iu kundërvura tiranisë së këtij stereotipi. Unë luftova për t'i hedhur poshtë këto mbeturina të rrënjësura thellë dhe ia bëra qejfin vetes – a s'bëjmë kështu të gjithë? – se ia kisha dalë mbanë. Dhe vërtet më pëlqen të mendoj se çdo gjë që unë e shikoj si amerikane ka të bëjë kryekëput me nocionet e etnisë dhe të diversitetit (ndonëse këto janë slogane të detyrueshme) dhe kjo vetëdijë e transformuar ushtron trysni mbi të menduarit dhe të shkruarit tim në çdo hap. Por, për hir të së vërtetës, ajo nuk është formuese në të njëjtën mënyrë, ajo shtrihet përsipër një tjetër më të thellë. Do të dëshiroja që kjo të ishte ndryshe. Sepse një vetëdijë themelore e ndryshme, një investim më pak obsesiv në këto fantazi të normalitetit të amerikanëve elitare mund ta kishte bërë kalimin tim më të lehtë, më pak të dhimbshëm. Mjerisht, sado intriguese të jenë këto pandehma, ato nuk na çojnë kurrkund. Ne formohemi nga ajo çka ëndërrojmë dhe në këtë proces gjithçka është jashtë kontrollit tonë. ■

Ekstrakti i mësipërm i Rothit është marrë nga *Ankimi i Portonit* i Filip Rothit. Përdorur me lejen e Vintage International, degë e Random House, Inc.

**I** cilësuar nga një komentues si «mjeshtër modern i esesë letrare,» *Sven Birkerts ka botuar një sërë vëllimesh të mirëpritura mbi tema letrare e kulturore. Në veprat e tij madhore bëjnë pjesë Një Shkretëtim Artificiale: Ese mbi Letërsinë e Shekullit të 20-të (Morro, 1987); Jetë Elektrike: Ese mbi Poezinë Moderne (Morro, 1989); Energji Amerikane: Ese mbi Prozën Artistike (Morro, 1992); Elegjitë e Gutenbergut: Fati i të Lexuarit në një Epokë Elektronike (Faber & Faber, 1994); Lexime (Graywolf, 1998); Profesionet e Mia të Qiellit Blu (Graywolf, 2002). Esetë dhe recensionet e Birkertsit janë botuar në New York Times Book Review, Atlantic, Harper's, The New Republic, The Nation, The American Scholar dhe organe të tjera.*

*Në Elegjitë e Gutenbergut ai shkruan: «Zhytja jonë përherë e më e thellë në komunikimin elektronik ndëraktiv» mund të na çojë në «shkëputje nga fuqitë qytetëruese të fjalës së shkruar» dhe «librat elektronikë dhe videot ndëraktive do t'i dobësojnë aftësitë tona për përsiatje.» Nuk kemi pse të habitemi nga një shqetësim i tillë që vjen nga një intelektual letrar që shkruan në esenë e mëposhtme se si përsiatjet dhe leximet e një natyre tepër të ndërlikuar e kanë ndihmuar atë që të zbulojë identitetin e tij dhe të përcaktojë marrëdhëniet e tij me kulturën komerciale amerikane që e ka rrethuar që nga lindja e tij në Pontiak, Miçigan, më 1951, nga prindër imigrantë evropianë.*

*Ndër çmimet që ka marrë Birkertsit përfshihen: The Citation for Excellence in Reviewing nga Rrethi i Kritikëve Kombëtarë të Librit (1985); një grant nga Lila Wallace-Reader's Digest (1991); dhe një grant nga Guggenheim Foundation (1994).*

*Që nga viti 1994, Birkertsit është anëtar i trupit të pedagogëve të Seminarëve të Krijimitarisë Letrare dhe që nga viti 1997 është lektor në kolegjin Maunt Holjok. Disa nga revistat letrare me të cilat ka pasur lidhje të ngushta janë Wigwag, Mirabella, Esquire dhe si redaktor, Agni.*



# Robert Olen Batlër



Kartolina e ilustruar ka lindur rreth nëntëdhjetë vjet më parë. Ajo është një fotografi origjinale e bërë nga një person me aparatën e saposhpikur Kodak Brownie dhe është stampuar në një copë kartoni të fortë me shpinë kartoline. Kjo ishte një praktikë e rëndomtë në Amerikën e fillimit të shekullit të 20-të. Njerëzit bënin fotografi nga

aspekte të ndryshme të jetës së tyre të përditshme dhe ia dërgonin pamjet njëri-tjetrit me postë. Kjo pamje e veçantë është e një avioni biplan tejet të brishtë dhe u përket ditëve të para të rrezikshme të aviacionit kur piloti fluturonte i vetëm në një qiell të zbrazët. Po të shikohet me kujdes mund të vihet re se skaji i djathtë i krahut të sipërm ka filluar të prishet. Mesazhi në shpinë të kartolinës lexon: «Ky është Ērl Sandt i Eri Pasë në avionin e tij përpara rrëzimit.»

Unë kam mbi dhjetë vjet që koleksionoj kartolina të vjetra amerikane. Koleksionin e kam përqendruar jo vetëm në pamjet e anës së përparme të kartolinave – gjë që, pa dyshim, është e jashtëzakonshme – por sidomos në mesazhet në shpinën e tyre, që janë akoma më të jashtëzakonshme. Përpara se telefonat të përhapeshin në masë, njerëzit i komunikonin ato çka kishin në zemër me anën e pasme të kartolinave.

Si shkrimtar – një shkrimtar, them unë, vepra e të cilit është e rrënjësuar thellë në shpirtin e Amerikës – unë jam magjepsur nga këto mesazhe. Një artist i çfarëdo kombësie është thellësisht i ndjeshëm ndaj nuancës, aluzionit, nëntekstit apo zbulimit të personalitetit dhe përgjërimit të the-

llë që fshihet në çdo zemër njerëzore. Dhe këto fragmente nga zërat e amerikanëve që kanë ndërruar jetë prej kohe evokojnë thellë jo vetëm botët e tyre individuale që pulsojnë prapa fjalëve, por edhe shqetësimet dhe karakterin e këtij kombi në vitet e para të shekullit që do të ishte një shekull i jashtëzakonshëm.

Tani jam duke shkruar një libër me tregime të mbështetura në koleksionin tim me kartolina amerikane që u përka-sin dy dekadave të para të shekullit të kaluar. Libri do të përmbajë mbi njëzet e pesë tregime dhe pjesa e përparme dhe e pasme e çdo kartoline do të riprodhohet si një lloj epigrafi. Unë do të rikrijoj botën shpirtërore të shkruesit të mesazhit në pjesën e pasme të kartolinës, por mundet edhe atë të marrësit e mbase do të shikoj mundësisë edhe për të rikrijuar botën e dikujt që përmendet në mesazh.

Në një kartolinë private me fotografi paraqitet një grua që rri ulur pranë shoqes së saj në një veturë Mitchell të vitit 1906 dhe që ka shkruar një poezi poshtë figurës: «Asnjë akord muzike ende nuk është gjendur/që të barazohet me atë tingull të ëmbël/që kapërcen gjithçka në mendjen time/një motor veture që nxjerr tym të dendur.» Dhe shton duke i shkruar shoqes që rri ulur pranë saj: «A s'të kujton kjo xhirot e këndshme në rrugën e bukur Draiv Uei?» Qyteti prej nga shkruante ajo e kishte emrin Kuana, Teksas, i marrë nga emri i kryetarit të fisit Komançi, Kuana Parker, i cili ishte i fundit që e solli fisin e tij në një rezervat në Teksas Steikt Pleins dhe që më vonë u bë një biznesmen i suksesshëm, shok gjuetie i Teodor Ruzveltit dhe zëvendëssherif në Loton, Oklahoma.

Historia që tashmë kam shkruar i nxitur nga kjo kartolinë është një kronikë për dy gra, të cilat, ndërsa burrat e tyre kanë shkruar tek ankandi i kuajve, shkojnë të marrin veturën për një xhiro, gjë që dëshmon për pavarësinë e tyre, dhe që i çon ato ballë për ballë me sherifin, adashin e qytetit. Ky komb i ndërtuar mbi parimin e ruajtjes së të drejtave të pakicave nganjëherë ka qenë prapa me zbatimin e plotë të këtyre të drejtave. Por kjo kartolinë fikson çaste nga fillimi i shekullit të 20-të në procesin e hapjes së mëtejshme të shoqërisë amerikane. Një qytet i Teksasit nderon me emrin



e vet kryetarin e një fisi autokton amerikan që zhvilloi një luftë të gjatë kundër ngrehinës së një qyteti të tillë, por që më pas iu përshtat me sukses botës së re. Në teknologjinë e një shoqërie të dominuar nga burri një grua kënaqet bashkë me një grua tjetër duke e ndier ndofta se pikërisht kjo teknologji një ditë do të ndihmonte që kjo shoqëri të shndërrohej në një tjetër më barazimtare.

Një kartolinë me pamjen e ndërtesës ku bënin pjesë Departamentet e SHBA të Luftës, të Shtetit dhe të Marinës në Uashington, D.C., mban këtë mesazh: «Së dashurës sime Xhoxho: në kujtim të orës së këndshme që kaluam duke qëndruar përballë Departamenteve të SHBA të Luftës, të Shtetit dhe të Marinës (në një ditë të ftohtë) duke pritur që vargani të kalonte në Shtëpinë e Bardhë ku ne shtrënguam duart me presidentin Ruzvelt ditën e Vitit të Ri 1908. Nga e shtrenjta e saj Didi.» Kjo kartolinë, si shumë të tjera që përmbajnë mesazhe nga më personalet, nuk ka pullë. Ajo ka qenë futur në zarf për të ruajtur privatësinë. Dy gratë, të lidhura paqësisht në një mënyrë jonkonvencionale, kanë qenë krenare që prisnin ushtrimin e të drejtave të tyre për të shtrënguar duart me presidentin e Shteteve të Bashkuara.

Më 4 Korrik 1906, një djalosh anonim i ka dërguar një burri në Shelbörn Follz, Masaçusets, ndofta të atit, një pamje nga lumi Sako që rrjedh përmes Uajt Mauntins të Nju Hempshërit. Vula e postës tregon se djaloshi kishte zënë vend në një nga hotelet e mëdha të këtij vendpushimi në Uajt Mauntins, Kroford Haus. «Është një hotel i qetë me 4 yje,» shkruan ai. «Banojnë 220 bujtës. Kur sot në mëngjes u ngrit flamuri, ata u mblodhën në shesh, hoqën kapelet dhe brohoritën tri herë. Nesër do të shkojmë në ndeshje.» Kjo kartolinë më duket shumë prekëse për nga përmbajtja. Gati njëqind vjet më parë, të gjithë njerëzit në hotelin e madh të vjetër, shumica të panjohur me njëri-tjetrin, dolën në oborr dhe brohoritën me përkushtim për Amerikën që i mbante kaq të bashkuar. Kurse të nesërmen djaloshi do të shkonte të luante atë lojën amerikane, bej-sbollin, përsëri bashkë me të tjerët, këtë herë për lojë.

Kam edhe një foto tjetër private që mendoj se është bërë në vijat e llogoreve të frontit në Luftën e Parë Botërore në të cilën duken trungje drurësh të vënë stivë përgjatë murit prej dheu të gërmuar thellë si dhe figura e një ushtari këmbësor që po largohet. Në truallin prej dheu qëndron në këmbë një grua e bëshme me pamje dinjitoze, e veshur me një gabardinë të errët, me një kapele strehëngushtë në kokë, me sahatin e xhepit të mbërthyer në krahëror e me një buzëqeshje të lehtë e krenare në buzët e holla. Diçitura e shkruar me dorë thotë thjesht: «Nëna në Llogore.» Kjo nënë tipike amerikane ka shkruar në vijën e frontit për t'u interesuar për të birin.

Një kartolinë e prodhuar në seri paraqet figurën artistike të një gruaje që duket e braktisur. Fjala që përcakton gjendjen e saj shpirtërore është: *e pikëlluar*. Anash mesazhit dikush i ka drejtuar këto fjalë të thjeshta një njeriu në Atëllboro, Masaçusets, pa fjalë përshëndetëse ose nënshkrim: «Do të takohemi në vdekje.» Në pamje të parë kjo duket si një ndarje e hidhur e dy të dashuruarve. Por duke e vështruar më nga afër adresën e burrit del se ai është në sanatorium duke vdekur nga tuberkulozi. Marrëdhënia ndryshon në mënyrë drastike në përfytyrimin tonë dhe bëhet vërtet e ndërlikuar – veçanërisht nga mungesa e fjalëve dashurore dhe e identitetit të mesazhit. Në një epokë kur kaq shumë sëmundje kanë qenë fatale, një grua ka shkruar thjesht duke dhënë thelbin e besimit që ajo ndante me një njeri që po vdiste dhe që ajo e donte.

Në besimin, pragmatizmin dhe kurajën e kësaj gruaje ka diçka që mua më duket veçanërisht amerikane. Po kështu më duken edhe angazhimi i apasionuar i gruas së Teksasit ndaj progresit teknologjik, edhe kënaqësia e dy grave nga Uashingtoni për transparencën e një qeverie përfaqësuese, edhe shoqëria e një djaloshi me bashkatdhetarët e tij të panjohur, edhe forca, natyra mbrojtëse dhe aftësia e një nëne për të braktisur konvencionin për një qëllim më të lartë. Por, sigurisht, të gjitha këto cilësi janë njëkohësisht edhe

të gjithëmbarshme.

**E**shtë e rëndësishme të kuptojmë se si e veçanta dhe e përgjithshmja gërshetohen në art. Një vepër arti nuk buron nga mendja e artistit. Nuk buron nga aftësitë racionale, analitike. Nuk buron nga idetë. Arti buron nga thellësia ku artisti ëndërron. Arti buron nga e pavetëdijshmja.

E pavetëdijshmja është një vend i frikshëm. Akiro Kurosava, regjisori i madh japonez i filmit, dikur ka thënë: «Të jesh artist do të thotë të mos i kthesh kurrë sytë mënjanë.» Nëse artisti e bën vërtet këtë, nëse shkon tek e pavetëdijshmja ditë pas dite, vepër pas veprë dhe nuk i kthen sytë mënjanë ai, më në fund, arrin në një vend në të cilin ai nuk është as femër as mashkull, as i zi as i bardhë, as i kuq as i verdhë, as i krishterë as mysliman, as çifut, as hinduist, as budist e as ateist, as amerikanoverior as amerikanojugor, as evropian, as afrikan e as aziatik. Ai është njeri. Dhe nëse ndodh që për shkak të lindjes apo të zgjedhjes së tij ai i quan atdhe Shtetet e Bashkuara, ai do të shikojë përreth veçoritë e këtij vendi dhe të kësaj kulture dhe do të gjejë në to ato aspekte që do të rezonojnë me humanizmin e gjithëmbarshëm që ne ndajmë së bashku në këtë planet.

Vjeshtën që kaloi ndërmora një projekt letrar duke përdorur Internetin për të demonstruar këtë aksiomë themelore të procesit artistik. Studentët e mi qenë njohur prej kohe me pikëpamjen time se origjina e artit qëndron në të pavetëdijshmen dhe se, për rrjedhim, veprat e artit, në themel, janë objekte konkrete që e kuptojnë dhe e shpalosin botën në mënyra joanalitike. Megjithatë, paradoksi i të shpjeguarit të kësaj forme të artit është se për të shmangur analizën,

njeriu patjetër do të përfundojë duke përdorur të folurit analitik, siç po bëj unë pikërisht në këto fjali.

Pra, më 30 tetor 2001, nën patronazhin e uebsajtit të Universitetit të Shtetit të Floridës ku jap mësim, fillova një transmetim në Internet. Çdo natë, gjatë dy orëve, do të shkruaja një tregim letrar gjersa ta mbaroja. Studentët mund ta shikonin procesin krijues drejtpërdrejt, shkallë-shkallë, deri në përfundimin e tij. E fillova punën me një koncept të thjeshtë dhe pa përgatitje tjetër krijova një tregim në kohë reale. Shikuesit e mi ndiqnin çdo vendim

krijues që merrja, deri te presja, ashtu siç e shkruaja në faqe. Unë ekspozoja përpara tyre çdo fjali të pagoditur apo të pastrukturuar, çdo zgjedhje jo të mirë të fjalëve dhe çdo qorrrokak konceptual duke e përpunuar, rishikuar e rishikuar materialin përpara syve të tyre.

Prita gjer në mëngjesin e 30 tetorit për t'u bërë i hapur për frymëzim në mënyrë që të mos kisha mundësi, qoftë pvetëdijshëm, për ta paraplanifikuar tregimin. Doja që i gjithë procesi të shpalosej në uebsajt. Kështu që atë mëngjes shkova te koleksioni i kartolinave për të gjetur kartoli-

*Kjo pamje e veçantë  
është e një avioni biplan  
tejet të brishtë dhe u  
përket ditëve të para të  
rrezikshme të aviacionit  
kur piloti fluturonte i  
vetëm në një qiell të  
zbrazët.*



nën që përmbante historinë më të fortë. Dhe dora më shkoj vetë te kartolina me figurën e biplanit të Ērl Sandtit.

Kur e pata blerë atë kartolinë në një takim mbi kartolinat janarin e kaluar, e dija se një ditë do të shkruaja një tregim të frymëzuar prej saj. Gjithnjë kisha menduar se tregimi do të kishte botën e Ērl Sandtit, pilotit fatkeq. Por më 30 tetor kjo ndryshoi. E mora këtë kartolinë të vjetër dhe paveshtëdija ime artistike, ndjenja e unit tim si amerikan dhe identiteti im më i gjerë si qenie njerëzore konvergjuan të gjitha fuqishëm. Në çast e ndjeva se duhej ta shkruaja tregimin mbi botën shpirtërore e njeriut që shikonte.

Sepse më 11 shtator 2001 ne të gjithë qemë shikues.

Nga vendi im i ëndrrës shkrova këtë tregim mbi Amerikën e fillimit të shekullit të 20-të dhe duke vepruar kështu kuptova diçka themelore mbi atë ditë të tmerrshme të Amerikës së fillimit të shekullit të 21-të. Njeriu që e kishte bërë atë fotografi dhe që kishte shkruar kartolinën nëntëdhjetë vjet më parë do të kishte ndër të njëjtën gjë që ndiem edhe ne të gjithë më 11 shtator dhe unë arrita të kuptoja se pasojat më të thella dhe më të pashlyeshme të kësaj dite kanë të bëjnë shumë pak me politikën ndërkombëtare, me terrorizmin mbarëbotëror, me sigurimin e atdheut apo me unitetin si komb. Sigurisht që këto çështje janë reale dhe të rëndësishme, por mua më duket se përvoja më e thellë e 11 shtatorit u përjetua nga çdo shpirt njeriu në veçanti dhe në një mënyrë tërësisht vetjake. Ne të gjithë pamë rënien e një avioni në rrethana tronditëse, avion për të cilin nuk kishim kurrfarë reference dhe si përfundim ngjarja kapërceu disa mbrojtje që ne de-tyrimisht i mbartim brenda vetes. Dhe u përballëm, një nga një, në një mënyrë që shumë nga ne s'e kishin bërë kurrë më parë – me vetë mortalitetin tonë.

Artistët e të gjitha vendeve të botës kalojnë çdo ditë përmes së paveshtëdijshmes vetjake dhe hyjnë në thellësitë e së paveshtëdijshmes kolektive dhe këta artistë shfaqen me vizione të gjërave që na lidhin të gjithëve së bashku. Unë jam amerikan. Unë jam artist. Unë e mbaj shikimin te vendi im dhe kërkoj shpirtin njerëzor. ■

**D**uke filluar nga viti 1981 Robert Olen Batlër ka botuar 12 libra, 10 romane – *Rrugica e Edenit, Qentë e Diellit, Bashkëfshatari prej Eshtrash, Në Trevën e Largët, Uobëshi, Djalli, Pëshpërimat e Tyre, Deti i Thellë i Gjellbër, Njeriu i Hapësirës dhe Aromë e Mirë* nga një Mal i Çuditshëm që fitoi çmimin Pulicer 1993 për prozën artistike.

*Tregimet e tij kanë zënë faqet e shumë organeve si The New Yorker, The Paris Review, Harper's, GQ, Zoetrope, Hudson Review, The Virginia Quarterly Review, dhe Sewanee Review. Ato janë përzgjedhur për t'u përshirë në katër botime vjetore të The Best American Short Stories, në shtatë botime vjetore në New Stories from the South si dhe në shumë tekste shkollore letrare për kolegjet nga botues të tillë si Simon & Schuster, Norton, Viking, Little Brown & Co., Houghton Mifflin, Oxford University Press, Prentice Hall, dhe Bedford/St. Martin. Veprat e tij janë përkthyer në mbi dhjetë gjuhë si vietnamsisht, tajlandisht, koreance, polonisht, japonisht e greqisht.*

*Duke fituar bursën Gutenberg në prozën artistike dhe grantin e Fondacionit Kombëtar për Artin, Batlëri ka fituar edhe çmimin e Fondacionit Richard and Hinda Rosental nga Akademia Amerikane e Arteve dhe e Letrave dhe ka qenë finalist në çmimin PEN/Faulkner. Tregimi i tij «Paralajmërimi i Ndershëm» fitoi çmimin e vitit 2001 të Revishtës Kombëtare për Prozën Artistike, gjë që hodhi bazën për romanin e tij të ri me të njëjtin emër. Ai ka marrë edhe çmimin Tu Do Chinh Kien që jepet nga Veteranët Amerikanë të Vietnamit për «kontributin e shquar në kulturë të një veterani të Vietnamit.»*

*Duke filluar nga viti 1995 ka shkruar skenarë filmash artistikë për New Regency, Twentieth Century Fox, Warner Brothers, Paramount, Disney dhe Universal Pictures si dhe dy skenarë televizivë për Home Box Office. Është profesor me titullin Francis Eppes në Katedrën Michael Shaara të Krijimtarisë Letrare në Universitetin Shtetëror të Floridës, Tallahasi, Florida. Është i martuar me romancierën dhe dramaturgen Elibazet Djubëri.*



# St. Majkëll Shabbon



Në vitin 1969, kur isha gjashtë vjeç, prindërit e mi morën një kredi nga Administrata e Veteranëve dhe blenë një shtëpi me tri dhoma në një qytet imagjinar të quajtur Këlambia. Im atë, i lindur në Bruklin, pediatër në Shërbimin e Shëndetit Publik, para së gjithash ishte veteran i Rojës Bregdetare të Shteteve të Bashkuara (e cila e kishte

çuar me punë, pa dyshim me vend, në shtetin e Arizonës që nuk ka det). Kredia jonë e strehimit, e marrë nga Administrata e Veteranëve, qe e para që jepej në Këlambia, Merilend, dhe kjo ngjarje doli në faqen e parë të gazetës lokale.

Kam dëgjuar se Këlambia është sot qyteti i dytë i shtetit për nga madhësia, por në kohën kur ne shkuam atje, ajo nuk kishte më shumë se disa mijëra banorë, «pionierë», siç e quanin ata veten. Ata qenë kolonët e një ëndrrë, imigrantë në një trevë të re që më fort ekzistonte në letër. Më shumë se tre të katërtat e shtëpive të Këlambias, ndërtesa zyrash, parqe, pishina, rrugë për biçikleta, shkolla fillore e qendra tregtare qenë të projektuara dhe ende të pandërtuara; kurse mijëvjeçari i harmonisë racore dhe ekonomike që Këlambia premtonte se do të lindte në rrugët dhe qorrsokaqet e saj teorike qenë shumë larg lindjes së tyre. Në fund, me gjithë premtimet e ambiciet e saj, Këlambia mund të mos kishte sjellë ndryshim në asgjë, përveçse te një djalë i vogël. Unë prapëseprapë besoj se vendimi i prindërve të mi për të shkuar në mes të asaj veprë të imagjياتës arkitekturore e sociale të papërfunduar, por në vazhdim, ndryshoi rrjedhën e jetës sime dhe më bëri shkrimtarin që jam sot.

Në mesin e viteve 1960, një ëndërrimtar i pasur, kokëngjeshur e pragmatist me emrin Xhejms Rauz, që kishte shtëinë në dorë, me vjedhje e marifete, një copë të madhe të vendit të duhanit në Merilend përgjatë të dyja anëve të Këlambias Pajkut midis Baltimorës dhe Uashington Rauzit dhe që shpesh përmendet si shpikësi i qendrës tregtare (ndonëse përta i përket kësaj merite pretendimet janë kontestuese) ishte një burrë me ide të mëdha mbi natyrën e dëmshme të rrethinave dhe rëndësinë e vazhdueshme të qyteteve në jetën e njerëzve. Aso kohe Qyteti ishte një ide e diskredituar, diçka e djegur, e helmuar dhe e braktisur gjër në kalbësi, por Xhejms Rauzi ishte thellësisht i bindur se ai mund të ripërfytyrohej, të rindërtohej, të ripërtërihej.

Ai mblodhi një ekip burrash të zotë – një nga një mori ekipeve të tilla me burra kollarengushtë e flokëshkurtër, optimizmi i tmerrshëm i të cilëve i bënte vitet 1960 një kohë kaq të admirueshme dhe zhgënjyese. Këta burra llërrpërvëshur e quanin veten Grup Pune. Sikurse shefi i tyre, edhe ata i kishin kokat plot me ide të shëndosha e largpamëse për rregullimin e territorit, hapësirat e gjelbra, kalimet e kollajshme dhe jetën publike të qyteteve si dhe plot me koncepte të emancipuara mbi racat, klasat, arsimin, arkitekturën, kapitalizmin e tranzitin. Fati, pasuria dhe frymëzimi i shfrenuar i një teoricieni me xhepa shumë të thellë u dhanë mundësinë për të eksperimentuar në përmasa kolosale dhe ata e shfrytëzuan. Brenda një kohe relativisht të shkurtër, ata paraqitën Planin.

Kujtimet e mia më të hershme për Këlambian lidhen me Planin. Plani nuk ishte vetëm dokumenti themelues dhe pika më e fortë e eksperimentit të Këlambias. Ai ishte edhe thesari më i vyer i qytetit të ri, prova materiale e shpirtmadhësisë dhe e frymëzimit të Z. Rauz. Si në hollësi, edhe në frymë, Plani ishte ekspozuar për t'u parë nga të gjithë njerëzit në një ndërtesë të vogël (një nga ndërtimeve e para të Frenk Gehrit) e quajtur Qendra e Ekspozitave përgjatë bregut të liqenit artificial që ndodhej në qendër si të planit, edhe të qytetit. Ky liqen, i quajtur Liqeni Kitamakundi sipas një trilli të studiuar, historicist, që i dha një kontribut kaq autentik atmosferës utopike të qytetit, ishte i



pastër e i rregullt, i valëzuar nga vazhdat e ndritshme të rrosave. Buzë tij ngrihej një ndërtesë shumëkatëshe modeste e bardhë sipas stilit modernist Star Trek të fundit të viteve 1960, e quajtur ndërtesa e Qytetit Amerikan. Midis saj, pra «qielleggërvishtësisë» të vetëm të Këlambias, dhe Qendrës së Ekspozitave, shtrihej një shesh i hapur panoramik i rrethuar me stola e lehe lulesh, i pastër, i zbukuruar me një vepër skulpturore të çuditshme të quajtur Pema e Popullit, një lule qumështi e gjatë prej metali, xhufkat e praruara të së cilës përbëheshin nga figura të stilizuara njerëzish. Skulptura, stolat, sheshi, liqeni, kulla... në një pasdite me diell të motit 1970, ishin gjëra me një pamje ideale; ato ruanin perspektivën e paprishur, të pafund, të vizatimeve të arkitektit nga të cilat edhe kishin mbirë kohët e fundit.

Prindërit, vëllai im më i vogël dhe unë i kishim parë këto vizatime, por edhe të tjera si këto, në Qendrën e Ekspozitave. Atje kishte projekte, skica e diagrama shpjeguese. Atje shpjegohej Marrëveshja e famshme – marrëveshja e përbashkët midis gjithë banorëve të Këlambias dhe ndërtuesve për të respektuar disa rregulla estetike paksa të rrepta në ndërtimin dhe modifikimin e shtëpive të tyre. Në një-rën prej atyre dhomave të gjata të viteve 1970, tashmë të zhdukura, të mobiluara vetëm me kube të mbështjella me qilima dhe të lyera në ngjyrën e thesit të ëmbëlsirave prej misri, projektohej në mur edhe një diapozitiv. Diapozitivi paraqiste fëmijë të qeshur duke luajtur, familje që shëtisnin në rrugat e rrethuara me drurë, çifte që vozitnin në varka në liqenin Kitamakundi ose në liqenin Uaild, vëllai i tij artificial. Ajo ishte një botë e ndritshme, me ngjyrat bazë, por fëmijët e saj ishin përherë bardhë e zi. Sepse ajo ishte pjesë integrale e idesë së Këlambias: atje ku dikur sklleverit mblidhnin duhan mund të realizoheshin më në fund premtimet fisnike dhe ekstravagante që u qenë bërë zezakëve në vrullin e lëvizjes për të Drejtat Civile. Siç ma merrte mendja mua, ajo ishte pjesë e kuptimit të simbolit që ishte riprodhuar kudo rreth nesh në Qendrën e Ekspozitave: se ne ishim të gjithë degë të së njëjtës familje, se ndanim të njëjtat rrënjë e aspirata.

I ulur mbi një kub, duke parë projektimin e diapozitivit, ideja – Ideja – e Këlambias më hyri shumë në qejf, po fati im u vulos pikërisht kur ne po iknim nga ekspozita: tekta po dilnim, dikush më dha një hartë, një hartë të madhe, të palosur, të hollësisht dhe me ngjyra, të ëndrrës së Grupit të Punës.

Fuqia e hartave për të ndezur imagjinatën është e mirënjohur. Dhe, siç ka vërejtur Marlou i Xhozef Konradit, nuk ka hartë më tërheqëse se ajo që kemi në klasën e shkollës dhe që i ngjan hartës së Afrikës, me ngjyra si të flamurit, që e udhëhoqi atë fatalisht në kërkimin e tij të pafat, të karakterizuar nga dyshime e hamendje dhe nga zbrazëtia romantike e një territori të paeksploruar. Harta e Këlambias që mora në shtëpi nga ajo vizitë e parë i ngjante asaj. Plani diktonte që Qyteti të ndahej në nënjesi të quajtura Fshatra dhe çdo Fshat të ndahej në Lagje. Këta fshatra qenë pro-

jektuar dhe emërtuar, pra ishin të pranishëm dhe të përcaktuar në hartë. Qenë projektuar edhe shumë nga Lagjet bashkë me rrugët e rrugicat për biçikletat që thurnin strukturën e qytetit. Por në hartë kishte edhe zona të gjera që përveç emrit të Fshatit, ishin krejt të zbrazëta, të hamendësuar dhe, në fakt, joekzistente.

Emrat e Këlambias! Fakti që shumë syresh, në mos shumica, ishin të çuditshëm, të allasojshtëm e madje qesharakë përbënte një subjekt të përhershëm diskutimi si ndërmjet këlambianëve, edhe të jashtëmve. Në Lagjen që quhej Felps Lak mund të gjeje rrugë me emra anglo-tekanjözë dhe me aliteracione (Drajstro Drajv, Margrejev Mjuz, Lak-pëni Lejn); eliptike dhe enigmatike, pa prapashtesat e tyre, si Zen (Blu Pull, Red Lejk, Spajrëll Kat) ose mirëfilli të çuditshme (Klaudlip Kort, Roull Rajt Kort, Njugreinxh Garth). Flitej se emërtimi i një mijë rrugëve të Këlambias ishte bërë vetëm nga një punonjës i Kompanisë Rauz i cili, duke e pasur të ndaluar nga njëfarë marrëveshjeje e errët për të dubluar ndonjë nga emrat e rrugëve që përdorshin në kontetë fqinje të Baltimorës dhe të En Arundelit, ishte dëshpëruar nga stërpërdorimi i emrave të luleve, drurëve dhe presidentëve të SHBA apo i emrave të veprave të shkrimtarëve dhe poetëve amerikanë. Emri i engjëllit mbrojtës të Filip Felsit – mund ta merrni me mend? – ishte Robinson Xhefërs.

**H**arxhova shumë orë mbi atë hartë, shumë kohë përpara se familja ime të shkonte në shtëpinë që më së fundi e blemë me kredinë e Administratës së Veteranëve, në adresën 5179 Eliët Ouk Roud, në Lagjen Longfellou, në Fshatin Harpër's Çois. Për mua, gjëja e veçantë lidhur me ata emra nuk ishte tingëllimi i çuditshëm i tyre, por fakti i thjeshtë se shumica u referoheshin vendeve që nuk ekzistonin. Ata ishin si formula magjike, secili i sajuar për të thirrur në jetë një rrugë me asfalto-beton, një trotuar, një lulishte dhe asgjë tjetër. Me kalimin e kohës, rruga e thirrur duke shqiptuar formulën «Darkbush Terrës» ose «Najt Rust» do të shfaqej nga balta dhe argjila e Merilendit dhe do të mbushej me shtëpi, pemë apo tabela identifikuese bardhë e blu, gjë që e pashë me sytë e mi muaj pas muaji e vit pas viti. Në sytë e mi kjo ishte vërtetim i padiskutueshëm i fuqisë magjike të emrave dhe emërtimeve.

Harta tashmë që vjetëruar e grisur, kështu që e ngula me thumba në murin e dhomës sime në katin e dytë të shtëpisë sonë të stilit pseudokolonial me tri dhoma gjumi, dy banja me dush e një pa dush, në rrugën Eliët Ouk. Pas ca kohe, hartës origjinale iu shtua një hartë e Mbretërisë së re Magjike të Botës së Uollt Dizneit si dhe një hartë tjetër e fantazisë sime, e një bote me kuaj e bar të gjatë që unë e quajta Davoria. Unë e studioja hartën e Këlambias në mëngjes, kur vishesha për të shkuar në shkollë (një shkollë pa klasa në të cilën ne mësuam se beteja për integritet dhe të drejta civile kishte mbaruar dhe se të mirët kishin fituar, një informacion që e morëm si nga mësuesit prej racash të ndryshme, edhe thjesht nga përvoja që e përfitonim duke


parë rrotull fytyrat e tjera në klasë). Natën, ndërsa rrija shtrirë në krevat duke lexuar *Hobitin*, *Librin e të Treve* ose ndonjë roman me ngjarjet në *Oz*, i hidhja sytë nga harta. Nganjëherë i hidhja një sy të shpejtë edhe përpara se të ikja me shokët e mi zinj a të bardhë për ndonjë vrullosje fushave, tej kufijve të qytetit dhe të imagjinatës sonë.

Lagjia jonë Longfellou ishte deri diku e kompletuar, me ca lëndina të rregulluara rishtas ku qenë mbjellë ca pemë të holla si këmbët e kërrçit, po fill pas skajeve të saj shokët e mi dhe unë ngisnim biçikletat dhe shkonim përtej e Botës sonë së Njohur në një zbrazëti të paeksploruar prej argjile të gërmuar me buldozer dhe me hunj me shirita ku një ditë do të lulëzonin shtëpitë dhe njerëzit. Ne u ngjiteshim thurimave të shufrave prej hekuri dhe hynim në bodrumet e sapogërrmuara, të lagështa, ngjitëse e të mbushura me qimet e rrënjëve të drurëve. Rrokullisnim bobinat e mëdha të kabllit të telefonit nëpër sopet prej dheu, mblidhnim gozhdë të përthyerë në formë pyke dhe kuti llaçi bosh. Skeletet e shtëpive, sistemi i tyre nervor dhe shtresat e poshtme të

izolimit na zbuloheshin përpara syve dhe ne shikonim sesi ato vinin duke u rritur nga brenda jashtë. Më vonë do të njihja të zotët e shtëpive, do t'u bëja vizita dhe teksa do të rrija tek ata, do të mendoja: «I kam parë shtëpitë tuaja që kur kanë lindur.»

Në një kuptim, puna e vazhduar në qytetin tim amtar dhe veprimtaria ime fëminore përputheshin më së miri, sepse ndërsa më pas familja ime shkoi në një Fshat më të ri e më zhveshur në Long Rijç, ku dhe filloi të merrte rrokullimën me shpejtësi, Këlambia dhe unë luftonim për të mbushur vendet e zbrazëta, për të gjetur rrugën tonë në të çarat misterioze dhe në cepat e pazbulura të botës. Në rrjedhën e viteve të mia në Këlambia ndesha në gjëra që ishin jashtë vëmendjes së anëtarëve të Grupit të Punës, që nuk ishin hedhur në hartë. E kam fjalën se atje kishte territore të çuditshme, të paregjistruara, me shqetësime njerëzore për shkak të racës e gjinisë. Ishte edhe kataklizma e thellë dhe tronditëse e ndarjes së prindërve të mi që rivizatoi kaq shumë kufij dhe që krijoi, me lëvizjet proverbiale të penës,

*Skeletet e shtëpive, sistemi i tyre nervor,  
shtresat e tyre të poshtme të izolimit na  
zbuloheshin përpara syve dhe ne shikonim  
sesi ato vinin duke u rritur nga brenda jashtë.*



zona të gjera të reja pëshqjellimi e frike. Dhe erdhi një ditë kur ika nga Këlambria, një ditë kur edhe zbulova të vërtetën e hidhur mbi marrëdhëniet racore dhe për njëfarë kohe pa ta prirjen për t'i parë mësimet që më kishin mësuar dikur me njëfarë zëmërimi e pikëllimi. E ndjeva se më kishin mashtruar, se harta që më kishin dhënë ishte false. Mbi të gjitha, kohë më kohë do të dëgjoja se Këlambria kishte dështuar në eksperimentin e saj të madh. Ajo që bëri një periferi e llojit kopsht në Korridorin Baltimorë-Uashington; atje kishte krime e trazira racore.

Gjykimet e kritikëve të Këlambrias mund të jenë ose mund të mos jenë të sakta, por duke e hedhur shikimin 30 vjet pas në ëndrrat e mia dhe të Xhejms Rauzit, mua më duket se pikërisht për shkak se njeriu pushon së besuari në diçka për të cilën i kanë premtuar nuk do të thotë se vetë premtimi ka qenë gënjeshtër. Në rastin më të mirë femënia është një aventurë e përjetshme në kuptimin më të vërtetë të kësaj fjale shumëkuptimshme: ajo është shpalosje e vetvetes në ca fushëtira pa rrugë që mund të kishin ardhur në

ekzistencë pak përpara se t'i hidhje sytë në to. Sa fatlum kam qenë që më ra në dorë, në një moshë kaq të njomë, një hartë për t'u orientuar, sado e përkohshme, një hartë që për më tepër ishte e zbuluar me një nomenklaturë të ndërlikuar aluzionesh të nxjerra nga vjershat, romanet e tregimet e njerëzve misteriozë me emrat Folkner, Heminguei, Frost, Hothorn dhe Fitsxherald! Këta emra, ato aventura janë ende tek unë; i kam pranë sa herë që ulem në tastierë për të lundruar larg, në treva të panjohura, me një hartë të dyshimtë apo një hartë çfarëdo. ■

Fillimisht botuar në  
Architectural Digest  
©2001 Michael Chabon

**K**ohët e fundit prodhimi letrar i shumanshëm i romancierit dhe i tregimtarit Majkëll Shabon shënoi një kulm të ri me botimin e veprës *Aventurat e Mrekullueshme të Kavalierit dhe Klejtit (Random House, 2000)*, një roman ambicioz që bën fjalë për aventurat e dy kushërinjve që shkojnë në Nju Jork në vitet 1930 dhe hyjnë në biznesin e tregimeve të ilustruara. Kavalieri dhe Kleji ka fituar çmimin Pulicer në Prozën Artistike 2001 dhe aktualisht Shaboni është duke punuar me një sërë projektesh e botimesh madhore.

Ndër veprat e botuara bëjnë pjesë *Misteret e Pitsburgut, roman (1988)* dhe *Djemtë e Çudirave, roman (1995)* si dhe dy vëllime me tregime, *Një Botë Model dhe Tregime të Tjera, (1990)* dhe *Njerëzit-Ujq në Rininë e Tyre (1999)*. *Shkrimet e tij janë botuar në The New Yorker, Harper's, Esquire dhe Playboy dhe në një numër antologjish, ndërmyjet të cilave: Tregimet e Çmimeve O'Henri 1999. Një pjesë e mirë e krijimtarisë së tij gjendet edhe në uebsajtin e tij [www.michaelchabon.com](http://www.michaelchabon.com).*

Pas diplomimit nga Universiteti i Pitsburgut, Shaboni u regjistrua në programin e Masterit të Arteve të Bukura (M.F.A.) në Universitetin e Kalifornisë, Èrvajn. Ai paraqiti dorëshkrimin e një romani si disertacion për M.F.A. dhe që më pas, më 1988, u botua me titullin *Misteret e Pitsburgut, kur Shaboni ishte në të njëzetat. Revista The New Yorker e ka cilësuar Misteret si «një shembull thuajse të përsosur të një romani të parë premtues,» kurse recenzentë të tjerë e kanë krahasuar Shabonin me romancierë si F. Skot Fitsxherald dhe Xh.D. Selinxher. Romani tjetër i tij, Djemtë e Çudirave, u bë bestseller dhe u shirua film ku luan Majkëll Dagllës.*

*Eseja e Shabonit «Harta dhe Legjenda» në këtë vëllim buron nga rrethanat e lindjes së tij në Këlambria, Merilend, më 1964, një nga qytetet e pakta të ndërtuara me planifikim në Shtetet e Bashkuara. Sipas fjalëve të vetë Shabonit, imaginata e tij e pasur buron pjesërisht nga kontakti i tij me një numër të jashtëzakonshëm librash komikë në femëni, të cilët ia blente babai. Gjyshi i tij nga babai kishte qenë tipograf dhe kishte shtypur shumë libra komikë që ia sillte të birit. Duke qenë në një mendje me shumë kritikë, Soll Osterlits shkruan në uebsajtin «Central Booking» se «përveç që është një nga shkrimtarët më të suksesshëm dhe më të pëlqyer që kanë dalë në prozën artistike amerikane dhjetëvjeçarin e kaluar... Majkëll Shaboni u shmangte edhe shumë prej lojërave të shokëve të tij postmodernë duke parapëlqyer virtytin e thjeshtë të modës së vjetër të një historie të treguar mirë. Librat e tij mbeten në kujtesën e lexuesve për personazhet e fuqishme dhe të gdhendura mirë si dhe për dhuntinë e dialogëve të mprehtë.»*

*Shaboni jeton në Bërkli, Kaliforni, me të shoqen Ejlit Uoldmën e fëmijët.*



# Billi Kolins



Përpara se të shkoja në Angli disa vjet më parë për të bërë një cikël leximesh, unë kurrë nuk e kisha quajtur veten një poet veçanërisht amerikan. Turneun e organizova krejtësisht vetë dhe ai doli siç duhej. Në vargun e auditorëve të veçantë u përfshinë një klasë e gjashtë, një klub xhazi në Brajton, një kolegji në Universitetin Shefield dhe një

qendër bashkësie në një fshat të vogël të Jorkshërit. Me që ra fjala, pikërisht në këtë vend të fundit një burrë i mosshuar me pamje fshatari u ngrit nga vendi në mes të auditorit gjatë një sesiioni me pyetje/përgjigje dhe më pyeti: «Z. Kolins, të gjitha poezitë në prozë i keni shkruar?» Pavarësisht nga auditori i lokalit, çdo lexim më bënte të kuptoja të njëjtën gjë të vogël, por të vazhdueshme: se poezitë e mia qenë shkruar jo në anglisht, por në amerikançe. Në çdo lexim, kur shqiptoja shprehje të tilla si «nxitem lehtësisht» ose «djersij deri në fund» dalloja pika të vdekura. Filllova të bindesha se kur në njërën nga poezitë e mia thosha «lulja e një shteti», në veshët e britanikut ajo i tingëllonte si «lule fushe.» Po zbulova se amerikançja idiomatike është e vështirë për t'u përkthyer jo vetëm në frëngjisht ose gjermanisht, por edhe në anglisht. Sikurse njeriu nuk mund të kuptojë se ç'është amerikanë derisa të largohet nga vendi, edhe unë, përpara se të ndodhesha përballë një numri dëgjuesish britanikë, nuk kisha qenë, si të thuash, i vetëdijshëm për zërin tim amerikan, për aksentin tim të shkruar.

U habita sidomos kur zbulova se sa fort të ngulura në të folmen amerikane ishin poezitë e mia, pasi prej vitesh i isha

shmangur përdorimit të të folmeve të modës apo referencave të kulturës bashkëkohore. E dija se shprehje të tilla si «fluturues i shpeshtë», «derë e pasme veture» ose «Jello shot» (lloj pijeje) do të bënin që një poezi të tingëllonte e vjetruar dhe kështu që do ta kishte shumë të shkurtër jetën e bibliotekës. «Jeta e bibliotekës» është ndofta një shembull tjetër. Unë jam përpjekur të aktivizoj një leksik më të gjithëmbarshtëm, jo thjesht një përdorim të mirëfilltë të fjalëve «shkëmb», «re», «qiell» apo «pemë», por një të folme që të ecte në atë drejtim dhe që të mos ishte e prirur për të lejuar në fondin e vet të rejat gjuhësore të ditës. Ezra Paundi e ka shprehur këtë dukuri në një mënyrë më koncize kur e ka përkufizuar poezinë si «një kumt që qëndron i ri». Unë admiroj edhe këshillën e Meri Oliverit në lidhje me nocionin e një poeti për auditorin: «...të shkruash për një të huaj të lindur në një vend të largët qindra vjet më vonë.» Unë doja që ta përfshija atë të huaj të së ardhmes në auditorin tim dhe nuk do të doja që ai të sqarohet te shënimet në fund të faqes për fjalët «Wonder Bread» (lloj buke) apo për «Big Mac» (lloj hamburgeri).

Amerika, sigurisht, është më e madhe se shuma e të folmeve të saj, por nëse do të zgjidhnim disa poetë ndërkombëtarë dhe t'i pyesnim mbi lidhjen e poezisë së tyre me kombësinë e tyre, shumica do të vinin gjuhën amtare në qendër të përgjigjeve të tyre. Çeslav Milozhi do të përmendte mundësitë shprehëse të gjuhës polake, Janis Ricosi mund të fliste për ndjenjën e të shkruarit në greqishten demotike. Por poetët amerikanë nuk mund të pretendojnë për të drejta ekskluzive, nacionalistike për gjuhë amtare, pasi gjuha që ata shkruajnë është e përbashkët me pjesën tjetër të botës anglishtfolëse dhe që, në të njëjtën kohë, është gjuha që po përhapet më shpejt në botë.

Pra, ku qëndron amerikanizmi për një shkrimtar amerikan nëse nuk qëndron te gjuha e tij amtare? D.H. Lorens e nis veprën e tij udhëhapëse *Studime mbi Letërsinë Amerikane Klasike* me shtrimin e pyetjes në formë sfide: «Ku është ky zog i ri i quajtur amerikan? Na e tregoni këtë burrec të epokës së re. Hë pra, na e tregoni. Sepse në Amerikë gjithçka që është e dukshme për syrin lakuriq evropian, është njëfa-



rë imitacioni i keq i evropianes.» Mua më duket e habitshme që Lorensi e quan syrin evropian «lakuriq», sepse, hollë-hollë, i krahasuar me lentet libreske që mbulon syrin evropian, është syri amerikan ai që është lakuriq; dhe poeti i parë që do ta shikonte Amerikën me atë sy lakuriq – dhe që, në të vërtetë, do të na e zbulonte lakuriq përpara nesh – ishte Uollt Uitmani.

Lorensi e njihje Uitmanin si pionier të letërsisë së re amerikane. Ai e quante atë «më të madhin, të parin dhe të vetmin mësues amerikan... të parin autokton të bardhë» megjithëse, në po atë frymë, ai e parodizon qëndrimin universal të Uitmanit dhe e akuzon atë për simpati të shtirur. Sigurisht, Uitmani qe poeti i parë që u përpoq t'i shtrinte krahët rreth kontinentit për të mbajtur druvarin, ministrin dhe eskimezin në një përfaqim kozmik të ngrohtë. Banor i Long Ajlëndit dhe i Nju Jorkut, ai nuk pranonte ta përkufizonte veten provincial, siç kanë bërë disa poetë të tjerë amerikanë dhe akoma më shumë disa romancierë amerikanë që nga ajo kohë. Por gjesti i vërtetë autokton ishte largimi i Uitmanit nga zinxhiri jambik i poezisë tradicionale angleze. *Fije Bari* mban ritmin e Biblës, jo dyhapëshin jambik. Kjo poemë e gjatë shënoi një largim kaq të madh nga metrika dhe forma tradicionale britanike, sa që i dha shkas një debati kritik nëse ishte vërtetë poezi, një debat që duhet të jetë mbyllur kur një profesor vërejtë: «Nëse nuk është poezi, është diçka më e madhe se poezia.»

**P**ër çudi, u desh një kohë e gjatë që të tjerët të ndiqnin shembullin çlirues të Uitmanit. Lorensi është shprehur: «Përpara Uitmanit, asgjë. Përpara të gjithë poetëve, duke çarë shkretëtirën e një jete ende të paçelur, Uitmani.» Eventualisht poezia amerikane e arriti Uitmanin, po jo përpara se të kishte përfunduar shekulli i tij. Në fillim të viteve 1920, kur Lorensi bënte vlerësimet e tij, filluan të dilnin shumë nga poezitë tashmë kanonike moderniste dhe pavarësisht se ku qëndronte ajo diçka tjetër që do të karakterizonte largimet e tyre nga tradita, lirinë e tyre nga shablloni i strofës dhe kapistalli i jambikut, pikërisht kjo diçka përbënte dëshminë më të zakonshme të eksperimentimeve të tyre.

Sigurisht, në ditët tona «vargu i lirë» nuk është më ajo licensë ngazëllyese që ka qenë dikur; shumë shpesh ai përdoret si justifikim për të prodhuar poezi të çregullta joritmike, një justifikim që nuk kufizohet kurrsesi vetëm te poetët amerikanë. Mësimi më i madh e më i vështirë, por edhe më i qëndrueshëm i Uitmanit qëndron në natyrën e guximshme të tij. Guximi i vargjeve të tilla si «Është koha për të shpjeguar vetveten, le ta bëjmë» dhe «Trokas me hap barbar mbi çatitë e botës» u hapën rrugën vargjeve të Ginzbergut: «Amerikan, po i vë rrotës shpatullat e mia të çuditshme» dhe, me njëfarë ndrojtjeje, vargjeve të Frenk O'Harës «Ah, dreka! Më duket se po çmendem.» Zëri i guximshëm e i padëgjuar i Uitmanit theu xhamat e fisnikërisë evropiane dhe eventualisht u dha zemër brezave të mëpasëm të poetëve amerikanë për të folur me tone më të fuqishme.

Në goftë se një shkrimtar është rezultante e ndikimeve që ai ose ajo ka marrë, atëherë poezitë e mia janë detyrimisht rezultat i ekspozimit tim ndaj tingujve e stileve të poezisë angleze e amerikane. Madje unë e gjej veten duke luajtur me njërin të folme kundër tjetrës, zakonisht për efekte ironie. Dhe më konkretisht, duke e menduar veten si «poet amerikan» dhe duke kryer kështu aktin e rrezikshëm të autokritikës letrare, unë vë re se një numër poezish të mia duken të prirura për të vendosur një taban amerikan të dallueshëm nga ndikimi evropian. «Soneti Amerikan», për shembull, është mohim i soneteve italiane dhe angleze në favor të kartolinës amerikane, e cila, si soneti, e kufizon shprehjen brenda një hapësire të kufizuar dhe përveç kësaj, kombinon fjalësoren, nga njëra anë, me piktoriken, nga ana tjetër. Sikurse soneti tradicional i dashurisë, edhe kartolina e udhëtarit ka fituar konvencionet e saj rituale. Poezia hapet me një «ne» jokarakteristike, sikur unë të flisja në emër të të gjithë poetëve amerikanë.

#### SONET AMERIKAN

*Ne nuk flasim si Petrarka, as mbajmë kapele si Spenseri  
dhe nuk kemi katërmbëdhjetë vargje  
si brazdat në një arë të vogël të lëruar me kujdes,*

*por kemi kartolinën e ilustruar, një poezi në pushime,  
që na detyron t'i këndojmë këngët në hapësira të vogla,  
apo t'i derdhim ndjenjat tona me pikatore.*

*Ne shkruajmë në shpinë të ujëvarës a të liqenit,  
duke i shtuar pamjes një diçiturë aq të njohur  
sa edhe sytë rrethdiellorë të një gruaje elizabetiane.*


*Ne e përcaktojmë me një mbiemër motin.  
Ne shpallim se po ia kalojmë për mrekulli.  
Ne shprehim dëshirën që ju të ishit këtu*

*duke e fshehur dëshirën që ne të ishim te ju,  
te ju, që ktheheni nga kutia e postës me kokën të ulur,  
teksa lexoni e rrotulloni mesazhin në duart tuaja.*

*Një copëz nga ky vend i largët, një brez bregu i bardhë,  
një shesh, apo shigjetat e gdhendura të katedrales  
do të shpojnë vendet familjare ku ju qëndroni,*

*dhe do të rrotulloni mbi tryezë këtë ekspozim të kthyeshëm,  
një pakicë inçesh katrorë ku ne kemi shëtitur,  
dhe një ngjeshje të asaj çka ndiejmë ne.*

Loja ironike letrare e pjesës së parë të poezisë shpalos një dramë të vogël ndarjeje, largësie dhe malli. Ndonëse nuk ia arrin, poezia përpiqet që të shkrijë ironinë dhe emocionin në një raport të tillë barazie sa që të bëhet e mundur të përftohet një ton përsosmërisht i dytlershëm.



*Këtu kam qenë edhe tjetër  
herë, shumë kohë më parë, dhe  
ja ku jam përsëri, dhe ky është  
një konstatim që ndodh në poezi aq  
shpesh, sa ç'ndodh në jetë rënia e shiut.*

Një poezi tjetër e quajtur «Ngushëllimi» pretendon t'i këndojë kënaqësisë së kalimit të verës në atdhe dhe jo nisjes për pushimet tradicionale në Evropë. Poezia hapet me vargun «Sa e këndshme është të mos bredhësh nëpër Itali» dhe vazhdon të flasë për rehatinë e të qëndruarit në truallin amtari duke shëtitur «në këto rrugë vendore, të njohura/ku e kap menjëherë kuptimin e çdo shenje e tabele rrugore/dhe të gjesteve të papitura të duarve të bashkëvendasve.» «Në vend që të strukem në një kafe ku nuk e di fjalën akull,» rrefimtarit poetik parapëlqen «kafenën dhe kamerieren me emra familjarë» ku ai nuk është i detyruar të dalë në fotografi me pronarin apo të pyesë për kursin e shkëmbimit kur vjen fatura. Ai thotë: «Mjafton që të hipi në veturën time për kthim/si të ishte vetura e madhe e vetë anglishtes/dhe duke i rënë burisë zëllartë amtare nis rrugën/që nuk do të më çojë as në Romë, as në Bolonjë.» Poezia është një mohim humoristik i eurocentrizmit që shprehet nga një rrefimtar poetik, shijet modeste të të cilit i bëjnë jehonë provincializmit të këndshëm të personazhit të Uolles Shonit në filmin *Dreka ime me Andrenë*.

Poezia «Vargje të Shkruara mbi Tri Mijë Milje Larg Tintërn Ebit», siç e sugjeron titulli, jep një shembull tjetër të procesit të «amerikanizimit», ku lirika e famshme autobiografike e Wërdsuërthit importohet në jetën familjare, por gjithsesi amerikane, të rrefimtarit poetik.

*Këtu kam qenë edhe tjetër herë, shumë kohë më parë,  
dhe ja ku jam përsëri,  
dhe ky është një konstatim që ndodh në poezi  
aq shpesh, sa ç'ndodh në jetë rënia e shiut.*

*Një djalosh mbase rri duke shikuar  
peizazhin e tokës angleze,  
faqet e kodrës të pikëzuara nga delet,  
një sërë drurësh të lartë në bregoren e gjelbër,*

*ose mbase shëtit i trishtuar përmes hijeve  
të një pylli të errët bavarez,  
me një byreçkë me djathë e një libër me përralla,  
që ka marrë me vete në çantë.*

*Gjithsesi, ndjenja është përherë e njëjtë:  
ishite më mirë herën e parë.  
Këtë herë nuk është edhe aq mirë.  
Nuk po ndihem aq gazmor sa dikur.*

*Gjithçka përherë mungon –  
Mjelmat, si njolla të ndritshme në faqen e liqenit,  
një prekje e vogël, por thelbësore.  
Apo cilësia e gjërave është zbehur.*

*Qielli ishte më i thellë, me një blu më dimensionale,  
retë, më shumë të ngjashme me katedralet,  
dhe ujët që përplasej pas shkëmbit  
kishte shkumëzime më të bardha.*

*Kemi kundruar nga karriget tona  
autorin e gjorë të veshur me jelek,  
teksa kujtonte ajsbergët marramendës të fëminisë  
duke ardhur vërdallë në fushën plot barishte.*

*Kemi dëgjuar poetët e vdekur prej kohe  
duke deklamuar për vdekjen e tyre,  
qëndruar mbi një kep, a në një breg lumi  
pranë një mullari bari, a në hijen e një zabeli.*

*E kemi ndier mërzitjen e tyre,  
atë lloj brengje që del nga poezitë,  
siç del uji nga tubat prej gome,  
siç ia jep shkrepja përherë fjalëzën e saj zjarrit.*

*Dhe, kur më në fund e lëmë librin mënjane,  
dhe tërhiqemi pas duke mbyllur sytë  
e pickuar nga shkronjat, dhe futim mes tij  
shenjuesin e faqeve për të marrë një sy gjumë,*

*do të jemi mjaft më të kënduar e do ta dimë,  
se kur do të zgjohemi  
pak para darkës  
gjërat nuk do të jenë më siç ishin më parë.*

*Diçka do t'i mungojë,  
kësaj dhome të gjatë, në formë arkivoli,  
diçka do t'u mungojë mureve, dritareve  
me dy ngjyresa të ndryshme të grisë,*

*dhe gardenia e sedeftë var kryet,  
në saksinë e saj prej terrakote të ciflosur.  
Dhe mbi dysheme, këpucë, çorape,  
zemra bojëkafe e një molle.*

*Asgjë nuk do të jetë siç ka qenë më parë,  
veç disa orë më parë, a në të shkuarën zulummadhe  
përpara dremitjeve tona, në atë Epokë të Artë,  
që mori fund shpejt pas darkës.*

Çmagjepsja riinterpretuese e rrefimtarit poetik me temën romantike të humbjes bie në sy nga futja në një thes e të gjithë poetëve ankimtarë, anglezë e gjermanë, të shekullit të 19-të. Mësimi me këtë model të humbjes fillon me imazhet e rëndomta të tubit të ujitjes së kopshtit dhe të shkrepes. Brenda një harku kohor autobiografik koha ngjishet në disa orë midis drekës e darkës, kurse peizazhi i vjetruar i «kepit», «mullarit të barit» dhe «zabelit» është ngjeshur në hapësirën e një dhome të zakonshme me lulen kryeulur e me këpucët e çorapet të hedhura. Agonia romantike reduktohet në lodhjen e lexuesit. Epoka e Artë shtrihet në pjesën e parë të ditës, pas nesh, përfundimisht e pakthyeshme.

Ajo çka i jep vulën poezisë amerikane mund të përcaktohet nga mënyra e largimit të saj nga poezia e «Botës së Vjetër», siç do të thuhet në librat shkollorë. Poezia mund të jetë amerikane edhe për shkak të të folmeve të saj, peizazhit, shpërfilljes së saj ndaj së kaluarës evropiane, egocentrizmit të guximshëm, qëndrimeve ironike, lirisë nga kadencat shabllone, por mbi të gjitha për shkak të larmisë së saj të pakufishme. Ky tipar i fundit – gjerësia dhe përfshirja e saj demokratike – është shprehur më së miri në një poezi të Luis Simpsonit, i cili, për momentin, meriton t'i kushtohet fjala e fundit në këtë ese.

## POEZIA AMERIKANE

*Çfarëdo që të jetë, ajo duhet të ketë  
Një stomak që të mund të tresë  
Gomën, qymyrin, uranin, hënata, poezitë.*

*Si peshkaqeni, ajo mund të ketë brenda një këpucë.  
Ajo duhet të notojë për milje të tëra përmes shkretëtirës  
Duke lëshuar britma që janë thujse njerëzore. ■*

Shënim: «Sonet Amerikan» dhe «Ngushëllimi» janë botuar së pari në vëllimin *Duke Bredhur i Vetmuar nëpër Dhomë* të Billi Kolinsit (Random House, 2001). «Poezia Amerikane» është marrë nga *Në fund të Krugës së Hapur*. Kopirajti © 1963. Ribotuar me lejen Luis Simpsonit.

**B**illi Kolins është autor i gjashtë librave me poezi, përfshirë *Duke Bredhur i Vetmuar nëpër Dhomë* (Random House, 2001); *Piknik, Vetëtima* (University of Pittsburg Press, 1998), *i cili fitoi çmimin Paterson*; *Arti i të Mbyturit* (University of Pittsburg Press, 1995); *Molla që Mahniti Parisin* (University of Arkansas Press, 1988); dhe *Pyetje mbi Engjëjt* (William Morrow & Co., 1991) *i cili u për zgjodh nga Edward Hirsch për Konkursin Kombëtar të Poezisë.*

*Një vëllim i ri, Nëntë Kuaj, do të dalë në fund të këtij viti. Poezia e Kolinsit është përfshirë në antologji, tekste shkollore dhe në një sërë periodesikësh përfshirë Poetry, The American Poetry Review, Harper's, The Atlantic Monthly, The American Scholar, The Paris dhe The New Yorker.*

*Ai ka marrë bursa nga Fondacioni i Nju Jorkut për Artet e Bukura, Fondacioni Kombëtar për Artet dhe Fondacioni John Simon Guggenheim Memorial. Ka fituar çmimin Bess Hokin, çmimin Frederick Bock, çmimin Oscar Blumenthal, çmimin Wood dhe çmimin Lewinson – të gjithë të akorduar nga revista Poetry.*

*Billi ka marrë gradën e Bakalaurit në Shkencat Shoqërore (B.A.) nga Kolegji Cross si dhe gradën Doktor i Filosofisë (Ph.D.) nga Universiteti i Kalifornisë në Rivërsajd. Është Profesor i Shquar i Anglishtes në Kolegjin Lehman, qyteti i Nju Jorkut, dhe pedagog i jashtëm i krijimtarisë letrare në Universitetin Këlambia. Është emëruar Poet Laureat i Shteteve të Bashkuara për 2001–3. Jeton me gruan e tij Dajane, arkitekte, në Uesgëstër Kaunti, shteti i Nju Jorkut.*



Robert

# Kriili



*A gjallon vallë njeriu  
me një shpirt kaq të  
vdekur*

*Që kurrë ndonjëherë  
nuk ka shqiptuar me  
vete,*

*Kjo është toka ime,  
është vendlindja ime!  
Zemra e të cilit nuk ka  
ndier kurrë zjarrmi  
Teksa ka qenë duke u  
kthyer në shtëpi  
Nga bredhjet e gjata  
në treva të huaja?*

*Nëse dikush kështu  
gjallon, e damkosni,  
pra;*

*Sepse asnjë bard nuk e  
bën dot me krahë;*

*Sado tituj të ketë, sado krenar ta ketë emrin,*

*Mall e gjë pa fund të ketë sa ujët e detit,*

*Me gjithë këta tituj, pushtet e pasuri*

*Ky mjeran i përqendruar veç te vetë e tij,*

*Duke jetuar, do ta humbasë emrin e mirë,*

*Me vdekjen e dyfishtë poshtë ka për të shkuar*

*Në pluhurin e baltën prej nga është gatuar,*

*I paqarë, i panderuar e i pakënduar.*

SËR UOLTER SKOT, «A GJALLON VALLË NJERIU»

Megjithëse këtë poezi të pavdekshme e ka shkruar një anglez, ajo gjithsesi është e tillë që mund të kishte pretenduar fare mirë për qytetarinë e nderit të SHBA për faktin se e mishëron kaq mirë ndjenjën kombëtare. «Ne jemi të fundit njerëz të parë» ka shkruar poeti Çarlz Olson në studimin e tij të ngjeshur *Më Thirr Ishmael* mbi Herman Melvilin. Të krijohet përshtypja sikur Shtetet e Bashkuara, në kuptimin e realitetit të tyre, janë vendi në të cilin të gjithë të tjerët në botë kanë shpresuar të vijnë sepse ai u ka premtuar kaq

intensivisht një shans për ripërtëritje, për një fillim të ri larg të gjitha fakteve të kontestimit të historisë, të gjitha zakoneve e vlerave të vjetra të botës prej nga kanë ikur. Kjo është po aq një ëndërr për ne që jetojmë këtu, siç dëgjohet të thuhet, sa edhe për cilindo imigrant aspirues. Ne të gjithë besojmë se në të ardhmen ky vend do të jetë vendi tek i cili do të dëshironim të ktheheshim.

Jam rritur në një qytet të vogël klasik të Nju Inqlëndit, ku nëna ime ishte infermiere e qytetit (im atë, mjek, vdiq kur unë isha katër vjeç) dhe në shumë aspekte ndihesha i shpërfillur. Së pari, ne nuk ishim nga qyteti, por kishim shkuar atje nga një vend që sot quhet zona e Bostonit. Megjithëse largësia deri në Boston ishte 25 milje, për nga ana kulturore kjo hapësirë nuk ishte pa probleme. Edhe Konkordi, që ndodhej rreth tetë milje larg, ishte shumë larg nga zakonet dhe njerëzit e njohur të fëminisë sime. Kështu, duke u konsideruar si një njeri që i përkiste botës tjetër jashtë Bostonit metropolitan, një qyteti të vogël bujqësor në të cilin, në fakt, kisha kaluar një pjesë të rëndësishme të jetës sime, do të më krijoheshin jo pak pështjellime. Para disa vjetësh shkova atje për të takuar miqtë e mi të vjetër me rastin e ritakimit të 50-të të shkollës së mesme, një festë ku kishin ardhur shumica prej nesh dhe ku pashë se ne, çuditërisht, ishim bërë përsëri «fëmijë» në kuptimin se jeta që kishim kaluar ashtu si kishim mundur tashmë kishte mbetur pas përgjithnjë. Ne u përballëm përsëri me një kohë të re, pleqërinë, dhe ishim aq të brishtë në rrethanat e saj, sa edhe atëherë kur sapo kishim hyrë në burrërinë tonë të parë me të gjitha problemet shoqëruese eksperimentale të seksit dhe të fitimit të jetesës.

Kur isha 14 vjeç, u largova nga qyteti im lindor krejt rastësisht. Ime motër kishte shkuar në Seminarin Northfield për vitin e fundit të shkollës së mesme dhe një shoqe e saj e ngushtë atje kishte një vëlla më të vogël në shkollën episkopale përgatitore Holdërnes në Nju Hempshër. Kështu që motra ime gjeti formularët e aplikimit, e bindi nënën që t'i plotësonte dhe t'i dorëzonte dhe më në fund unë dhashë një provim pranimi dhe shkova. Edhe tani më kujtohet malli përvëlues që ndieja duke i mbajtur letrat e mamasë e të



motrës të pahapura gjersa të gjeja rastin për t'i lexuar dhe për të qarë larg syve të të tjerëve. Por mësuesit ishin jashtë-zakonisht të aftë dhe çfarëdo arsimit të kem marrë, e kam marrë atje. Disa mësimë ishin vërtet të çuditshme, si p.sh. 'përkthimi' në anglisht i pjesëve nga vëllimi i madh me tre-gjime i Xhejms Joisit, *Dublinasit*. Një pjesë e lëndëve ishin klasike të mirëfillta – për shembull mësimi i gjuhëve latine e gjermane – kurse një pjesë tjetër ishte thjesht përvetësim i aftësive bazë për të lexuar e shkruar, për t'u aftësuar në atë që Uiliam Karlos Uiliamsi e quan «çfarë pashë e dëgjova më pas.» Megjithëse kolegji ishte njëfarë burimi informacioni për mua, informacionin më të madh e mora nga shokët, nga ndikimi transformues i Luftës së Dytë Botërore dhe nga dashuria e parë e dallueshme që pata.

Megjithëse vështirë se e dija tamam se kur kisha filluar të shkruaja, me shkrime merresha më fort për të provuar se ç'kishte të qëndrueshme në jetën time të karakterizuar nga ndërrime të pareshtura vendesh e marrëdhëniesh. U martova 20 vjeç. Në moshën 28 vjeç isha përsëri beqar dhe u martova përsëri brenda vitit. 20 vjet më vonë u ndava përsëri, pastaj prapë u martova dhe vazhdoj të jem i martuar. Pyes veten: a është amerikan ky zakon? Para disa vjetësh, Bakminster Fulleri kishte vënë në dukje se një numër amerikanësh që përfaqësojnë një të pestën e popullsisë së vendit ikin çdo vit nga shtëpia. Ç'mund të themi tjetër për veten tonë? Që mendojmë se s'kemi nevojë për asnjë gjuhë tjetër përveç anglishtes (megjithëse, të themi atë që është, ne e dimë se sot në Nju Jork fliten shumë gjuhë, më shumë se kudo në botë!), se nuk kemi nevojë të dimë asgjë për operën ose poezinë ose për shumë gjëra të tjera si këto dhe se, në këtë shoqëri, ne përsëri e ndiejmë veten si në shtëpinë tonë. A është turp të biesh në sy të të tjerëve pse *ipëlqen* gjëra të tilla ose pse zotëron aftësi të tilla? Thënia «një lexim i mirë» do të ishte një shprehje sinonimike me «një vend argëtimi» ose me «paç një ditë të mbarë». Njeriu nuk ka qejf që t'i marrë artet shumë seriozisht, të çdo lloji qofshin.

Robert Grejvz ka shkruar se poezia është ai art për të cilën nuk ekziston asnjë shkollë në kuptimin, me sa e marr vesh unë, se nuk ka ndonjë vend ku mund të shkohet për të bërë praktikë për poezinë. Por Grejvzi kishte pasur një traditë goxha të mirë për mësimë e mbështetje. Sado i ndryshëm të na duket vendi ku ka lindur Ezra Paundi, një «vend gjysmë i egër, jashtë mode», prapë, me sa shihet, shumë poetë amerikanë, si dhe unë, e zgjedhim atë vend si kushtin tonë nga frika se modeli shumë më i sigurt i poezisë angleze do ta zhvendoste krejtësisht vendin tonë të vogël imagjinar që ne e quajmë shtëpi. Brezi ime ka qenë i ndarë prej vitësh midis atyre që kanë ndjekur shembullin e T.S. Eliotit, duke i bërë kështu shërbim një poezie të lëvruar në mënyrë klasike në traditën angleze, dhe atyre si puna ime që ndiqnim me besnikëri Dr. Uiliamsin. Kur e pyetën njëherë Uiliamsin se nga e kishte burimin «e folmja» e tij, ai u përgjigj thjesht: «Nga e folmja e nënave

polake.» Po të përdorim shprehjen e Çarlz Olsonit, ne kemi dashur «t'i lëmë rrenjët të gjalla.» Ne kemi dashur që krijimtaria jonë të ishte fakt për trupin tonë social, provë e personit tonë kolektiv familjar, e nënave, etërve, xhaxhallë-rëve, kushërinjve dhe fqinjëve tanë polakë, irlandezë, italianë, gjermanë, kinezë, afrikanë, francezë, rusë. Për të bërë që përdorimi i burimit të mënyrave tona të të folurit, të retorikave tona, të pranohej, na është dashur një betejë e gjatë dhe ngulmuese. Siç thotë dikush, ne nuk flisnim mirë, ishim vulgarë. Pra, në kontrast me «lëndën e gatuar» sipas formulës së Levi-Shtrausit, ne kemi qenë «lëndë e papërpunuar» dhe kjo ka qenë për ne një kënaqësi e madhe.

Amerika, çfarëdo që të jetë, nuk mund të merret sikur është një vend i vetëm. Unë, për veten time, qëndroj i ngulur thellë në Nju Inglënd, sikur të kisha kaluar atje gjithë jetën, madje më shumë se dikush që e ka kaluar vërtet. Ai vend është *imago mundi* im, është ajo tablo për botën që unë e mbart me vete në përfytyrimin tim. Megjithëse kam udhëtuar pareshtur nga lindja në perëndim e nga veriu në jug duke bërë dy deri në tri mijë milje në çdo drejtim disa herë në vit, unë prapë kam qëndruar në «shtëpi», të paktën në mendjen time, duke menduar se në Boston tani bie borë, apo sa bukur sikur të isha në Mein tani kur gjethet e vjeshtës ndërrojnë ngjyrë. Dhe jam ndodhur përherë në ato vende, sado e ndryshme të ishte gjithçka rreth meje.

Nga ana tjetër, ajo që ka vërtet rëndësi është ajo që ka thënë Uitmani, se një vend duhet t'i përqafojë poetët e vet. «Për të pasur poetë të mëdhenj, duhet të ekzistojnë auditorë të mëdhenj.» Kjo është e lehtë për ta thënë, po thuajse e pamundur për ta realizuar. Poetët renditen shumë poshtë në krahasim me interpretuesit publikë ose me ata që i sigurojnë qeverisë materiale sipas interesit e dëshirës. Nëse ngjarjet e trishtuara të 11 Shtatorit 2001 nxitën një përdorim të dukshëm të poezive si një mjet për të gjetur një terrin të përbashkët për dhimbjen e zemrave, ky vrull kaloi kur vendi e rifitoi ekuilibrin dhe iu drejtua ndërmarrjes së një lufte agresive dhe, duhet pranuar, kur iu rikthye fitimit të parave. Vallë poezia ka një rëndësi kaq të vogël në këtë vend sepse nuk «sjell para», sepse zor se mund të quhet «profesion», apo të paktën «pasion» i arsyeshëm, dhe sepse duket si më e përshtatshme që me të të merren adoleshentët dhe gratë emocionale? A na «thotë» poezia ndonjë gjë me interes? Ç'kuptim ka ajo? Përgjigjet e të gjitha këtyre pyetjeve janë shumë të thjeshta, por nuk gjenden këtu. Këtu më mirë të theksojmë se në Amerikë poezia nxit një reagim pak a shumë të ngjashëm me vargun e parë ironik të Marianë Muërit: «Poezia? As mua s'më pëlqen.» Një artist tjetër dikur ka thënë: «Poetët janë si ata që u bien sazeve të gojës. Të zotët janë, por s'ua kanë fort nevojën.»

**P**ra, të merresh me poezi është si të punosh për orë të gjata në kushte të vështira, në ajër të ndënjur apo në dritë të dobët. Kush do të donte të ishte poet në këtë vend nëse nuk do ta ndiente mirëfilli se duhej të ishte? Dikush më ka folur për një student të mjekësisë, i cili, gjaja-

të kohë së studimeve, u bë trashëgimtar i një pasurie të madhe nga një xhaxha që vdiq papritur. Ngaqë arsyeja për t'u bërë doktor kishte qenë që të bëhej i pasur, sapo u bë i tillë i la studimet menjëherë. Kurse unë vetë di për një njeri tjetër të mjekësisë me të cilin u njoha rastësisht në një bar kur më bëri vend që të ulesha dhe më tha se nuk i duronte dot vështrimet dhe erën e njerëzve. Dukej i neveritur prej tyre. Kur e pyeta se pse ishte futur në shkollën mjekësore pa i njohur më mirë ndjesitë e veta, më tha se nuk i kushtonte vëmendje pacientit, por mjekut tek i cili po specializohej. Ndiqte shembullin tij duke zbatuar çka vendoste ai, kurse pacienti ishte i pranishëm në mënyrë abstrakte. Megjithatë, në klinikën e tij, pacienti do të ekzistonte kokë e këmbë, i vërtetë, me mish e me koeka.

Nëse unë përbëj ndonjë shembull, kjo do të thotë se poetët amerikanë, deri në kohën kur do të shkojnë në varret e tyre respektive, do të vrasin mendjen për atë që janë duke bërë, përse e kanë bërë dhe, nëse e kanë bërë për dikë, për kë. «A është ajo një poezi e vërtetë apo e ke bërë vetë?» Ndofta nga gjithçka që mund të bëjë njeriu, nuk ekziston asgjë që të fitojë një reagim e simpati të tillë të mrekullueshme edhe pse, siç shkruan Uiliamsi, ajo «mbështetet vetëm në ajër.» Poetët amerikanë kanë një

liri vërtetë të rrallë në botën e zakonshme. Ata mund të shkruajnë çfarë të duan në një mënyrë gati të pamundur në vendet dhe kulturat e tjera. Paundi na e bën të qartë se çfarë na ka dhënë kombësia jonë, të paktën në njëfarë kuptimi, duke cituar Remi dë Gurmontin se «kënaqësia e vetme e shkrimtarit është që të shkruajë lirisht çfarë i pëlqen». Jo vetëm që njeriu mund të shkruajë në atë kuptimin e dobishëm të «lirisë» megjithë kufizimet e saj, por ai mund t'i marrë fjalët nga një gamë marramendëse retorikash – të larta, të ulëta, shtëpiake, profesionale – me të gjitha tonet e ngjyresat e tyre. Në dallim nga kjo, një miku im gjerman më ka thënë dikur se Gynter Grasi nuk kuptohej pikërisht nga punëtorët e thjeshtë, nga personat për të cilët romanet e tij të mrekullueshme ishin «zëra». Gjuha artistike e përdorur në shkrimet e tij ishte gjermanishtja «letrare». Punëtorët flisnin në një të folme që ishte shumë larg kësaj gjuhe. Në Angli, Uindhëm Ljuisi shkruante se njerëzit kishin nga «një damkë dalluese në gjuhë.» Klasa, arsimit dhe shtresat e përcaktuara ndikonin në mënyrë të jashtëzakonshme në mundësitë e poetit aspirues të asaj kohe, gjë që vazhdon edhe sot pa ndonjë ndryshim të madh.



*Uollit Vitman*



*Emili Dikinson*



*Ezra Paund*

Unë, përgjithësisht, më fort respektoj lokalizmin e theksuar që më ka dhënë prejardhja ime nga NjuInglëndi – dhe Amerika. Mbase shprehja më e mirë do të ishte vetëshqetësimi, ajo çka, në rastin më të mirë, del në pah në atë *tour de force* që krijon Uitmani në poemën «Këngë për Vetën Time», një poemë që është kaq shumë e këtij vendi dhe kaq zbulimtare. Apo, në të njëjtin kuptim, është mënyra e qetë në të cilën shkruan Emili Dikinsoni, qartësia e saj e mahnitshme për jetën që jetojmë çdo ditë në mendjet dhe trupat që na janë dhënë. Ajo u rrit në Amherst, Masaçusets, rreth 70 milje në perëndim të Ektënit, vendlindja ime. Kemi edhe Henri Throun, i cili, për vendin ku ka jetuar, ka thënë: «Kam udhëtuar shumë në Konkord», domethënë deri në fund të rrugës.

Është gjenia e këtij vendi që ka krijuar një poezi lirike të një larmie e fuqie unike. Ndofta edhe në vende të tjera ka poetë që e kanë arritur autoritetin e saj, por asnjë komunitet poetësh nuk ka shkruar kurrë kështu, me kaq gjerësi e dallueshmëri, sa ata të botës sime. Nëse ndonjëri karakterizohet – dhe në SHBA dikush, njeri apo poet, *doemos* karakterizohet – nga pavarësia dhe individualiteti i natyrshëm për të cilat kultura jonë ngulmon aq shumë që t'i ketë megjithë izolimin e dhimbshëm që kjo gjë shkakton, atëherë

*E ka bërë me qëllim apo jo, është pikërisht Amerika ajo që më ka dhënë këta miq të përhershëm të zemrës e të mendjes sime. Ne të gjithë kemi jetuar pikërisht këtu.*

poezia lirike – poezia e një ekzistence të veçantë, kalimtare – duhet të jetë burimi i tij ose i saj më i madh. Kështu që gjatë gjithë jetës sime unë kam jetuar me mjeshtërit e saj të përhershëm – Uiliamsin, Dikinsonin, Paundin, Uitmanin, Poun, H.D.-në, Stivensin, Luis Zukovskin, Çarlz Olsonin, Robert Dankënin, Allen Ginzbergun, Denis Levertovin, Eduard Dornin. Lista zgjatet e zgjatet. E ka bërë me qëllim apo jo, është pikërisht Amerika ajo që më ka dhënë këta miq të përhershëm të zemrës e të mendjes sime. Ne të gjithë kemi jetuar pikërisht këtu. ■



Ralf Ualdo Emerson

**P**oeti amerikan veteran Robert Krili është me emër në të gjithë botën dhe njihet prej shumë vjetësh si një poet me prodhimitari të gjerë. Ai ka botuar mbi 60 vëllime me poezi, përfshirë: Tamam në Kohë: Poezi 1984–1994 (*New Directions*, 2001), Poezi të Zgjedhura 1945–1990 (*London and New York*, 1991) si dhe shumë vëllime të tjera që zënë fill në vitet 1950. Ai ka botuar edhe një roman *Ishulli* (1963) si dhe mbi dhjetë libra me prozë e ese. Ai ka redaktuar veprat poetike të Çarlz Olsonit si dhe përmbledhjet e Robert Bërnshit dhe të Uollt Uitmanit. Krijimtaria e tij është botuar në shumë revista, përfshirë Poetry.

Ndër nderimet që ka marrë përfshihen Medalja Frost, çmimi Shelley Memorial si dhe grante e bursa nga Fondacioni Kombëtar për Artet, Fondacioni Rokfeler dhe Fondacioni Gugenheim. Nga viti 1989 është profesor me titullin Samuel P. Capen i Poesisë dhe i Lëndëve Shoqërore në Universitetin Shtetëror të Nju Jorkut në Bafëlo. Më 1999 u zgjodh kancelar i Akademisë së Poetëve Amerikanë.

Krili u lind më 1926 në Arlington, Masaçusets, dhe në fëmëni mori një bursë për në një shkollë të vogël private në Nju Hempshër, një ngjarje për të cilën thotë se i siguroi shkollimin e tij të rregullt. Më 1943 hyri në Universitetin e Harvardit, kurse në vitet 1944–45 punoi në Shërbimin Amerikan të Terrenit në Birmani e Indi. Më 1946 filloi të botojë poezi. Në fund të viteve 1940 dhe fillim të viteve 1950 nisi korrespondencën me Uiliam Karlos Uiliamsin, Ezra Paundin si dhe një shkëmbim të gjerë letrash me poetin Çarlz Olson. Më 1954 shkoi tek Olsoni në kolegjin Blek Mauntin, një kolegj i arteve eksperimentale në North Kerëljajnë, ku redaktoi Black Mountain Review. I konsideruar si pjesë e shkollës moderniste të letërsisë sipas shembullit të Paundit dhe Uiliamsit, Krili është i lidhur në ton e teknikë me bashkëmoshatarët e tij Olson, Robert Dankën, Allen Ginzberg, Denis Levertov, Eduard Dorn e poetë të tjerë.

Jeta dhe krijimtaria e Krilit prirën drejt shprehjes së «kundërkulturës» letrare, veçanërisht asaj amerikane që lindi në radhët e inteligjencës në vitet 1950 e 1960. Në fëmëni, përpara moshës 5-vjeçare, Krili humbi të atin; megjithatë e përballoi jetën me guxim duke e shuar kureshtjen paresh-tur dhe duke u njohur me vende e kultura të tjera. Në vend që të stabilizohej në një qytet dhe të jepej pas një karriere fitimprurëse, ai ishte përherë në lëvizje duke parapëlqyer të jetonte në një fermë bujqësore në Nju Hempshër, të botonte poezi në Majorka, të jepte mësimë në Nju Meksiko, mësimë private në një plantacion guatemalas dhe në British Këlambia dhe të ushtronte mjeshtërinë e të shkruarit në Bolinas, Kaliforni.

Në një artikull mbi Krilin në revistën Oxford Companion to Twentieth-century Poetry in English, shkruhet: «Poezia e Krilit është kryesisht e angazhuar me dashurinë dhe emocionet që lindin nga marrëdhëniet intime. Ndër ndikimet e tij më të fuqishme ai rendit jo vetëm poetët [përfshirë Allen Ginzbergun] që e risiguruan se «ju mund të shkruani drejtpërdrejt atë çka ndieni», por edhe muzikantët e shazit që i vërtetuan se ndjenjat mund të shprehen jo më pak fuqishëm duke iu shmangur formave të paravendosura.»



# Deivid Herbert Donald



Kur isha duke përfunduar biografinë time mbi Abraham Linkolnin, agjenti im letrar kontaktoi një sërë botuesish britanikë me synimin për ta botuar librin në Angli. Asnjëri nuk shprehu ndonjë interes të madh. Më në fund një nga shtëpitë botuese më me emër të Londrës pranoi që ta botonte librin, por pa shprehur kurrfarë entuziazmi.

Kryeredaktori më shkruante se nuk kisha pse të prisja ndonjë shitje të madhe në ishujt britanikë. Ai më paralajmëroi se gjasat ishin që një libër mbi Abraham Linkolnin në Angli mund të shitej në aq kopje, sa ç' do të shitej në Amerikë një libër mbi Lordin Shaftsbëri.

U mërzita. Në fund të fundit, libri që kisha shkruar nuk ishte mbi ndonjë figurë amerikane të errët, ndonëse të denjë, të shekullit të 19-të, si fjala vjen për Tomas Hart Bentonin apo Benxhëmin Herrisonin. Ai ishte për Abraham Linkolnin, që pa dyshim ka qenë presidenti amerikan më i madh. Duke udhëhequr Veriun në fitore gjatë Luftës Civile, duke hequr skllavërinë dhe duke ruajtur paqen me fuqitë evropiane gjatë konfliktit, ai u bë një figurë me rëndësi jo vetëm kombëtare, por edhe ndërkombëtare, i admiruar nga burra të shquar si Uinston Çërcilli apo Martin Luter King i Riu. Lev Tolstoi e ka quajtur «Krisht në miniaturë, shenjt i njerëzimit.»

Pasi e blova me vete këtë fyerje për disa javë, më në fund pranova pa qejf, të paktën përpara vetes sime, se botuesi snob londinez kishte një bazë që, për fat të keq, e përforconte shitja e mjeruar e librave në Angli. Problemi

për të ngjallur interesin e një auditori të huaj të madh me një libër mbi Linkolnin nuk kishte të bënte aq me subjektin, siç kishte menduar redaktori, se sa me parashtrimet që kisha bërë unë gjatë shkrimit të tij. Duke iu drejtuar së pari auditorit amerikan, unë kisha prekur shkarazi disa ngjarje të rëndësishme të historisë së SHBA, si për shembull Kompromisin e Misurit dhe vendimin gjyqësor mbi çështjen Dred Skot, apo së paku gatishmërinë për të zhbluar çështje të tilla të koklavitura si Shpallja e Çlirimit nga skllavëria apo Amendamenti i Trembëdhjetë. Këto parashikime dolën jorealiste.

Kisha bindjen se mbi këto çështje kisha shkruar si historian, si një njeri që i përkiste një vëllazërie ndërkombëtare, e cila kishte një sërë tezash të përbashkëta dhe praktikonte pak a shumë të njëjtat teknika, siç bëjnë shkencëtarët në të gjitha vendet. Mirëpo, krejt ndryshe, unë zbulova se kisha shkruar si historian amerikan. Madje arrita në përfundimin se të gjithë librat e mi kishin të përbashkët po këtë tipar: qenë libra amerikanë, të shkruar nga një historian amerikan.

Nuk është e lehtë të përcaktosh me saktësi se ç'i bën shkrimet e mia qartazi amerikane. Mënyra më e thjeshtë do të ishte të vija në dukje se ato, thuajse pa përjashtim, janë të gjitha me subjekte amerikane: lufta mes nacionalizmit e separatizmit në Amerikën e shekullit të 19-të; Lufta Civile Amerikane; procesi i Rindërtimit pas asaj lufte. Por edhe të gjitha biografitë e mia kanë pasur në qendër amerikanët, disa nga të cilët me reputacione kaq lokale, sa që vështirë të mendosh se do t'u interesonin lexuesve të tjerë veç atyre amerikanë. Uiliam H. Herndon, ortak me Abraham Linkolnin në firmën e tyre juridike dhe një nga biografët e tij më të hershëm, megjithëse njeri me interesa të gjera, ka qenë një figurë më e vogël. Ende pa u bërë Sekretar i Thesarit i Abraham Linkolnit, Salmon P. Çejsi gëzonte një reputacion të kufizuar si politikan i antiskllavërisë në Ohaio. Mbase reputacioni më i madh i Çarlz Frensis Adamsit ka qenë si ministër i SHBA në Britaninë e Madhe gjatë Luftës Civile, por edhe ai mbahet mend, nëse mbahet, si bir e nip i presidentëve amerikanë. Çarlz Samëri, senatori i fuqishëm abo-



licionist i Masaçusetsit përgjerohej që t'i ngjante një aris-tokrati britanik, po sot zor se ka anglezë që t'i kenë dëgjuar të paktën emrin.

Por zgjedhja e një subjekti jo doemos tregon kombësinë e një historiani. Tekefundit, një nga biografitë e para më të mira të Abraham Linkolnit, që akoma ka vlerë, është shkruar nga një anglez, Lordi Çarnud. Kurse Bazil Litëll Hart, Kolin Ballërd dhe G.F.R. Henderson, që të gjithë anglezë, kanë shkruar disa nga studimet ushtarake më të mira mbi Luftën Civile Amerikane. Një vepër e vëllimshme e historianit italian Raimondo Luragi është një nga historitë e përgjithshme më të mira të Luftës Civile.

Ndoshta përdorimi i gjuhës nga ana ime është një tregues akoma më i mirë se unë nuk shkruaj thjesht mbi subjekte amerikane, por se jam vetë amerikan. Unë përdor kryesisht anglishten standarde, por, kur është nevoja, kënaqem me fjalë e shprehje dallueshëm amerikane. Për shembull, në një nga mesazhet e tij në Kongres Linkoln i quajti shkëputjen si një «rebelim i Iyer me sheqer» dhe tha se në një betejë trupat e Konfederatës «ua mbathën e u zhdukën.» Senatori Samër e kishte qortuar Linkolnin për vulgarizim të gjuhës angleze, por unë i kam cituar shmangiet e tij me kënaqësi të madhe. Mua më pëlqejnë edhe disa neologjizma amerikane. Kur Herndoni shkroi për kortet e ndërlikuara të Linkolnit ndaj Meri Todit dhe për planet e tyre të martesës me të sotën e të nesërën, ai shtoi kapitullin «Belaja e Martesës.» Këtë fjalë e kam menduar gjithnjë si një fjalë më të mirë, më amerikane se fjala «ngatërrësë» dhe e kam përdorur shpesh. Po ashtu, sa herë që mundem, më pëlqen të citoj gjuhën e folur të amerikanëve të pashkolluar, e cila shpesh ka një forcë e qartësi që do të humbishte po të ndiqeshin rregullat e gramatikës angleze. Unë gjej diçka të drejtpërdrejtë dhe interesante në një pohim si ai i Denis Henksit, kushëriri i Linkolnit nga fshati, që e këshilloi Herndonin se çfarë të përfshinte në biografinë e Linkolnit: «Pra, Uiliam, mos e çaj kryet, po nxire në shesh emrin tim dhe puna ka për të të ecë [dmth ecur] mirë.»

## II

Por formimi im amerikan ka ndikuar edhe në një drejtim tjetër mbi mënyrën se si unë e shkruaj historinë. Një vëzhgues i paanshëm, duke pasur parasysh detyrën e palakmueshme të rivlerësimit të listës sime të gjatë të botimeve që shtrihen nga vitet 1940 në ditët e sotme, do të arrinte me të drejtë në konkluzionin se librat e mi nuk kanë pasur një strukturë të qartë e koherente. Në ditët e mia të hershme si historian unë kam qenë i magjepsur nga mundësia e lidhjes së disiplinës sime me sociologjinë dhe në një sërë esesh të botuara si *Vështrime të Reja mbi Linkolnin* jam përpjekur të analizoj origjinën sociale të lëvizjeve reformuese amerikane të shekullit të 19-të dhe atë të mbrojtjes që i bënte Jugu skllavërisë. Më pas më lindi një interesim i thellë për psikologjinë, veçanërisht psikanalizën, me rezultatin që biografia ime për Çarlz Samërin arriti të bëhej ajo çka një recensues e quajti biografinë më frojdiste që kishte lexuar.

Megjithatë, rreth kësaj kohe po më tërhiqnin zhvillimet e reja në historinë kuantitative, kështu që në veprën *Politikat e Rindërtimit* bëra përpjekje që atë periudhë ta vizatoja në një sërë skicash. Pas kësaj fillova të lexoja kritikë letrare dhe shkrova biografinë për Tomas Ulfin, romancierin jugor të shekullit të 20-të. Disa nga kolegët e mi i kanë quajtur këto kalime në tematikë e metodologji si të pakuptueshme e madje shqetësuese. Një miku im i vjetër, Artur S. Link, i cili e ka kaluar të gjithë karrierën e tij shkencore të shquar duke rigjurmuar karrierën e Uidrou Uilsonit, një herë më ka qortuar për ndryshimet e paargumentuara në pikëpamjet e mia. «Deivid,» m'u drejtua me të butë, «problemi yt është se nuk je historian serioz.»


Lidhur me këtë akuzë e pranoj se në njëfarë shkalle jam fajtor, sepse kam shkruar për gjithçka që më ka interesuar duke përdorur gjithfarë mjetesh që kam pasur mundësi t'i gjej dhe kam shkruar atë që më pëlqente të shkruaja dhe jo atë çka mendoja unë – apo dikush tjetër – se duhej shkruar. Kjo, them unë, është një mënyrë tipike amerikane. Në rastin tim ajo ka buruar nga përvoja që pata me një udhëtim të gjatë me autobus gjatë viteve të mia si student pasuniversitar. Duke u nisur nga Bregu Lindor udhëtova orë pas ore e ditë pas dite me autobusin që troshitej dhe që na çonte përmes maleve Apalashë në qytetet industriale të Perëndimit të Mesëm, përmes Pllajave të Mëdha të pafundme dhe terrenit malor mrekullisht të bukur gjersa më në fund arritëm në Kaliforni. Nga kjo aventurë zë fill dashuria ime me peizazhin amerikan në të gjithë larinë e tij. Ky udhëtim i gjatë më detyroi të kuptoja hapësirën e pamatë të vendit tonë dhe në takimet e mia ditë pas dite me bashkudhëtarët e mi të të gjitha racave dhe të dyja gjinive nga të gjitha anët e vendit, arrita të njihja larinë e pafundme të jetës amerikane.

Kjo larmi më ka dhënë – siç u ka dhënë, sigurisht, shumë shkrimtarëve amerikanë të tjerë – edhe shumë vend për eksperimentime në lëndë, tematikë e metodë. Nuk ka ndonjë traditë sunduese të vetme historiografike; nuk ka ndonjë rrugë të vetme që duhet të ndjekin historianët aspirues. Vetë larmia e krijimtarisë sime është treguesi më i mirë se si të qenit amerikan ka ndikuar në karrierën time si historian.

## III

Megjithatë, brenda kësaj larmie mendoj se ekziston një unitet i fshehtë që është gjithashtu qartazi amerikan – ose të paktën karakteristik për Shtetet e Bashkuara Jugore, ku unë jam lindur e rritur. Cilado qoftë metoda ose tema ime, pavarësisht nëse përpiqem të bëj një studim kuantitativ për Kongresin e Rindërtimit ose një zbërthim letrar të romaneve të Tomas Ulfit – unë gjithmonë jam përpjekur të tregoj një histori që lexuesve do t'u dukej interesante, me aktorë që ata do t'i quanin të besueshëm.

Kjo traditë e të treguarit të historive ka qenë përherë e fortë në Jug. Thuajse çdo familje në Misisipi, vendlindja ime, ka tregimtarët e saj të historive – ka, si të thuash, arki-



*Duke udhëhequr Veriun në fitore gjatë Luftës Civile, duke hequr skllavërinë dhe duke ruajtur pagën me fuqitë evropiane gjatë konfliktit, ai u bë një figurë me rëndësi jo vetëm kombëtare, por edhe ndërkombëtare, i admiruar nga burra të shquar si Winston Çerçilli apo Martin Luter King i Riu.*

vistët e saj të kujtimeve familjare dhe të legjendave. Ato zakonisht kanë qenë gra të moshuara, kujtimet e të cilave shtrihen pas në kohë, gati që në fillim të botës. Ato i kanë ditur të gjitha ndodhitë familjare: se si stërstërgjyshi kishte sjellë gruan e vet dhe tre fëmijët përmes maleve Apalashë

dhe luginës Misisipi mezi duke u shpëtuar cubave indianë; se si stërgjyshi ishte mobilizuar në Ushtrinë e Konfederatës dhe kishte luftuar derisa ishte plagosur në betejën e Çikamaugës; se si gjyshi e kishte tronditur familjen duke u martuar me një vajzë janki – e quajtur kështu pasi ishte lindur

në veri, përtej vijës Meson-Dikson. Ndërkohë që rritesha, dëgjoja epikat që rrëfenin tregimtarët – me hollësinë më të madhe dhe përherë me të njëjtat fjalë – se çfarë kishte veshur aksh figurë e aksh historie, çfarë kishte thënë e kishte bërë.

Këta ushtrues të panjohur të historisë gojore kanë qenë tregimtarë që i tregonin rrëfenjat me mjeshtëri të rrallë e me lezet të madh. Ata nuk bënin thjesht një renditje të fakteve, por i ndërtonin historitë me art duke i çuar ngjarjet përherë në një kulm. Pikërisht kjo traditë e fuqishme gojore është futur shumë thellë në pjesën më të mirë të letërsisë moderne jugore. Ajo u ka dhënë strukturën themelore romaneve të mëdha të Uiliam Folknerit. Dhe është pikërisht kjo traditë ajo që u jep një vërtetësi kaq të madhe tregimeve të Judora Ueltit.

Sigurisht, kjo traditë ka ndikuar edhe në qasjen time kundrejt historisë, siç ka ndikuar edhe te shumë nga historianët më të mirë të Jugut. Ndonëse unë jam kualifikuar në metodat më të mira «shkencore» të kërkimeve historike dhe jam mësuar të trajtoj forca të gjera pavetore si «klasa», «kasta», «kapitalizmi», «feudalizmi» e të tjera si këto, kam vënë re se kur ulesha realisht për të shkruar, mendja më shkonte te gjedhet e vjetra të të rrëfyerit, të cilat kërkojnë që figurat reale të së kaluarës të jenë të perceptueshme e të kuptueshme nga lexuesit.

Edhe në mekanikën e të shkruarit vë re në veten time se jam ndikuar nga kjo mënyrë e dallueshme amerikane, mbase jugore amerikane, për të treguar një histori. Unë kompozoj në tastierën e kompjuterit tim duke bërë pauza sa herë që përfundoj plotësisht çdo fjalë duke u siguruar që si zëri, edhe kuptimi, të përçojnë mendimin që dua. Nëse nuk ia kam arritur, e fshij fjalinë e pagoditur dhe filloj përsëri. Ka raste kur shqiptoj me zë nja dhjetë variante të një shprehjeje ose fjalie gjersa arrij atje ku dua. Nganjëherë kjo praktikë më ka krijuar situata komike. Një herë, kur ndodhesha në studion time duke shkruar biografinë për Tomas Ulfën, dy marangozë miqësorë po bënin ca rregullime në dhomën tjetër. Ata bënë një pushim për kafe në oborrin e pasëm në një vend nga ku mua nuk më shikonin, por mund të më dëgjonin.

Marangazi më i vjetër pyeti shokun me shqetësim: «More, mos nuk është në rregull ai?»

«Nuk ma merr mendja,» u përgjigj më i riu, «veç nuk e di pse ulet përpara asaj makine për orë të tëra e flet me vete.»

Unë mbase «nuk jam në rregull» – por më pëlqen të mendoj se aftësia ime e të treguarit të historive mbart një traditë të gjatë. Dhe ajo është një traditë e dallueshme amerikane. ■

**D**eivid Herbert Donald është Profesor me titullin Charles Warren i Historisë Amerikane dhe Profesor i Merituar i Qytetërimit Amerikan në Universitetin Harvard.

*Deivid Herbert Donald u lind në Misisipi dhe një pjesë të mirë të jetës ia ka kushtuar të shkruarit dhe mësimdhënies mbi epokën e Luftës Civile Amerikane. Veç Harvardit ka qenë profesor edhe në Universitetin Këllambia, Universitetin Princeton, Universitetin Oksford dhe Universitetin Xhons Hopkins. Ka fituar dy herë çmimin Pulitzer në biografi për veprat Çarlz Samëri dhe Ardhja e Luftës Civile (1960) dhe Me Sytë drejt Vendlindjes: Jeta e Tomas Uolfit (1987), por më shumë është i njohur për veprën Linkolni (1995), një biografi që u fut në listën e veprave bestsellër të New York Times për 14 javë.*


*Ndër librat e tjerë të tij përfshihen Herndoni i Linkolnit (1948; botim i rishikuar, 1989); Luftuam të Ndarë: Një Histori Piktorike e Luftës, 1861–1865 (1952); Brenda Kabinetit të Linkolnit: Ditarët e Luftës Civile të Salmon P. Çejstit (1954); Vështrime të Reja mbi Linkolin: Ese mbi Epokën e Luftës Civile (2001); Lufta Civile dhe Rindërtimi [me Xhin Harvei Bejkër dhe Majkëll F. Holt] (2000); Politikat e Rindërtimit, 1863–1867 (1965); Çarlz Samëri dhe të Drejtat e Njeriut (1970) dhe Linkolni në Vendlindje (1999).*

*Z. Donald u lind në Gudman, Misisipi, në 1 tetor 1920, biri i Ira Ungar Donaldit, një plantator pambuku, dhe Sou Ella (Belford) Donaldit, mësuese. Pasi ndoqi shkollat vendore, shkoi në kolegjin Holmz Xhunior në po atë qytet. Pastaj vazhdoi kolegjin Millsaps në Xhekson, Misisipi, nga i cili u diplomua me ulerësimet më të larta më 1941. Më pas ndoqi kualifikimin pasuniversitar në histori e sociologji në Universitetin e North Kerëljans dhe Universitetin e Illinoisit, nga ku më 1942 mori gradën M.A. (Master i Lëndëve Shoqërore) dhe më 1945 gradën Ph.D. (Doktor i Filozofisë). Në Universitetin e Illinoisit ka qenë ndihmëskërkues i shkencëtarit të madh të Linkolnit, Xh.G. Rendëllit. Pas disa posteve në mësimdhënie shkoi në Universitetin Harvard, ku dha leksione gjersa doli në pension më 1991.*

*I martuar me Dr. Aida Dipejs Donaldin, kryeredaktoren e Harvard University Press tani në pension, Donaldi banon në Linkolin, Masaçusets.*



# Ricard Ford



Sigurisht, kjo është një pyetje që më së pari rrotullohet rreth vetes, një gjëgjëzë letrare «pula-apoveza.» Vetëm po ta shikojmë problemin më gjerë do të kuptohet se ku e kam fjalën: si ka ndikuar të qenët rus te Çehovi? Si ka ndikuar të qenët grua te Virxhia Ulfi? Si ka ndikuar të qenët një detar trupxhuxh në prononcimet publike të Popajit,

i cili më në fund e gjen përgjigjen dhe e shpreh fare mirë: «Unë jam ky që jam. Kaq jam e pikë.»

Për të zbrërthyer këtë logjikë më duhet të hamendësoj ndonjë përgjigje tjetër dhe jo të them ndonjë që tashmë ekziston. Kjo është përgjithësisht detyra e romancierit: të shkojë drejt së resë përtej së dukshmes, të krijojë një vetëdijë të re, t'ia shtojë atë inventarit të realitetit ekzistues, të çajë detin e ngrirë brenda nesh – në çdo mënyrë që ai përfytyron se arrihet e reja.

Së pari duhet të shtjellojmë dy çështje paraprake, të cilat, që të dyja, u përkasin çështjeve joamerikane. Në përgjigje të pyetjes së shtruar që në titull: *Si ndikon të qenët amerikan në shkrimet e mia?* – dikush mund të thoshte: «Shiko, të jesh amerikan do të thotë të ndihesh i lirë për të shkruar çdo gjë që ke qejf, ndaj dhe unë kështu kam bërë. Q.E.D.» (Por kjo duhet vërtetuar). Po a nuk do të kisha bërë unë të njëjtën gjë edhe në Danimarkë, Kanada apo Britani si qytetar i tyre? Në rastin e SHBA kjo është e vërtetë, por jo vetëm për këtë vend. Dhe së dyti, megjithëse fakti që jam amerikan mund të më ketë bërë shkrimtar dhe i ka vulosur përpjekjet e mia në mënyrë të pashlyeshme,

ky fakt jo detyrimisht më ka bërë një shkrimtar më të mirë se në ndonjë vend tjetër. Një vështrim në letërsinë botërore flet për këtë. Me sa ma merr mendja, mund të isha bërë më i mirë po të isha francez.

Unë nuk e mbaj mend se kur e kam kuptuar së pari se jam në Amerikë. Në moshën 6 vjeç jam betuar përpara flakurit për besnikëri. Në moshën 18 vjeç jam thirrur në shërbimin ushtarak. Në moshën 20 vjeç jam futur në Marinë. Megjithatë jam i sigurt se shumë kohë përpara se të ndodhnin të gjitha këto kam qenë mëse i vetëdijshëm se mbi të gjitha isha misisipas – në fakt xheksonas – pra një jugor, një *djalë* nga prindër që nuk ishin nga Misisipi, por nga Arkanzas dhe kështu paksa ndryshe nga unë. Sigurisht, të gjitha këto identitete vendore presupozojnë se unë jam amerikan, pasi Republika e këtij vendi, parimet që ajo mishëron, i *përmbajnë* të gjitha të tjerat. Kësisoj, pra, gjithçka që lidhet me mua e me krijimet e mia dhe që unë ia atribuoj faktit që jam jugor etj., mund t'i atribuohen – sipas një logjike analoge – të qenit tim amerikan.

Në periudhën viteve 1940–50, në kohën e rritjes sime në Misisipi, gjendja shpirtërore e besnikërisë së Jugut ndaj pjesës tjetër të kombit amerikan ka qenë shumë ekuivoke. Depresioni dhe Lufta e Dytë Botërore sapo kishin mbaruar. Një kushërirri im ndodhej në Përl Harbër (në familjen time bisedohej për të gjatë darkës). Lufta e Koresë kishte filluar. Komunizmi po shikohej si kërcënim ndaj asaj çka shumica e jugorëve e identifikonin me sigurinë kombëtare, në mos me krejt identitetin tonë. Prindërit e mi votuan. Ruzvelti dhe Trumani qenë presidentët tanë. Unë u betova për besnikëri. Amerika ishte jona dhe ne i përkisnim asaj – të paktën për qëllimin e ruajtjes dhe të mbrojtjes së saj.

Megjithatë, kur fjala ishte për çështje të tjera të rëndësishme socio-politike – veçanërisht për racën, të drejtat e votimit, mundësitë e barabarta, hyrjen e lirë në bollëkun amerikan dhe në themelimin kushtetues origjinal amerikan të quajtur federalizëm, të njohur rajonalisht si «të drejtat e shteteve» – njeriu ndiente se shumë njerëz në Jug mund të kishin dashur më mirë që t'i përkisnin një atdheu krejt tjetër: për shumë të bardhë, Afrikës së Jugut ose Paraguajit;



për zezakët, Francës ose Suedisë. Nga të gjitha anët, këto çështje me rëndësi jetësore si të qenët amerikan, besimi të qëllimet e deklaruara për jetën, lirinë dhe kërkimin e lumturisë u bënë çështje shqetësuese, kundërthënëse, të debatueshme e nganjëherë të rrezikshme për shëndetin.

Pranimi i ndrojtur i identitetit kombëtar nga ana e dikujt dhe të folurit e tij me vete për të është, pa dyshim, vetëm një shfaqje e të pasurit një identitet. Ç'është e vërteta, për t'u përqendruar më intensivisht në *frytet* e përkatësisë, ne amerikanët tradiconalisht kemi pasur qejf që ta quajmë një pjesë të mirë të identitetit tonë si të natyrshëm. Ai është një qëllim i shprehur qartë i formës sonë republikane të qeverisjes në mënyrë që qytetarët të mos preokupohen aq fort për mekanikën dhe filozofinë e qytetarisë, se sa për të *vepruarit* – qoftë edhe pa shumë përkushtim – si qytetarë. Pra, identiteti kombëtar është një mjet për qëllimin e lirisë vetjake, jo qëllim në vetvete.

Kurse për mua, në vitet e formimit tim në periudhën 1950–1962 në Misisipi, në Jug, që të isha amerikan dhe të merrja identitetin tim kombëtar do të thoshte që të isha i paraangazhuar (dhe krejt i përkushtuar) si dhe të përfshihe-sha edhe në një vorbull ndjenjash të zjarra, të debatuar publikisht e tejet serioze, edhe në një vorbull idesh konkurruese mbi qytetarinë amerikane. Boshti i këtij debati ishte: si ta harmonizoj unë përkatësinë time me këtë vend të lindjes sime kur ky vend dukej i prirur për shtypjen e asaj çka unë besoja se janë të drejtat e mia më themelore dhe detyruesisht më të patjetërsueshme të individit? Për segregacionistët e bardhë, kjo e drejtë e presupozuar ishte ajo që u jepte të drejtën për të veçuar e ndarë ata që ishin ndryshe prej tyre; kurse për zezakët dhe integralistët e bardhë, e drejta kundërshtuese ishte ajo që i çlironte ata dhe u jepte liri për të shkruar ku të donin dhe të shoqëroheshin me këtë donin pa frikë se do ta pësonin po qe se bënë kështu. Në këtë pëshqjellim dhe në debatin që e shoqëronte atë – një debat i gjatë i quajtur Lëvizja Amerikane për të Drejtat Civile – shumë njerëz humbën jetën që drejtësia dhe e drejta të fitonin, gjë që ndodhi, ndonëse jo përsosmërisht.

Unë kurrë nuk e kam pasur të lehtë të gjykoj qëndrime, njerëz, sjellje, cilësi karakteri, përvojë ose besim nëse janë «tipike amerikane» apo jo. Kur ndodhem në një vend tjetër dhe dikush që lexon librat e mi më pyet nëse ndonjë krijim imi është tipik amerikan, unë ngurroj. Pastaj them: përfytyro sikur fluturon në helikopter mbi një periferi amerikane dhe shikon një njeri me kasketë duke kositur lëndinën e tij. Sigurisht që ai do të dukej një amerikan tipik. Kush është ai? (Mund të mendojmë se e dimë.) Po kur i afrohem dhe ia heqim me delikatesë kapelen zbulojmë se ai është një imigrant pakistanez, por mund të ishte edhe një ganez i brezit të tretë apo një kinezo-amerikan. Dhe rruga që e ka sjellë atë njeri në lëndinën e tij në këtë vend, në këtë ditë, i zbeh shumë nocionet e tipikes dhe shfaq prirjen për të zbehur ose përjashtuar cilësi specifike që nuk përputhen. Në këtë mënyrë, përsa i përket specifikes, përgjithshmëria

del e mangët – gjë që përbën argumentin se letërsia e madhe synon të vërtetohet: ne mund të shikojmë më qartë duke parë më nga afër – dhe kështu duhet bërë.

Nëse mund të thuhet se përvoja ime e rritjes në Misisipi në vitet 1950 është deri diku më tipike amerikane se përvoja e imigrantit pakistanez kjo, sigurisht, është e dyshimtë. Unë jam amerikan sa ç'është edhe ai. Përvoja jonë është përvojë amerikane ose pjesë e saj: është trazirë (në rastin tim), është një përvojë e ndërlikuar dhe e papërcaktuar e qytetarisë, është identitet kombëtar dhe rajonalizëm përçarës – që të gjitha joplotësisht të zbutura nga një idealizëm i gjerë politik i tillë që, ndërsa përpigjet të shtypë e të ndrydhë sa më pak që të jetë e mundur, përfshin shumë. (Mbase duhet të pranoj se imigranti dhe unë kemi më shumë gjëra të përbashkëta nga ç'mendoja.)

Pra, si i frymëzohet përvoja ime librat që kam shkruar?

**N**dofta më mirë do të ishte të thosha «do t'i kishte frymëzuar» ato që kam shkruar, përderisa të gjurmohesh shprehjen letrare nga njëri cep i imagjinatës njerëzore në tjetrin, nga cepi ku ajo nuk është gjë tjetër veçse rastësi e ndjesi deri tek cepi ku ajo bëhet diçka (një tregim), është spekulative, shpesh e rreme. Madje, aftësia ime e pamjaftueshme për të dalluar synimet e mia nga arritjet e mia konkrete, dëshira ime për të lakuar atë që tashmë kam shkruar për të «provuar» një ndikim si dhe i gjithë kuptimi im si autor për atë që kam shkruar në dallim nga se si e kupton atë një lexues – të gjitha këto nuk më bëjnë vërtëtarë më të çinterësuar apo më dallues.

Prandaj, për të folur pak e sak, po them vetëm pak gjëra.

Në një letër dërguar kolegut të tij amerikan Filip Roth, romancieri çek Milan Kundera shkruante se «romancieri i mëson lexuesit që ta kuptojë botën si një pyetje... Në një botë [totalitare] të ndërtuar në siguri të shenjtëruara, romani është i vdekur.» Kështu që në përputhje me përvojën time amerikane (aspak totalitare, por të kontestuar, të ndërlikuar, të papërcaktuar, të larmishme, shpesh të paharmonishme deri në pikën e një paqëndrueshmërie të skajshme), unë përherë *jam përpjekur* të shkruaj tregime e romane që të dëshmojnë për natyrën e racës njerëzore ashtu siç i ekspozohet ajo zjarrit spastrues të kundërshtisë, paharmonisë dhe pyetshmërisë – dashnorë që kërkojnë intimitet, mirëkuptim reciprok, simpati e ngushëllim dhe nuk i gjejnë; etër e bij, bij e nëna që e shikojnë me mall, por papërsosmërisht njëri-tjetrin përmes të çarave të keqkuptimit duke luftuar me shprehje të pasakta dhembshurie e duke u përpjekur që t'i dalintjetrit ballazi për t'i thënë atë që duhet thënë. Këto kanë qenë rrethanat – të trazuar, rivalizuese, të mprehta, pronësore – në të cilat unë arrita që të njihja se ç'është thoshte të jesh amerikan: dy luftëra, ajo për të drejtat civile dhe ajo e Vietnamit, ku secila ndau familjet; spastrimet Mëkarti, që ndanë kombin; pasojat e Depresionit të ndjekura nga Lufta Botërore dhe lulëzimi i viteve 1950.

Si një çështje të dytë – në lidhje me përvojën time amtare – unë kam vepruar i nisur nga nevoja dhe liria për të



shkruar mbi disa persona dhe për t'i përshtatur ata (gra, njerëz nga raca të tjera, kombësi të tjera, fëmijë) në përpjekje për t'iu përgjigjur çështjes themelore amerikane të shtruar nga qytetaria ime: si jemi ne kaq të ndryshëm e prapë të ngjashëm? Unë kam shkruar tregime për ta bërë këtë papërcaktueshmëri të durueshme, interesante, madje të këndshme e të bukur.

Unë jam marrë edhe me *pak* politikë në rrafshin intim, në kuotën zero, të jetës së pjesëmarrësve njerëzorë në të. Kam qenë sigurisht në këtë nivel, i ngjuar në një familje të vogël, në një qytet të vogël amerikan, larg qendrave të pushtetit e të retorikës publike kur kam parë të drejtën e të shtrembrën të inskenuar. Megjithëse, ç'është e vërteta,

në një moment të paplanifikuar, i nxitur vetëm nga kureshtja dhe duke supozuar se intelijenca ime vendore do të materializohej në një auditor më të gjerë amerikan, ika nga Jugu si një vend-subjekt dhe u përpoqa që ta bëja të gjithë vendin një vendveprimi dhe, me shpresë, edhe një subjekt.

**D**he së fundi – dhe këtu nuk kam pse të hamendësoj se ç'është ajo që frymëzon dhe çfarë frymëzon – si shkrimtar gjithmonë kam besuar se Amerika është një vendveprimi brenda të cilit ngjarjet e veprimet universalisht *njerëzore*, motivet, shkaqet e rrjedhojat morale të tyre mund të portretizohen e të kuptohen si të rëndësishme nga çdo pikë vështrimi në planetin tonë. Përvoja njerëzore amerikane, ndonëse jo model për pjesën tjetër të botës,



është paraqitur të paktën si një përvojë e vërtetë dhe e denjë për t'u vështruar.

Të gjithë zanafillën e ndikimeve është përherë një punë trulllosëse, përzgjedhëse e vetëlëvduese. Unë vij në këtë përfundim pas përsiatjesh dhe mendoj se sikur këto ndikime të mos kishin funksionuar gjatë këtyre viteve, asgjë tek unë ose te punët e mia nuk do të ishte siç është. Ose më saktë, tek unë nuk do të kishte asgjë fare. Po të heqim një gjymtyrë të rëndësishme nga një ekuacion nuk mund të na mbetet më po ai ekuacion. Nëse Popaji do të bëhej një pilot reaktivi ose një shitës obligacionesh, nuk do të ishte më Popaji që duam ne.

Sot në Çeçeni është një shkrimtar që shkruan në shkrimet e tij për

ndikimet e... le të themi, Çeçenisë. Dhe shkruan të njëjtat gjëra që kam shkruar edhe unë, ose më të mira. Bukur, them unë. Sepse në qoftë se e gjithë kjo periudhë shumëvjeçare e të qenit tim amerikan më ka përgatitur për të kuptuar ngjashmërinë, farefisninë apo kolegjalitetin tim me dikë që unë nuk do ta njoh kurrë, pra më ka bërë që të përjetoj urtësinë më të vyer të letërsisë – atëherë të qenët amerikan, dhe jo më pak shkrimtar, më kanë shërbyer vërtet mirë. ■

**D**igard Ford u lind më 1944 në Xhekson, Misisipi, dhe është rritur fillimisht atje pastaj në Litëll Rok, Arkanzas. Ka ndjekur shkollat publike, Universitetin e Shtetit në Miçigan, Universitetin e Kalifornisë dhe Fakultetin Juridik të Universitetit të Nju Jorkut. Është autor i pesë romaneve përfshirë Gazetari Sportiv, Natyrë e Virgjër dhe Dita e Pavarësisë si dhe i tre librave me tregime përfshirë Rok Springs dhe Një Mori Mëkatesh. Ka shkruar shumë ese dhe është bashkëpunëtor i rregullt i revistave The New Yorker dhe New York Times.

Puna e Z. Ford është nderuar me çmimin e Meritës në Roman nga Akademia Amerikane e Arteve dhe e Letrave në të cilën është anëtar. Ka fituar edhe çmimin Pulicer në prozën artistike, çmimin PEN/Faulkner në prozën artistike dhe çmimin PEN/Malamud për mjeshteri në tregimin e shkurtër. Romanet dhe tregimet e tij janë përkthyer në 23 gjuhë. Franca i ka dhënë çmimin Ordre des Artes et des Lettres. Është i martuar me Kristinë Fordin dhe jeton në Nju Orliëns.



# Linda Hogan



Kam qenë një vajzë e ndrojtur, pa aspiruar kurrë për t'u bërë shkrimtare, pa menduar kurrë për të pohuar identitetin tim amtar, një identitet përherë i qartë kur motra ime dhe unë ndodheshim në Oklahoma me gjyshërit tanë nga fisi çikaso. Ne vijmë nga gjyshër karrocierë dhe zanati i tyre vazhdoi deri vonë. Unë ende i ndiej aromën e drurëve pikan dhe të arrave të errëta me tul. Më pas, në vitet '50 e '60, xhaxhai im nga Denveri më morri në mbledhjet e lëkurëkuqve që atëherë mbaheshin në palestrat e shkollave të vogla. Megjithatë, në përgjithësi ne nuk e shikonim jetën tonë indiane si diçka të rëndësishme. Historia nuk ka interesonte. Ne jetonim në botë e vende të tjera. Dhe përsëri, brenda meje kisha vlera tradicionale. Atëherë nuk e dija se do të bëhesha një grua autoktone me mendësi tradicionale. Unë u rrita në të siç rritet njeriu në trupin e tij, siç rritet një filiz që pa synim apo plan, kthehet në pemë.

Mua as që më shkonte mendja se do të bëhesha shkrimtare dhe fakti që vij nga një Amerikë tjetër ka qenë rrënja e krijimtarisë sime që në fillim.

Edhe pse si vajzë kam qenë e urtë, jo e dhënë pas llafëve, një ditë arrita t'i thosha mësuesit të shkollës të së dielës, i cili besonte se ne ishim në shtëpinë e Zotit, se unë e ndieja Zotin kur uleshja nën pemë. Pikërisht atje, bashkë me drurin, ndieja dashurinë për tokën duke nuhatur aromën e dheut të butë, fijet e barit që rriteshin ndërsa unë rrija ulur.

Isha ende fëmijë kur u grinda për herë të parë për një pemë. Ishte grindja ime e parë, ndofta e para në jetën time përherë të qetë. Tani e di se ne rritemi edhe brenda fjalëve tona. Dhe ndërsa shkruaj këto radhë, jam ulur poshtë një peme. Duke qëndruar këtu kam parë gjer tani ritualin e çiftimit të kolibrut si dhe bletët, ato bletë me dekoracione të jashtëzakonshme, duke fluturuar në lulet e balsamit, në hudhurat e gjarprit. Një dhëlpër kockëdalë rrinte ulur në sopin atje tej.

Kur mendova se Zoti ishte pemë, nuk e dija se natën e shpërnguljes së tyre nga Misisipi në Oklahoma nëpër Rrugën e Lotëve stërgjyshërit e mi ishin parë tek preknin gjetet dhe trungjet e pemëve duke qarë. Preknin pikërisht *miqtë e tyre të vjetër, drurët*, siç i cilësoi më pas një vëzhgues në shkrimin e tij për ikjen e tyre në Oklahoma, në Territorin Indian.

Në këtë mister njerëzor rritja, brenda meje, u bë një histori e trashëguar, kujtesë e bartur prej kohësh të hershme, dije stërgjyshore.

Duke e hedhur shikimin pas mund të them se isha poetë, por në zemër; fjalët në fillim nuk më duheshin. Isha vëzhguese. U rrita duke u kthyer në një jetë krijimtarie. Krijimtaria ime ishte, dhe është, një mënyrë për të qenë në botë. Është njohje se ne jetojmë në një botë me ndjenja. Me krijimtarinë time përpiqem ta shikoj botën përsëri të pacënuar. Në një botë stereotipesh, romanet e mia, sidomos, u japin indianëve dinjitet, realitet, u japin edhe tërësi shpirtërore. Unë i paraqes njerëzit e mi të pranishëm, tërësisht të pranishëm në sfondin e Amerikës, ballë për ballë saj. Unë theksoj gjithnjë inteligjencën e të vjetërve dhe nderoj botën. Ajo është një krijimtari për shpresën dhe brenda saj unë përpiqem të ruaj kuptimin indian tradicional për kozmosin, për atë që përmban yllësi të quajtura Rosat Notare apo Bualli, të ndryshme nga yllësitë perëndimore. Unë di edhe rëndësinë e rrënjës më të vogël të një bime, që edhe ajo kontribuon në botën tonë. Krijimtaria ime është më e gjerë se unë. Ajo vjen nga një vend që unë s'ia di emrin. Unë jam mirënjohëse ndaj saj. Në të ka nënryma dheu, dallgët oqeani, zbulime të panjohura për mua:



*Dikur, në pyllin e sekuojave vigane, dëgjova rrahjen, diçka si vrundullimë lodre apo zemre që vinte nga toka dhe drurët dhe era. Ajo drithërimë e nëndheshme nxiti një lloj kuptimi brenda meje, një lidhje fisnore e mall... Unë mendoj për njerëzit që kanë qenë përpara meje, se si ata i dinin vendet e siveve në qiell dhe se si vazhdimisht e ngultas shikonin diellin që lëvizte për të parë se si drita, që binte në një kënd të caktuar, prekte një gur vetëm një herë në vit. Pa dëshmi të shkruara, ata i dinin zotat e çdo nate, detajet e vogla, delikate, të botës rreth tyre dhe pafundësinë e lartme... Ajo është botë e një vëmendjeje natyrore, botë e të gjitha gjërave që bashkëveprojnë, që dëgjojnë atë që flet në gjak. Në cilëndo rrugë që ndjek, unë eci në trevën e shumë zotave që e duan dhe e hanë njëri-tjetrin. Sonte jam duke mbajtur vesh me një vëmendje më të thellë. Befas të gjithë stërgjyshërit e mi i kam pranë vetes. Rri e qetë, më thonë. Shiko dhe mbaj vesh. Ti je rezultat i dashurisë së mijërave.*

(ESKTRAKT NGA «DUKE E CUR»)

Unë u bëra ajo që do ta gjente rrugën në botë përmes shkrimeve. Unë kërkoja një gjuhë më të gjerë se thjesht bota njerëzore dhe me anën e këtij kërkimi, puna ime si shkrimtare ka qenë në lëvizje e ndryshim të paprerë, mes poezisë, esesë e tregimit. Tregimet e mia kanë ardhur duke u bërë përherë e më të rëndësishme për mua, sikurse edhe studimi im i vazhduar i letërsisë ceremoniale të fiseve shumë të ndryshme, secili duke ngërthyer një dije jashtëzakonisht të shumanshme, kuptim për botën, dhe vlera.

Sipas pikëpamjes së popujve indigjenë në të gjithë botën, në të gjitha traditat ekziston një marrëdhënie e njohur, e paharruar mes njerëzve e kozmosit. Vendosija e njeriut është thjesht një pjesë e Mistereve të Mëdha. Kulturat që kanë mbijetuar 20 000 gjer më 60 000 vjet s'ka si të jenë shumë të gabuara, them unë.

Por ç'është më e rëndësishme, unë kam mësuar të pres, të dëgjoj dhe të ndjek, si në fragmentin e mësipërm. Mua më është dashur të mësoj, si tani, e ulur nën një pemë, që puna të zbulojë vetveten, të vijë tek unë.

Në romanin *Push Teti*, personazhit kryesor i duhet të zgjedhë mes botëve ku mund të banojë, botën e të lashtëve dhe të dijes së tyre të madhe, apo botën e Amerikës. Ai di gjeometri, anglisht, njeh Amerikën, por është ajo që duhet të vendosë nëse ai duhet ta lërë këtë botë për të shkuar tek ajo e të vjetërve, në bashkësinë e tyre, sipaszakoneve të tyre.

*Në shkollë dëgjojmë për yje që brendashpërthejnë, yje që bien drejt brendësisë ashtu si po bie unë, por nuk ekziston kurrkund një vend ku mund të prekësh tabanin, nuk ka kurrfarë fundi për rënien së brendshmi... Ndërsa eci, unë pëshpëris me vete dhe drita e hënës më prek: «Po e lë këtë botë, po lë luftën dhe frikën. Po lë suksesin dhe dështimin, sendet që zotëroj, dhomat me dritë që dikur ishin lumë, por që tani është tkurrur.»*

Ky libër filloi si një projekt kërkimi. Unë kisha qenë në një komitet pune panindian për rifuqizimin e Ligjit mbi Speciet e Rrezikuara. Kishte ndodhur një incident që hapi

probleme, pasi një burrë semiola kishte vrarë një panterë të rrezikuar në Florida. Shkova në Florida për t'u njohur me materialet e gjyqit, pasi doja të shkruaja një artikull për një revistë juridike. Kur u gjenda në Evërglejdus u njoha me Omishton, personazhin kryesor, një grua, nga ato që shkrimtarët ua dëgjojnë zërin, kështu që shënova gjithë ç'tha ajo.

Kjo është mënyra se si shkrimet e mia kthehen në kërkime, në gjetjen e një gjuhe dhe të fjalëve për atë çka nuk mund të thuhet në gjuhën e zakonshme; ngjyresa kuptimore, horizonte dashurie, çaste urtësie që nuk vijnë nga unë, por prej mijëra vjetësh të mësuarit dhe ekzistence. Kur hodha në letër fjalët e para të pamësuar, këtë e bëra për t'i dhënë një zë të pazëshmit, për hir të tij e pavarësisht nëse ai është një kafshë e rrezikuar e librit *Push Teti* apo një nga figurat historike si gruaja Lozen dhe strategu ushtarak Geronimo në librin *Gruaja që Vështron mbi Botën*. Unë dua që këta personazhe të njihen në këtë botë, të jenë të rëndësishëm këtu, të kujtohen.

Tani është mëngjes dhe, teksa rri poshtë një druri, shikoj merimangat e sapolindura duke ikur. Dielli shkëlqen mbi fijet e tyre të mëndafshita. Dallëndyshtet e fushës fluturojnë vajtje-ardhje nga ligatinat në foletë e tyre prej balte, në një botë të tyre të formuar nga hartat e tyre. Unë mund të dëgjoj frymëmarrjen e thellë të kuajve prapa drurëve. Në njërin prej tyre, një mëze, shkronjat U.S. kanë ngrirë në gëzof të ndjekura nga simbole që do ta përkufizojnë atë përgjithmonë, do ta deklarojnë, do të tregojnë historinë e saj. Edhe ajo është pjesë e Amerikës, një krijim i kompletuar nga natyra e gjallë. Edhe kuajt indianë kanë një histori jo të ndryshme nga jona. Ushtria, duke u përpjekur të grumbullonte fiset dhe t'i çonte në Oklahoma, u përpoq ta dëmtonte lëvizjen e tyre duke u vrarë kuajt, nganjëherë me mijëra. Edhe kjo është një pjesë e historisë që më bën të shkruaj.

## AFINITET: *Pela Mustang*

*Sonte, kur tingujt e ditës  
u fashitën  
ajo qëndron nën hënë,  
pranë një shkëmbi të ndriçuar.  
Ajo është shoqe e tokës,  
që i përket.*

*Ajo ka një fytyrë të errët, të qetë,  
thundrat e saj si gurë të zinj  
i përkasin dheut  
ashtu siç ka qenë përherë,  
barërave të gjatë,  
se bari erdhi pas shiut,  
ose erës që shtrihet mbi fushëtitrat e vjeshtës  
apo, dimrit, tani,  
kur gëzofi i saj ndërron e bëhet borë  
dhe qimet e barkut të saj*

*marrin ngjyrën e shelqjeve të kuq të ujit  
pranë përroskës,  
këmbët e saj të zeza si drurë.*

*Këta kuaj  
thuajse një hije  
e thyer.*

*Kur ecim bashkë  
nëpër barishtet e gjata, e ndiej pranë  
si të isha duke ecur me misterin,  
me bukurinë dhe fuqinë e egra,  
sikur, për një çast, jemi e njëjta kafshë  
dhe e mbajmë mend shoqa-shoqen që prej kohe.*

*Qëllon që ulem në tokë  
dhe shikoj erën që i fryn krifën e bishtin  
dhe valëzimet e barit të gjatë  
në një drejtim  
dhe kjo më sjell ndërmend  
se si kam ardhur nga aq larg  
përmes kohës  
për ta gjetur.*

*Ka ditë që i këndoj  
duke kujtuar njeriun e fisit Kiova  
që këndonte për të mbytur britmat  
e mëzave të tyre të vrrarë nga amerikanët,  
një këngë që unë e di edhe në gjumë.*

*Netëve, duke dëgjuar atë, jashtë,  
mendoj se ajo është për tokën  
çka unë jam për të,  
duke i përkitur.*

*Nganjëherë më duket se e njohim shoqa-shoqen  
prej një kohe përpara udhëimit tonë për këtu  
Në fshehtësi i këndoj këngë të vjetra,  
nga ato që i këndoj edhe në gjumë.*

*Por mbrëmë i vogli i saj vdiq  
pas kushërinjve edhe ai, duke lëvizur  
gjatë kaq shumë muajve.  
Sonte jam ulur në kashtë  
dhe shikoj si rrjedh qumështi nga thithkat e saj  
në tokë. I pastroj fytyrën.  
Kam ardhur nga aq larg përmes kohës  
për të gjetur atë dhe  
Është hera e parë  
që shikoj një kalë duke qarë.*

*Dhe këndo, thotë era,  
Këndo.*

*Ajo është një krijimtari për shpresën  
dhe brenda saj unë përpiqem të  
ruaj kuptimin indian tradicional për  
kozmosin, për atë që përmban yllësi të  
quajtura Rosat Notare apo Bualli, të  
ndryshme nga yllësitë perëndimore.*





Unë e dua botën. Dua gjithçka që jeton në të. Prandaj dhe shkruaj, si këtë mëngjes, nën pemë. Ajo është një botë misterioze dhe është kjo botë ajo që më jep fjalët dhe këto fjalë vijnë nga dheu, nga gjuha e tokës, nga të rikujtuarit e të harruarve të kësaj bote, siç i ka quajtur shkrimtarja Meridel Lësëur. Unë shkruaj që të jem njeriu që ndihmon për të bashkuar botën, jetët e njerëzve dhe të jonjerëzve sërish, për t'i bërë përsëri tok. Këtë e bëj për të ardhmen. Këtë e bëj për hir të jetës. ■

**L**inda Hogan është një shkrimtare çikaso. Është autore e shumë librave. Në të përfshihen Banesat: Një Histori Shpirtërore e Botës së Natyrës (W.W. Norton, 1995), një roman me titullin Pushteti (W.W. Norton), si dhe romanet Shpirt i Ulët dhe Stuhi Diellore (Simon and Schuster). Shpirt i Ulët ka qenë finalist për çmimin Pulitzer, kurse Libri i Medikamenteve, një vëllim me poezi, ka qenë finalist për çmimin e Rrethit të Kritikëve Kombëtarë të Librit.

Hogani ka marrë çmime të shumta, përfshirë një grant nga Fondacioni Kombëtar për Artet, një bursë Gugenheim, një çmim nga Fondacioni Lannan, çmimin në dramaturgji dhënë nga Muzeu i Pesë Fiseve të Qytetëruara dhe më 1998 çmimin e Arritjeve gjatë Jetës nga Rrethi i Shkrimtarëve Autoktonë. Gjithashtu ka shkruar një tregim për një dokumentar mbi historinë e Lirisë Fetare të Indianëve të Amerikës, Çdo Gjë Ka Shpirt, që tani shfaqet në PBS. Ajo bën pjesë në shkrimtarët indianë që janë angazhuar nga Muzeu Kombëtar Smithsonian i Indianit Amerikan për të shkruar si bashkautore një libër mbi përrurimin madhështor të muzeut. Tematika e Hoganit është mbi traditën e mbi mënyrën e bartjes së saj gjër në ditët tona. Ajo ka qenë bashkëredaktore me Brenda Petersonin në librin Natyrë Intime: Lidhja mes Grave dhe Kafshëve, enti botues Ballantine, dhe Frymëmarrja e Ëmbël e Bimëve, enti Farrar Straus and Giroux. Në qershor 2000 do të dalin dy libra të tjerë të rinj të saj, Gruaja që Vështron mbi Botën: Memuari i një Kombi, enti W. W. Norton, dhe Udhëtimi Misterioz i Balenës Bojëhiri (National Geographic Books). Tani është duke punuar me një roman tjetër, një vëllim me vjersha, dhe dy kuaj.





# Xhekobs

Mark



Ekziston një lidhje e ngushtë mes të shkruarit dhe të qenët kokëngjeshur. Më kujtohet ndjesia e kënaqësisë që më pushtoi kur u zgjova nga ëndrra ime e parë trigjuhëshe. Kjo ndodhi pas kthimit nga Paraguaji, ku kisha kaluar dy vjet si vullnetar në Korpuset e Paqes duke jetuar në një fshat të izoluar ku mbillej pambuku. Paraguajianët flasin dy

gjuhë, spanjisht dhe guarani. Në ëndrrën time, secila nga tri gjuhët kishte ndjesinë/tonin e vet, tingëllimin e saj të dalluar. Ëndrra kishte të bënte me kënaqësinë e të përkthyerit, një ndjenjë që më buronte nga aftësia për të balancuar realitete të ndryshme. M'u deshën dy vjet për ta arritur këtë. Por për të shkruar atë që kisha filluar në Paraguaji më janë dashur përpjekje këmbëngulëse akoma më të mëdha.

Anglishtja, sigurisht, ka formësuar identitetin tim amerikan, botën në të cilën jam lindur. Spanishtja ka përfaqësuar një lloj ure, një rrugë për të kaluar në një vend të ri, por të njohshëm. Vite përpara se ura fizike të ekzistonte, ime shoqe dhe unë hipëm në një traget për të kaluar lumin Parana në jug të Paraguajit për në Posadas, Argjentinë, ku ajo më bleu një përmbledhje me poezi me lidhje të thjeshtë të Borgesit, shkrimtari i parë jashtë kulturës sime amerikane, krijimtarinë e të cilit jam përpjekur ta kuptoj (dhe vazhdoj ende). Gjuha guarani ishte ndryshe. Ishte vendore, rurale, një pyll i padepërtueshëm. I përkiste Paraguajit dhe ruante të fshehtat e tij. Vetëm në pak raste – duke dëgjuar një veteran të Luftës Çako tek përshkruante tmerrin e tij në shkretëtirë, ose duke pirë *mate* me një fermer ndërsa binte

shi dhe nuk mund të shkoje dot në fushë, ose duke pirë nga një gotë me uiski kallami me një ëndërrimtar të shqetësuar që kishte ndërmend të organizonte një garë hipizmi për të nxjerrë paratë e udhëtimit – i jam afruar murit që më mbante jashtë kulturës së ruajtur nga guarani i këtij vendi.

Nuk qe rastësi që vendi i vetëm ku këto tri gjuhë u takuan ishte ëndrra. Jashtë ëndrrave ka qenë fërkimi që ndodh në skajet ku këto kultura ndërpritën ai që më ka magjepsur, madje më ka obsesuar. Është ndofta kjo arsyeja pse hyra në shërbimin e jashtëm. Ai u bë materiali kryesor i jetës sime krijuese. Dhe ka filluar shumë kohë përpara, shumë vite përpara Paraguajit. Ai ka filluar kur kam filluar edhe unë.

Prindërit e mi janë nga dy vende shumë të ndryshme amerikane. Familja e nënës sime ishte nga Pensilvania fshatare. Njerëzit e saj merreshin me peshkim e gjueti. Merreshin edhe me makineritë, rregullonin traktorët, korrëset e barit, veturat, gjithçka që kishte motor. Luanin muzikë kantri në skenat e stacioneve zjarrfikëse dhe bare. Ishin protestantë, fjalëpakë e dyshimtarë për llojin e njerëzve që jetonin në botën e babait tim, e cila ishte qytetëse dhe në disa drejtime të caktuara e kundërt me atë nënës sime. Në pjesën më të madhe, njerëzit e familjes së babait tim punonin në fabrika. Ishin katolikë, banonin në zonën e Najagara Follzit, në lagje ende të ndara në grupe etnike (mund të ishte irlandez e të jetoje në një lagje polakësh; mund të ishte libanez e të martoheshe me një italiane, megjithatë e dije se kush ishte, e dije se kush ishin). Njerëzit e babait tim ishin më fjalëshumë se ata të familjes së nënës sime dhe flisnin në një të folme tjetër amerikane. Tregonin historira. Disa nga historitë që tregonin ishin të vërteta; shumica interesante. Muzika e tyre ishte svingu, stili i tyre më i lirshëm. Kur im atë ndodhej në spitalin Niagara Falls Memorial i shtrirë në barrelë për shkak të një ataku në zemër, personeli mjekësor e pyeti nëse vuante nga ndonjë alergji dhe ai u përgjigj: «vetëm nga muzika kantri.»

Do ta teproja po të thosha se prindërit e mi vinin nga dy kultura të ndryshme. Shamuejt dhe Xhekobsët bënin pjesë në forca të ndryshme të së njëjtës kulturë të madhe, të



zhurmshme, të pështjelluar dhe të konfliktshme amerikane, ishin tipar i tyre dhe i mbronin ato. Por nuk do ta teproja po të thosha se të vështuarit e ndërthurjes së ndërlikuar të këtyre përmasave të ndryshme të jetës amerikane është pikërisht ajo që më tërhoqi te shërbimi i jashtëm dhe te të shkruarit mbi kufijtë dhe njerëzit që i kapërcejnë ata.

Ne jetonim në Najagara Fallz, por kalonim shumë kohë në Pensilvani, në fermën e tim eti në Touanda. Lëvizja lart e poshtë midis një vendi e një tjetri ishte thujtja si të kaloje një kufi. Një rrjedhojë është se në të vërtetë vëllezërit e mi dhe unë u rritëm natyrshëm në dy kultura. Kjo, sepse kështu duhej, sepse mësuam t'i kuptonim të dyja botët, t'i flisnim të dyja të folmet amerikane. Ne dëgjonim muzikë, lexonim tabelat rrugore, qëndronim në ndërprerjet ku të dyja familjet nuk para përputheshin.

E gjithë kjo ishte e dobishme. Duke filluar nga dy vjet qëndrim në Potrero Japepo, Itapua, Paraguaji, unë përjetova një sërë çrregullimesh të dobishme kulturore. Qenë të dobishme sepse prishën ndjenjën time të identitetit, i cili, në rastin tim, me sa dukej kishte kohë që kishte filluar t'i jepte shkëndija imagjinatës sime. Në Paraguaji bleva një makinë shkrimi portative dhe thujtja përpara se të mund të flisja gjuhën (gjuhët) e atjeshme, fillova të shkruaja tregime me ngjarje që ndodhnin në atë vend. Të përfytyroje jetën dhe rrethanat e njerëzve, përvoja e të cilëve që kaq larg sime, që një ndërmarrje gati tejet e guximshme, gjë që e dija. Pata më shumë dëshitime se suksese. Po kur fillova, mendova, dhe tani ca më shumë, se të përfytyrosh jetë të tjera, realitete të dallueshme, përvoja të huaja nga të tuat, jo vetëm që është e mundur, por mund t'i bëhet pasion njeriut.

Ka mënyra e mënyra për t'iu qasur një kulture të huaj nga jotja dhe shumë syresh janë të mbushura me kurthe. Në krijimtarinë e Xhozef Konradit, fjala vjen, ndërlikimet e përfshira në përpjekjet e tij për të kuptuar e paraqitur me fjalë një kulturë të huaj nganjëherë spikatën me një qartësi të dhimbshme. Është e vështirë të debatosh me akuzën e hidhur që romancierit nobelist nigerian Çinua Açebe i bën autorit të veprës *Zemra e Errësirës* si racist, por mua më duket se në disa nga veprat e Konradit ka më shumë ngjyresë, një ambiguitet më të dobishëm, nga ç'është i gatshëm të pranojë Açebeja për të.

Në të vërtetë, në *Karaini: Një Kujtim* kemi një Konrad tjetër. Në të rrëfimtari, një trafikant i bardhë armësh, tregon historinë e një kryetari fisi malazian përmes një vargu reagimesh emocionale të ndërlikuara e të ndryshueshme, duke filluar nga simpatia e fuqishme gjër te një përçmim distancues që i ka fillesat në mendjemadhësinë e epërsisë engleze. Tregimi lëviz marramendthi përmes një vargu kalimesh të rrëfimtari ndërmjet këtyre ekstremeve konfliktuese. Kur mbaron, rrëfimtari e sjell historinë në atë çka në leximin e parë duket si një skenë e qetë siguroese londineze që flet për triumfin e qytetërimit britanik mbi harlisjen imagjinare, shkëlqimin, ngjyrën dhe eksenin ekzotik të

«Lindjes». Por në rrjedhën e «Karainit» ka pasur shumë lëvizje para-prapa që e kanë vështirësuar fiksimin e tregimit në një rrugë të tillë buçitëse e të vetëkënaqur të Londrës. Këtu kemi të bëjmë me një mënyrë për të konstruktuar botën, sugjeron me delikatesë rrëfimtari i Konradit, kurse atje me një tjetër, por e vërteta e përvojës është që të gjendesh në trafikun nervoz ndërmjet tyre. Lexuesi largohet nga «Karaini» i shpërqendruar e i hutuar, i përfshirë në këtë përballje kulturore në një mënyrë tejet të papërcaktuar.

Ç'është ajo te Konradi që i lejon atij të qëndrojë në kulturën tjetër në mos me të dyja këmbët, të paktën fare pranë saj, duke vëzhguar atë që është për t'u vëzhguar me një sy inteligjent e kureshtar? Eduard Said, një nga kritikët më të mprehtë të Konradit flet për një «aureolë çrregullimi, pastabiliteti e tëhuajsimi» te ky shkrimtar, rezultat i mërgimit dhe tëhuajimit të Konradit, i «humbjes së atdheut dhe gjuhës» së tij. Përvoja e Konradit ishte e tejskajshme. Ajo shkaktonte ndryshime të përhershme mbi të. Ai iku dhe humbi atdheun, gjuhën e kulturën përgjithmonë. Nuk kishte kthim pas në Poloni. Të shkruaje në polonisht nuk ia vlente. Me një përpjekje të vullnetit që nuk përshkruhet dot, detari-shkrimtar-aventurier zuri dhe bëri të vetin një atdhe të ri, një gjuhë të panjohur, një kulturë të huaj. Një nga pasojat e kësaj është se kjo e bëri tejet të vetëdijshëm – dikush mund të thoshte neurotikisht të vetëdijshëm – për atë që sot mbase mund të quhej relativitet kulturor.

Ne në Shtetet e Bashkuara thujtja flasim rastësisht për rishpikjen e vetes sonë. Mundësia e rishpikjes ka qenë një kusht për ndjenjën tonë se kush jemi ne, gjë që fillon me zbulimin dhe zotërimin e kontinentit amerikan. Ajo pulson e vazhduar në kulturën tonë që nga bindja e pelegrinëve se ata po themelonin një «qytet mbi një kodër», e shprehur nëpërmjet eseve tejet nxitëse të Emersonit, deri në ndryshimin e ndryshimeve të Bob Dilanit, e shprehur album pas albumi. Megjithatë, ne shpesh themi se e kemi rishpikur veten tonë kur ajo çka vërtet nënkuptojmë me këtë është se kemi ndryshuar diçka lidhur me veten tonë: punën tonë, vendbanimin tonë, mënyrën e veshjes sonë, sasinë në pagimin e faturave tona apo argëtimet tona. Ne thujtja nuk e vëmë re se rishpikja fillon me një akt shkatërrimi: vetja e vjetër i bën vend asaj të re. Konradi e kuptoi këtë, sepse e jetoi. Dhe e jetoi sepse duhej, jo sepse mendonte se ajo do të ishte një ushtrim intelektual interesant.

**K**orpuset e Paqes dhe shërbimi i jashtëm nuk i afrohen fare llojit të përvojës së thellë të ribërjes së vetvetes. Sa herë që kam ikur nga Shtetet e Bashkuara, kam llogaritur se do të kthehem përsëri. Megjithëse mësova gjuhë të reja, e ruajta gjuhën time. Unë kam qëndruar i mbërthyer në kulturën time; me teknologjinë e sotme dhe me zhurmën që shkakton ajo është më e vështirë të shkëputesh, sesa të qëndrosh i mbërthyer. Kështu, megjithë qëndrimin jashtë kulturës sime për 15 vjet, unë nuk u rishpika. Megjithatë, tek unë ndodhën gjëra të tjera. Gjatë jetës dhe punës në vende të tjera, u çorientova. U sfido-

va dhe u provokova. Nganjëherë ndihesha i përulur, por shpesh i habitur. Unë nuk u rishpika, po do të ishte më e drejtë të thosha se u zgjerova.

Duke shkruar prozë artistike me ngjarje nga vendet ku kam jetuar, më kanë tërhequr disa lloje tregimtarësh. Turistët e çdo lloji, përfshirë ata për udhëtime kulturore për qejf, nuk më kanë interesuar shumë. Unë kam kërkuar njerëz, zërat e të cilëve kanë pasur gamën për të shprehur një lloj tjetër angazhimi me kulturën në të cilin e gjenin veten. Gazetarët, sidomos korrespondentët e huaj, kanë qenë veçanërisht interesantë, pasi ata priren që të jenë kureshtarë e shpërfillës dhe të kenë një ndjenjë të fortë rebelimi, të cilën arrijnë ta kanalizojnë mirë. Ata e harxhojnë kohën duke u përpjekur të zbulojnë se çfarë po ndodh në një vend në të cilin nuk janë lindur. Për të shkruar një tregim të saktë, atyre u duhet të dëshifrojnë kodet kulturore. Ata ecin më tej dhe ndërsa bëjnë këtë, të mirët – dhe ka shumë të mirë – merren intensivisht me vendin që mbulojnë.

Qofshin refugjatë të përkohshëm apo të përhershëm, disa diplomatë (sigurisht, jo të gjithë), punonjës të ndihmës e misionarë, aventurierë e spiunë – që të gjithë ofrojnë personazhet e duhura për shkrimtarët që janë të interesuar për pikëtakimet e kulturave. Si shembull për kastën e personazheve dikush nisat nga romanet e shumta të Grehëm Grinit. Për një shkrimtar amerikan emigrantët, në një kuptim, janë pjesa më pak e vështirë e së tërës. Të paktën është relativisht më e lehtë që t'i vizatosh ata duke gërshetuar simpatinë dhe të saktësinë që kërkon proza e mirë, pavarësisht nga subjekti i saj. Personazhet amerikane vijnë nga bota vetjake e përvojës së shkrimtarit. Të vrojtuar jashtë elementit të tyre, ata duken çaprazë.


Shumë më e vështirë, me gjasat më të shumta që përpjekja të dështojë, është shpaloja e personazheve nga vendet dhe kulturat në të cilat ndodh ngjarja. Grini ishte i ndërgjegjshëm për vështirësitë për ta çuar atje ku duhej vizatimin e personazheve jobritanikë që krijonte. Duke shkruar për policin meksikan që gurmton priftin e uiskit në *Pushteti dhe Lavdia*, ai thotë çiltërsisht se kishte krijuar një personazh krejtësisht imagjinar. Ngjarjet e romanit kishin nevojë për togerin e vrullshëm, të rreptë e puritan si kundërpeshë e priftit të mefshët, të dobët e qejfli. Duke udhëtuar nëpër Meksikë, autori nuk arriti të gjente një model njerëzor, kështu që e nisi punën nga zeroja, por ndihet që ai nuk ishte plotësisht i kënaqur me rezultatin.

**S**hkrimtarë të tillë si Açebe dhe Said kanë vënë në dukje se sa e lehtë është për ta «orientalizuar» një kulturë të huaj, për ta përdorur atë si sfond ekzotik në të cilin personazhet të vizatohen nga kultura e vetë shkrimtarëve. Kur ndodh kështu, kultura e përvetësuar, në rastin më të mirë, sjell një ngjyrë vendore. Në rastin më të keq, tregimi i dehumanizon njerëzit në mënyrë të pakëndshme, gjë që ka ndodhur, sipas Açebes, në veprën *Zemra e Errësirës* nëpërmjet pikturimit që u bë Marlou zezakëve afrikanë.


Nuk ekziston ndonjë fjalë e vetme që të jetë atë aq e gjerë dhe e saktë, sa që të përshkruajë botën që ka pasuar epokën koloniale, përfundimin e përgjakshëm të së cilës e parathotë vepra e Konradit. Paskoloniale? Sigurisht. Bota ku jetojmë është sigurisht ajo, por fjala më fort sugjeron se nga kemi ardhur, sesa se ku po shkojmë. Ajo nuk e jep në plotësi thellësinë e ndryshimeve që kanë ndodhur qysh atëherë në perceptimet e njerëzve, ta zëmë, që nga vitet 1950. Ka raste kur është tmerrësisht e vështirë për t'u bërë i vetëdijshëm për këtë ndryshim për shkak të dhunës që vazhdon shumë shpesh, në shumë vende. Por botëkuptimi kolonial gjithsesi është i vdekur. Ata që kanë qenë pro tij dhe ata që e kanë kundërshtuar atë gjithashtu kanë vdekur. Diçka tjetër do ta zërrë vendin e tij.

Ndofta është shumë herët për t'i dhënë një emër asaj diçkaje. Ne jemi në një fazë tranzicioni dhe të quajturit e saj epokë paskoloniale do të ishte e pranueshme edhe për ca kohë. Por ekzistojnë shenja inkurajuese se ajo që po lind do të jetë më e mirë se ajo që po lëmë pas. Në rastin e letërsisë në anglisht, ajo është pasuruar në mënyrë të pallogaritshme nga shkrimtarë nga Afrika, India, Karaibet e gjetkë.

Më pak i vënë re, më pak i rëndësishëm, por që ia vlen të mendohet për të është një ndryshim tjetër që po ndodh sot. Kur shkrimtarët amerikanë udhëtojnë jashtë Shteteve të Bashkuara, ata përpiqen t'i vizatojnë drejt personazhet që nuk janë amerikanë: fermerin paraguajan të pambukut, aktivistin e të drejtave të njeriut në Honduras që fsheh dokumente inkriminuese në një frigorifer të prishur, gazetarin investigues me shenja plagësh dhe me të fshehtat e veta në Kenia, oficerin spanjoll të zbulimit, i ati i të cilit zbaviste turistët me marifete në letrat e lojës për të blerë saçme e cigare.



*Shkrimtarët amerikanë që shkruajnë prozë artistike me ngjarje të vendosura në kultura jo të vetat kanë një burim të jashtëzakonshëm në dispozicion të tyre, kanë letërsinë e vendeve për të cilat duan të shkruajnë.*



Përpara se të vdiste në një aksident ajror, romancierja amerikane dhe punonjësjë sociale Maria Tomas kishte punuar me pasion të madh për të përshkruar ndërveprimet e shumanshme mes afrikanëve dhe amerikanëve duke krijuar personazhe të një kompleksiteti dhe besueshmërie të barabartë në të dyja kulturat. Në veprat më të mira, krijimtaria e Tomasit rrezaton atë kombinim të pakapshëm të simpati-

së e të saktësisë për të cilën Grini ishte i vetëdijshëm se i nevojitej veprës së tij. Shkrimtarë të tjerë përpiqen të bëjnë të njëjtën gjë. Norman Rashi, Pol Eggersi dhe Marni Muleri punojnë për t'i vizatuar marrëdhëniet mes kulturave në botën paskoloniale me plotësinë e duhur, sipas imagjinatës së tyre.

Kritiku anglez i shekullit të 19-të, Metju Arnold, ka shkruar se për të vlerësuar me vërtetësi letërsinë e kulturës së vendit tënd është e nevojshme që të njohësh atë të një vendi tjetër. Ai e kishte fjalën se sa e rëndësishme ishte të dije frëngjishten për të kuptuar anglishten. Sot nocioni i të kushtuarit vëmendje një kulture që nuk është jotja është akoma më e domosdoshme. Ajo është edhe një sfidë. Borgesi që unë zgjedh sonte nuk është Borgesi që lexoja kur jetoja në një ish-treg mishi në Enkarnasion. Shkrimtarët amerikanë që shkruajnë prozë artistike me ngjarje të vendosura në kultura jo të vetat kanë një burim të jashtëzakonshëm në dispozicion të tyre, kanë letërsinë e vendeve për të cilat duan të shkruajnë. Ndofta është e vërtetë se kudo që të udhëtosh, çelësin e të shkruarit gjithsesi do ta gesh te të lexuarit. ■

**L**ibri i katërt i Mark Xhekobsit, Fare Pak Mbretër, do të botohet nga Simon and Schuster. Ngjarjet e romanit janë vendosur në Madrid, ku Xhekobsi ka shërbyer si nëpunës i çështjeve kulturore në ambasadën e SHBA. Robert Olen Batlëri ka shkruar për të se «asnjë shkrimtar nuk shkëlqen aq shumë sa Mark Xhekobsi në eksplorimin e hapësirës së pasur artistike të amerikanit jashtë vendit. Ai shkrin traditat letrare të Henri Xhejmsit dhe të Grehëm Grinit në një vepër që është mirëfilli e tij dhe vërtet e mrekullueshme. Fare Pak Mbretër është libri i tij më i mirë gjer më sot.»

Në librat e mëparshëm të Xhekobsit bëjnë pjesë Një Kastë Spanjollësh (*Talisman House*, 1994) të cilin redaktori i Atlantik Monthly, S. Majkëll Kërtis, e ka quajtur «një debutim i shquar i një shkrimtari të ri të kompletuar, të apasionuar, politikisht të mprehtë»; Kaubojsi i Gurtë (*Soho Press*, 1997) për të cilin The Washington Post ka shkruar: «Ndodh nganjëherë që krejt papritur të bie në dorë një roman që të kujton aftësinë që ka proza artistike për të dhënë kënaqësi e për të të mahnitur», si dhe Çlirimi i Qiellit të Vogël (*Soho Press*, 1999) ku përfshihet tregimi Si Merren Vesh Zogjtë që fitoi çmimin e Prozës Artistike të Iowa Review.

Xhekobsi ka botuar edhe mbi 60 tregime në një sërë revistash të zakonshme apo letrare ku përfshihen The Atlantic Monthly, The Southwest Review, The Southern Review, New Letters dhe The Kenyon Review. Ai ka punuar në Turqi, Paraguaj, Bolivi, Spanjë e Honduras si nëpunës i shërbimit të jashtëm. Ka qenë edhe vullnetar në Korpuset e Paqes në pjesën rurale të Paraguajit. Flet mirë turqishten e spanjishten e deri diku guaranin.



# Xh<sup>Ç</sup>arlz Johnson



Poshtë një globi të qelqtë në dhomën time të ndënjies ndodhet një kujtim nga historia e familjes sime katërshkulllore në kontinentin e Amerikës së Veriut. Jam i sigurt se kushdo që e ka vizituar shtëpinë time duhet të ketë menduar se ai është një nga trashëgimet e vjera më të çuditshme, një copë e padëshifrueshme nga e kaluara amerikane,

një ind nga një kohë dhe jetë e harruar. Në të unë kryej shpesh një lloj dëshifrimi duke i hequr një nga një shtresat kuptimore siç bëjmë mbi një palimpsest. Unë përpiqem të përfytyroj (siç bëjnë arkeologët me orenditë e Pompeit apo me copërat e poqeve të inkasve) botën afro-amerikane të shpresës, luftës, heroizmit dhe mundësive aq shumë të vonuara që rrethojnë këtë objekt 80-vjeçar.

Ajo që qëndron misteriozisht poshtë qelqit është një shishe qumështi e trashë, opake, me shumë shenja goditjesh dhe që mban një mbishkrim në relief: *Një pint. Kjo shishe është pronë e JOHNSON DAIRY CO., Evanston, IL. E mbushur atje. Lajeni dhe kthejeni.*

Xhonsoni i nderuar, pronari i kësaj shisheje, ka qenë Uilliami i ndjerë, xhaxhai i babait tim. Ai u lind në fushëtrirën e Sauth Kerëljajnës, afër qytetit të vogël Abvil më 1892, në fund të periudhës së rindërtimit, vetëm tre vjet përpara fjalimit të Buker T. Uashingtonit mbi Kompromisin e Atlantës (dhe botimit të *Makina e Kohës* të H. Xh. Uellsit). Njerëzit e tij jetonin pranë tokës. Merreshin me bujqësi, prodhonin gjithçka që u duhej dhe në dimër gjuanin. Ujin e merrnin nga pusi. Në përgjigje të thirrjes së natyrës në

mes të natës duhej të dilje jashtë e të ecje në vetmi gjer te nevojtorja e kutërbuar në oborr duke i hedhur këmbët me shkathtësi për t'iu shmangur gjarpërinjve. Ata i vinin fëmijët në punë që në moshën pesë vjeç duke i çuar për të marrë gjëra për të rriturit dhe për fëmijët e tjerë që punonin. Në jetën e tyre të përditshme asgjë nuk fitohej lehtë, nuk vinte vetvetiu, dhe jam i bindur se kur ishte fëmijë, Xhaxha Uilli do të ketë qenë ndikuar shumë nga programi i famshëm i Buker T. Uashingtonit për vetëmbështetjen dhe për «filozofinë e furçës së dhëmbëve» (pastërtinë dhe kujdesin e veçantë në të gjitha gjërat vetjake e profesionale). Po jo vetëm ky program, por ndofta edhe mburrja sfiduese e Thorout në veprën *Uolden*: «Di aq zanate sa kam gishta.»

Si shumë zezakë të tjerë që u shpërngulën në veri pas Luftës së Parë Botërore, ai shkoi në Çikago dhe u vendos në Ivënston, një lagje e qetë, duke marrë me vete asgjë tjetër veçse një shpinë të fortë, një mendje të mprehtë e një dëshirë të zjarrtë për të fituar kundër gjasave jashtëzakonisht të pafavorshme për zezakët në periudhën e segregacionit Jim Crow. Në Ivënston zbuloi se kompanitë e qumështit me pronarë të bardhë nuk u shërbenin zezakëve. Përherë optimist, një njeri që i pëlqente të përvishte mëngët e të punonte pa u lodhur në vend që të ankohej, Xhaxha Uilli iu përgjigj racizmit duke themeluar Kompaninë e Bulmetit Xhonson, një sipërmarrje që eci mjaft mirë në shpërndarjen e qumështit për zezakët e Ivënstonit gjer në periudhën e Depresionit të Madh që i dha fund kompanisë së tij.

Kur dështoi ky biznes, Xhaxha Uilli zuri punë në një brigadë ndërtimi derisa ia ma mori dorën punës dhe iu fut sipërmarrjes së dytë, themelimit të Kompanisë së Ndërtimit Xhonson, e cila vazhdoi deri në vitet 1970 duke u marrë me ndërtimin e kishave (Springfield Baptist Church), apartamenteve të banimit dhe banesave në të gjithë zonën e North Shores – vende në të cilat sot, shumë kohë pas vdekjes së xhaxhait të babait tim më 1989 në moshën 97-vjeçare, njerëzit akoma banojnë apo adhurojnë perëndinë e tyre. Me fillimin e këtij biznesi të dytë ai u tha vëllezërve, djemve e vajzave të tyre në Jug se mund t'i punësonte po qe se



shkonin në Veri. Im atë e pranoi ofertën dhe fill pasi u vendos në Ivënston u njoh me nënën time, njohje që nisi zinxhirin e shkaqeve që 54 vjet më vonë çuan te këto përsiatje se si të qenët amerikan ka formësuar jetën time si romancier, tregimtar, kritik letrar, filozof, profesor kolegji dhe karikaturist profesionist. (Xhaxhai i babait tim, për shembull, është portretizuar në Kreun 7 të romanit tim të fundit *Ëndërruesi* në figurën artistike të kontraktuesit zezak Robert Xhekson, fitoret e të cilit në fushën e arkitekturës janë të padiskutueshme në Ivënston.)

E thënë thjesht, unë u rrita në një qytet të vogël ku çdo ditë shikoja ose hyja në ndërtesat që ishin ndërtuar me mjeshteri, shije e fantazi nga brigada e ndërtimit të xhaxhait të tim eti, e përbërë vetëm nga zezakë, në të cilën dikur kishin punuar edhe babai e xhaxhallarët e mi. Kështu, kur isha fëmijë, unë kurrë s'kisha dyshuar, *kurrë*, për rolin vendimtar që kishin luajtur njerëzit e mi në ndërtimin e Amerikës në *të gjitha* nivelet – fizike, kulturore, ekonomike e politike duke filluar nga kolonitë e shekullit të 17-të. (Rrënjët e familjes nga ana e mamasë mund t'i gjej deri te Xhef Petersi, një karrocier nga Nju Orliënsi, i lindur rreth vitit 1812.) I rritur në Ivënston dhe duke ndjekur shkolla të paseregguara duke filluar nga vitet 1930, unë dija – falë prindërve, të vjetërve dhe mësueve të mi – se demokracia amerikane ishte një «punë në vazhdim» dhe një ftesë për luftë (më duket se kështu ishte shprehur dikur Benxhamin Franklini): një eksperiment i vazhdueshëm në liri, një demokraci që si pishtari ka kaluar nga një brez zezakësh te tjetri duke u lëmuar e përsosur më tej. Të parët e mi më kanë mësuar se racizmi është atavist, i destinuar për t'u hedhur në plehrat e evolucionit njerëzor dhe *i padenjë* për cilindo që e kupton thellë shpirtin e Amerikës.

Sa për Uilli Xhonsonin mund të them këto: më kujtohet si një burrë tullac, lëkurëzi, barkalec, me tiranta, si timonieri i familjes (një rol që më vonë do ta merrte edhe im atë), që kishte një stol të rezervuar në kishën tonë A.M.E. (ku hidhte shumë para), që shikonte lajmet e darkës në televizorin bardhë e zi si të ndodhej përpara orakullit të Delfit (çdo fitore gjatë Lëvizjes për të Drejtat Civile e bënte që të brohoriste për përparimin që arrinin zezakët në vitet '50 e fillim të viteve '60) dhe që kishte qejf të shikonte fëmijët e të vëllait, nipërit e mbesat e tij, që vinin për darkë në apartamentin dykatësh që e kishte projektuar e ndërtuar vetë (ai, sigurisht, banonte në katin e sipërm; katin e parë ia kishte lëshuar me qira një salloni bukurie e parukerie, kurse zyrën e vet e kishte në bodrum, të mbushur me harta, projekte e pajisje për rievime që [mua më] dukeshin të mistershme). Një herë e mbaj mend duke kënduar atë këngëzën e goditur që kishte krijuar vetë për kompaninë e tij të qumështit. Më vjen keq që sot e kam harruar. Por falënderoj fatin që më ra në dorë kjo shishe qumështi që kishte qenë e mbyllur brenda murit të një ndërtese në qendër të Ivënstonit në vitet '30 (i zoti *nuk* e kishte «larë dhe kthyer»). Një fotograf i bardhë që koleksiononte antika e zbuloi

në vitin 1975, kur banesa u rindërtua; ai e mbajti në shtëpi gjersa ma dha mua si dhuratë më 1994 në këmbim të një kopjeje me autograf të romanit tim *Kalimi i Mesëm* pas fjalës që unë mbajta në ditën e diplomimit në Universitetin Northuestërn (fillimisht ata ftuan presidentin Klinton, por pasi ai nuk u përgjigj, më ftuan mua), festë në të cilën merrte pjesë edhe fotografi, i cili, kur unë përmenda xhaxhain e tim eti, kishte thënë me vete: «More, po unë *kam* në shtëpi një shishe!»

Sa herë që eci në dhomën e ndënjies pranë shishes së qumështit të Xhaxha Uillit më duket sikur dëgjoj tonin ngulmues në zërin e tij kur i këshillonte stërnipërit e stërmbesat që të mbaronin një shkollë. «Kjo është më e rëndësishme nga të gjitha. Mungesa e saj është e vetmja gjë që më ka penguar të ecja më shumë.»


Ai e kuptonte, dhe, përmes shembullit të tij vetjak, na bënte edhe neve të kuptonim se megjithëse zezakët kishin përjetuar shtypje të tmerrshme, Amerika ishte themeluar mbi parime, ideale e dokumente... që e detyronin atë që të bëhej një vetëkorrigjuese e përhershme. Ai e dinte se ajo ishte trualli që i rriti zezakët amerikanë. Mundësitë që iu mohuan atij tashmë do të ekzistonin për ne, thoshte ai. Por vetëm nëse ne do të arsimoheshim dhe do të ishim punëtorë të palodhur.

Më vonë mësova se shumica, në mos të gjithë imigrantët rishtarë afrikanë, rusë e aziatikë në këtë vend, me të cilët kam pasur privilegjin të takohej e të bisedoj, kanë të njëjtin vizion si dhe ai për Amerikën. Deri përpara se të shkoja në një kolegji dhe të njihesha me një studente pasuniversitare të gazetarisë, një ganeze me emrin Fortunata Masa, unë nuk e kisha vlerësuar plotësisht se me ç'sy i shikojnë të huajt tiparet pozitive të jetës amerikane dhe as që e kisha vënë re se kjo përputhej me bindjet e familjes sime. Kjo ndodhi në fund të viteve '60, kur ganezja më tha: «Gjëja që pëlqej më shumë për Amerikën është se pavarësisht se çfarë dëshiron të mësosh, atje është përherë dikush që ta mëson.»

**M**e këto fjalë shoqja ime afrikane sintetizoi me imprehtësi jetën e këtij biri vendas. (Ajo mund të kishte shtuar fare mirë edhe virtyte të tjera të jetës amerikane si mbështetja që u jep ky vend kërkimeve që çojnë, thujse çdo javë, në zbulime shkencore e risi teknologjike; sistemi politik që e admiron e gjithë bota; nxitja e shëndetshme e konkurrencës që na motivon përherë për t'u bërë sa më të mirë që të mundemi, etj.)

Në shkollën fillore kisha talent për të vizatuar. Me shkri-me merresha për qejf. Kam mbajtur ditar që 12 vjeç dhe më pas shënime; dy tregimet e para i kam botuar më 1965 në shtojcën letrare të gazetës së gjimnazit. Por vetëm vizatimi ma ndizte imagjinatën dhe i bënte mësuesit të më lëvdonin shumë. Në moshën 14 vjeç u thashë prindërve se doja të bëhesha karikaturist dhe ilustrues, një fakt që e alarmoi babanë, i cili u shqetësua se një vendim i tillë i paarsyeshëm do të shkatërronte të ardhmen time financiare. Duke ngritur zërin në maksimum, më tha: «Çak, të zinjve nuk u lejo-

het të bëjnë gjëra të tilla.» Isha i sigurt që e kish-  
te gabim. Ai kishte mbaruar vetëm klasën e  
pestë (ndryshe nga mamaja që kishte mbaruar  
të mesmen dhe ishte një lexuese e etur, anëtare  
në tre klube librash) kështu që ai nuk dinte as-  
gjë për artistët e zinj siç ishin karikaturisti i  
madh politik Oli Herrington apo E. Sims Kem-  
pbell, krijimtaria e të cilit botohej në *Esquire*  
dhe *Playboy*, Mori Tërnër apo Xhorxh Herri-  
man, krijuesi i *Krazy Kat*. (Pak njerëz e dinin që  
Herrimani ishte zezak, pasi gjithë jetën ishte  
hequr si i bardhë.) Fjalët e tim eti, të kushtë-  
zuara nga femënia e tij e periudhës Jim Crow,  
më nxitën që t'i shkruaja letër një karikaturisti  
në Nju Jork, Lorens Lariarit, për të cilin kisha  
lexuar në *Writer's Digest*. Në vitet '60 ai kishte  
qenë redaktor i karikaturave në revistën *Parade*,  
«hartues storibordi» në një studio Diznei, re-  
daktor i vjetarit *Best Cartoons of the Year* dhe  
autor i më shumë se 100 librave, disa syresh  
romane bestsellër me mistere. I tregova ç'më  
kishte thënë babai. Brenda javës Lariari më  
dërgoi një përgjigje zemërdhënëse: «Yt atë e ka  
gabim. Ti mund të veprosh si të duash në jetën  
tënde. Ty të duhet vetëm një mësues i mirë.»  
Për t'i rënë shkurt, Lorens Lariari (që e kishte  
ndërruar mbiemrin në vitet '40), një çifut me  
mendime liberale, që i inatoste shpesh fqinjët  
duke ftuar artistë zezakë në shtëpinë e tij në  
Long Ajlënd ku u jepte mësim, u bë mësuesi  
im. (Kur pa letrën e Lariarit, im atë u tërhoq  
dhe pranoi të paguante paratë për mësimet që  
merrja.) Dy vjet më vonë fillova të botoja ilus-  
trime për katalogun e një kompanie në Çikago  
që shiste lodra e rebuse dhe fitova dy çmime  
në një konkurs kombëtar të sponsorizuar nga  
një organizatë gazetarie për karikaturistët e  
shkollave të mesme. Gjatë shtatë vjetëve të  
mëpasme, në periudhën 1965–1972, botova  
mbi 1000 karikatura e ilustrime, dy libra me  
ilustrime, *Humor i Hidhur* (1970) dhe *Një Gjysmë  
Përtej Orës Kombëtare* (1972) dhe ndërsa studioja  
për gradën e Bakalaurit në gazetari në Universi-  
tetin e Ilinoisit të Jugut, krijova, drejtova e  
bashkëprodhova një serial televiziv PBS të  
quajtur «Blloku i Çarlit» (1970) në të cilin u  
mësoja të tjerëve se si të vizatonin – një seri u  
dha në stacionet e TV-ve publike në vend e  
në Kanada për rreth dhjetë vjet. Krijimtaria më  
e mirë e kësaj moshe rinore është futur në anto-  
logji dhe gjendet në botimin e Pol Mandelbau-  
mit *Fjalët e Para: Krijimtari e Hershme nga Autorë  
Bashkëkohorë të Preferuar* (1993); të Tonia Bolde-  
nit *Ua Trego të Gjithë Femijëve Historinë Tonë*



*Xhaxha Uilli iu  
përgjigj racizmit duke  
themeluar Kompaninë  
e Bulmetit Xhonson,  
një sipërmarrje që  
eci mjaft mirë në  
shpërndarjen e qu-  
mështit për zezakët e  
Juënstonit qjer në  
periudhën e  
Depresionit të Madh  
që i dha fund  
kompanisë së tij.*

(2001) dhe të Xhon Mëknellit *Bëni Humor me Mua: Antologji Humori nga Shkrimtarë me Ngjyrë* (2002).

Parashikimet e Fortunata Masës dhe të xhaxhait të baba-it tim u vërtetuan përsëri më 1970, kur iu futa seriozisht shkrimit të romaneve duke mbaruar gjashtë në dy vjet, gjë që ndodhi përpara se të gjeja një mësues të mirë, të tillë që të kuptonte dëshirën time për të eksploruar e zgjeruar traditën e shekullit të 20-të të prozës filozofike amerikane. Për fat të mirë, ndërsa po përfundoja gradën e Masterit në filozofi dhe po filloja romanin tim të shtatë, *Besimi dhe Gjëja e Mirë*, Xhon Gardner, romancieri dhe mësuesi im i shkrimit, një shkrimtar filozofik që nuk jeton më, u bë mësuesi im duke më dhënë jo vetëm udhëzime të shkëlqyera, por edhe miqësinë e tij që nga viti 1972 e gjersa vdiq në një aksident me motoçikletë dhjetë vjet më vonë. Duke qenë mësues për 26 vjet, unë di – dhe këtë e di më mirë se gjithçka tjetër – se duke filluar nga vitet '60, mundësia për të marrë njohuri është bërë tipari i vetëm më i madh në demokracinë amerikane, mundësi që fuqizon e çliron qytetarët e saj. Ajo është një dhuratë që nuk e kam quajtur kurrë si të rënë nga qielli, sidomos pas premtimit që i bëra xhaxhait të madh se «po zotni, do të bëj shkollë.» Unë e bëra timin këtë virtut të jetës së të bardhëve kur, më 1967, fillova të ushtrohesha në artet marcialë kineze te një *kwoon* në Çikago, pastaj në shkollë të tjera në Nju Jork, San Fransisko e Siatëll dhe kur bashkëdrejtova, me një mik, studion tonë Chou Lit Fut për dhjetë vjet, kur mora gradën Doktor i Filozofisë në Universitetin Shtetëror të Nju Jorkut në Stoni Bruk me disertacionin *Qenia dhe Raca: Krijimtaria e Zezakëve nga Viti 1970*, deri në krijimin e një estetike fenomenologjike për prozën artistike të zezakëve dhe, së fundi, kur – pasi mora bursën Makartur katër vjet më parë – vendosa ta thelloja përkushtimin tim të gjatë ndaj budizmit duke mësuar sanskritisht jo në universitet, por duke studiuar tekstet e shenjta të hinduizmit dhe të Advaita Vedantës në shkrimin origjinal Devanagari me një prift Vedic që jeton në Portland, Oregon, dhe që jep mësimë private. Siç e kishite thënë Fortunata, *farëdo* që të duash të mësosh në Amerikë është dikush që mund t'ju mësojë. Por me këtë liri vjen edhe një poshtëshënim: për arsye se ne gëzojmë një liri të tillë, jemi të detyruar që t'u japim të tjerëve edhe më shumë gjatë gjithë jetës sonë.

Unë e kam parë gjithmonë jetën time amerikane si një aventurë të mësuar, zhvillimi e shërbimi. Në këtë vend, asnjë individ ose grup, qofshin të bardhë a të zinj, nuk mund të më thonë që të mos ëndërroj. Apo të më censurojnë. Apo të më ndalojnë që të luftoj gjersa këto ëndrra të krijimit artistik dhe të vetëpërmirësimit të bëhen realitet. Disa janë përpjekur, sigurisht, por në Amerikë unë e di se pasionet tona përcaktojnë mundësitë tona. Nganjëherë, kur jam duke punuar deri natën vonë dhe zbres nga studioja e katit të dytë në kuzhinë për një filxhan kafe, shikoj shishen e qumështit në anë të tryezës dhe përpiqem të përfytyroj se ç'pamje mund të ketë pasur Uilli Xhonson

herët në mëngjes, përpara agimit, duke çuar shishet bosh tringëllitëse si kjo këtu nëpër rrugët e zbrazëta e të qeta nga njëri prag i një familjeje zezake në tjetrin duke u ngutur për të ecur përpara për të siguruar një vend për veten e tij dhe të dashurit e tij në rrethanat e Marrëveshjes së Re dhe të një bote që po përshpejtonte drejt luftës. Pyes veten se sa të lidhura kanë qenë ëndrrat e këtij zezaku trupgjatë, të pashëm, të palodhur, me këto shishe të vogla që mbajnë një pint qumësht. Vallë do t'i kishin thënë atij zezakët e tjerë se ishte marrëzi që të përpiquej të konkurronte me kompanitë e qumështit të të bardhëve? A kishte qëndruar ai deri vonë netëve duke pyetur veten, siç bën çdo sipërmarrës (apo artist) se a kishte të ngjarë që të dështonte keq dhe në vend të frytit të djersës dhe të sakrificave t'i mbeteshin njollat e qumështit të derdhur? Po edhe ashtu, prapëseprapë në rregull. Sepse Amerika i garantonte se do të kishte një shans tjetër për të ëndërruar përsëri. ■

**C**arlz Xhonson, Bursist i Fondacionit Makartur për vitin 1998, ka marrë çmimin Kombëtar të Librit për romanin Kalim i Mesëm më 1990 dhe në vitin 2002 është fitues i çmimit të Akademisë për Letërsinë, dhënë nga Akademia Amerikane e Arteve dhe e Letrave. Ai ka botuar tri romane të tjera – *Ëndërruesi* (1998), *Rrëfenja e Okshërdingut* (1982) dhe *Besimi dhe Gjëja e Mirë* (1974) – si dhe dy vëllime me tregime, *Çiraku i Magjistarit* (1986) dhe *Kapësi i Shpirtrave* (2001).

*Ndër librat e tij të shumtë bëjnë pjesë edhe:* Kingu: Fotobiografia e Martin Luter King të Riut (me bashkautor Bob Adelmanin, 2000), *Afrikanët në Amerikë: Udhëtimi i Amerikës përmes Skllavërisë* (me bashkautor Patrisia Smithin, 1998), *Qenia dhe Raca: Krijimtaria e Zezakëve nga Viti 1970* (1988), *Zezakët Flasin* (me bashkautor Xhon Mëklaski të Riun, 1997) dhe dy libra me vizatime.

*Veprat e Xhonsonit janë botuar në periodikë të shumtë në Amerikë dhe në vende të tjera dhe janë përkthyer në shtatë gjuhë; ai ka marrë çmimin e Arritjeve në Arte gjatë Jetës nga Këshilli Korporativ për Artet si dhe shumë çmime të tjera. Më 1999, Universiteti i Indianës botoi një «libër leximi» nga veprat e tij me titull Unë e Quaj Vetën Artist: Shkrime nga Carlz Xhonson dhe mbi Të. Kritik letrar, skenarist, filozof, lektor ndërkombëtar dhe karikaturist me rreth 1000 vizatime të botuara, ai është Profesor i Anglishtes me titullin S. Wildon and Grace M. Pollock Endowed në Universitetin e Uashingtonit në Siatëll. Mund të vizitoni edhe faqen e tij në [www.previewport.com](http://www.previewport.com).*



# Mulkerxhi Barati



Tregimin tim të parë e kam botuar në Kalkuta, kur isha adoleshente. Në të flitej për ditët e fundit të Napoleonit në Shën Helena. Ky tregim u pasua nga Mari Antoneta duke pritur gijotinën dhe nga tregime të tjera që trajtonin figura nga historia romake. Këto «kallëza» të para qenë dëshmi e standardeve të ngurta të shkollimit britanik të vajzave

nga familjet «elitare» që ndiqnin shkollën e kuvendit irlandez. Programi shkollor i Kembrixhit për Vendet e Përtejdetit i kapërcente kufijtë dhe kontinentet; vajzat mund të ishin në Hong Kong, Johannesburg, Adelaide ose Port ov Spein – kudo ku standardet vendore konsideroheshin të mangëta ose inekzistente – dhe do të ishin shkolluar po njësoj.

Gjithë puna ishte se Kalkuta (apo çdo vend) nuk ekzistonte. Ne nuk kishim jetë interesante. Kulturat tona ishin thuajse të turpshme dhe sigurisht përbënin subjekte të papërshtatshme për letërsi serioze.

Ne, sigurisht, lexonim Xhejn Ostinin dhe Virxhia Ulf. Ne u bëmë mjeshtër në letërsinë Viktoriane dhe disa prej nesh kishin mësuar përmendsh shumë pjesë nga Shekspiri. Për qejf lexonim autorë francezë e rusë, kurse për kënaqësi të fajshme zhyteshim në prozën e bibliotekës së mbështetur nga nënat tona. Lexonim, fjala vjen, Monika Dikensin dhe Dafne du Morierin. «Letërsia Amerikane» përbënte një oksimoron, ishte me pluse e minuse. Amerikanët ishin alienët e fundit për ne, shumë të zënë me prodhimin masiv të filmave për t'u marrë me libra.

Më pas, ndofta në mënyrë të pashmangshme, doli një libër, *Dublinasit*. Ai përbënte një lloj joshjeje tjetër, diçka të ngutshme e shqetësuese. Një derë ishte hapur dhe më duhej të hyja. Të shkruarit (ndryshe nga të lexuarit) nuk ishte i sigurt e i hijshëm. Papritur ndjeva se doja të bëja për Kalkutën atë që Xhojsi kishte bërë për Dublinin. Kalkuta ime gëlonte nga hipokrizia dhe mjerimi i ndrydhur. Boll me Napoleonin, ishte koha për Narendrën.

I përmend këto shqetësime të dikurshme për të sqaruar se e konsideroja veten shkrimtare që në moshë të hershme. Unë nuk dyshoj se do të isha bërë shkrimtare edhe sikur të isha martuar me një «djalë të përshtatshëm», të zgjedhur nga im atë, dhe të mos kisha ikur kurrë nga India. Por lloji i shkrimtares tek unë, megjithatë, ka të bëjë më shumë me ardhjen time në Amerikë, sidomos në Seminarin e Shkrimtarëve në Universitetin e Ajovës, me martesën time me një student (kanadez i lindur në Amerikë) dhe me vajtjen time me të në Kanada për 14 vjet. U kthyem në Shtetet e Bashkuara kur ishim 40-vjeçarë.

Punimi im i Ajovës titullohej «Pasqyra e Thyer»; në të, çdo tregim ishte një studim i frymëzuar nga «Araby» mbi çmagjepsjen e Kalkutës dhe i renditur me kujdes për sa i përket zbulesës që përmbante. Një nga tregimet që botuar në një revistë amerikane tremujore dhe për shkak të tij mora një letër interesimi nga një botues i Bostonit. Në atë kohë kisha një foshnjë dhe një ngarkesë të plotë mësimore për doktoraturën. Pasi mora gradën, i thashë redaktores se do të shkruaja një roman. Më pas doli në dritë *Bija e Tigris*, i botuar nga Houghton-Mifflin më 1972. Këtë gjë e konsiderova si fillimin e karrierës sime krijuese amerikane, por në të vërtetë ajo që fundi i «projektit» tim indian të ushqyer prej kohe.

Në vitin 1961, kur erdha për studime në Amerikë, për shkak të kufizimeve të vizës amerikane, por edhe për shkak të kufizimeve të qeverisë indiane në valutën e huaj, atje kishte pak indianë e aq më pak gra indiane në fushën e artit. Sado e vështirë për ta përfytyruar sot, atëherë nuk kishte ndonjë komunitet indian, nuk kishte modele, lexues, redaktorë të gatshëm për të pranuar vepra nga një



shkrimtar imigrant indian. Më shumë se dhjetë vjet më vonë, agjenti im i dytë më tha se nëse do të këmbëngulja të shkruaja mbi imigrantët e përvuajtur në Nju Xhërsi dhe jo për ekzotikën e klasave të larta në Kalkuta, nuk do të kisha të ardhme si shkrimtare.

Kjo mbase është arsyeja pse jam kapur kaq fort pas nocionit të tërësisë sime dhe të vendit tim në rrjedhën qendrore në letërsinë amerikane. Mbase kritikët dhe redaktorët e teprojnë nëse më shikojnë (jo vetëm mua, por edhe të tjerë shkrimtarë si unë) si gjithçka tjetër, po jo «indiane», «indio-amerikane» apo «aziatike». Por mua më nervozon shumë më tepër amiqësia e shkencëtarëve indianë dhe amerikanë me origjinë indiane të disiplinave «paskoloniale» që instinktivisht përçmojnë gjithçka që është me prejardhje amerikane. (Me sa duket, mantra e tyre është se në qoftë se Amerika ose Perëndimi në përgjithësi e quajnë veten si kulmin e evolucionit social e politik, atëherë është detyrë e të gjithë fëmijëve të kolonializmit për t'i kundërshtuar ata «asimetrikisht», domethënë me çdo mënyrë që të mundën.) Po aq përjashtuese dhe asimetrike, edhe pse pa ndonjë përfitim nga teoria pasmarksiste, kanë qenë edhe murgeshat në shkollën time të vjetër të kuvendit në Kalkutë.

Romanin tim të dytë, *Gruaja* (Houghton-Mifflin, 1975) e kam shkruar kur isha me leje krijimtarie në Kalkuta. Atëherë isha shtetase kanadeze me banim në Montreal, profesore në Universitetin Mëgill, dhe po në atë kohë bashkë me burrin tim, Klark Blejs, isha duke shkruar edhe gjysmën e një libri me shënime, *Ditë e Net në Kalkuta* (Doubleday, 1977). Vitet 1974–75 i kaluam në familjen time në Kalkuta, të rrethuar nga të afërmit e mi, ku pas më shumë se dhjetë vjetësh unë flisja në gjuhën time amtare. Pikërisht atëherë arrita në një konkluzion të thellë: unë nuk isha më indiane në mendje e shpirt.

Pesha e traditës dhe tiranitë e shumëllojshme të një familjeje dashamirëse nuk ishin më të durueshme për mua. Në bisedat e pafundme me shokët e shoqet e dikurshme të shkollës, me prindërit e motrat e mia, unë kuptova se isha larguar jo pak. Duke hapur një derë tjetër, për mua u bë e qartë se isha një shkrimtare imigrante në traditën e grupeve të tjera, më të vjetra (evropiane) të imigrantëve. Unë kisha mësuar më shumë nga Henri Rothi (*Quaje Gjumë*) dhe nga romanet e tregimet e Bernard Malamudit, se nga cilido shkrimtar indian. Dhe për të qenë më e saktë (përderisa Kanadaja kishte filluar të reagoonte kundër pranisë së papritur të kaq shumë indianëve në të), unë vlerësoja mbrojtjet e të drejtave civile të Kushtetutës Amerikane, pasi garanci të tilla mungonin në atë kohë në Kanada e Britani. Ne u kthyem në Shtetet e Bashkuara në vitin 1980.

Megjithëse fakti që isha bërë amerikane nuk kishte ardhur pa një kosto (im shoq dhe unë nuk kishim mundësi të zinim punë deri diku të krahasueshme me punët që kishim bërë në Montreal, pra të jepnim mësim në të njëjtin qytet, në të njëjtën kohë), fakti që isha bërë shkrimtare amerikane më në fund më kishte dhënë një zë dhe autoritet për të

folur për një bashkësi dhe për një ndërgjegje që po lindte. Gjatë kohës prej 14 vjetësh që kalova në Kanada, në Shtetet e Bashkuara kishte mbërritur një bashkësi indiane e qëndrueshme, madje në lulëzim. Më 1985 botova librin tim të parë me tregime, *Errësira* (Viking-Penguin), që ishte një seri portretesh të indianëve në tranzicionin midis krenarisë së ruajtjes së kulturës (mërgimi/largimi nga atdheu) dhe frikës për kapitullimin kulturor (imigracioni). Në atë libër ngeca në vetë temën e tij, në «temën time të madhe» që ishte transformimi në të gjithë lavdinë e tij groteske. Imigracioni shpesh ka të bëjë me shprishjen dhe rënien shoqërore. Jo rrallë imigrantët bartin vurrata e kore plagësh për shkak të sinjaleve të pakapura dhe të shenjave të lexuara gabim. Ata e kanë shitur (herë me përulje, herë me ekzaltim) vendin e caktuar që kanë pasur në një shoqëri të stabilizuar për një shans të çmendur për të arritur një diçka të pakapshme të quajtur lumturi vetjake. Unë nuk them se do ta gjejnë, por mjafton që e provojnë fatin.


Në këtë frymë shkrova një vëllim të dytë me tregime, *Ndërmjetësi* (Grove, 1988), dhe një roman, *Jasemini* (Grove-Weidenfeld, 1989). Në kohën e shkrimit të tyre (vëllimit me tregime dhe romanit), tema e «transformimit» më kishte dhënë dorë të lirë për të shkruar duke qenë e pozicionuar në gjirin personazheve dhe të sfondeve të larmishme. Tani shqetësimi im kishte të bënte me një transformim me dy kalime që ishte njohja, nganjëherë e dhimbshme, nga ana e bijve dhe e bijave vendase të Amerikës se identiteti i tyre kishte ndryshuar nga këta imigrantë të rinj «ekzotikë» po aq sa influenca amerikane kishte shkaktuar transformime të paparashikuara mbi ardhacakët më të fundit nga nënkontinenti, Lindja e Mesme, Amerika Latine, Filipinet dhe Azia Juglindore.

**T**ri romanet e mia të dekadës së kaluar, *Mbajtësi i Botës* (Knopf, 1993), *Ma Lër Mua* (Knopf, 1997), dhe *Bija e Dëshirueshme* (Hyperion, 2002) trajtojnë çështje që më duken vazhdim logjik i të njëjtit shqetësim tematik. Tani që një «Amerikë e re» shumë e dukshme e ka afirmuar veten e saj në kontinent, si mund t'u përshtatet ajo ritmeve më të thella të Amerikës, madje një historie amerikane që në sipërfaqe duket se e ka mohuar vetë ekzistencën e saj? Romani i parë nga këta të dy përfshin si ngjarje bashkëkohore, edhe ngjarje nga Amerika e viteve 1650 duke i bërë njëfarë restaurimi tapicerisë së Mugalit për ta sjellë te grija mbizotëruese e *Letrës së Purpurt* të Hothornit. Romani i dytë trajton trashëgiminë e Vietnamit nga pikëvështrimi i një jetimi të Azisë, kurse romani i fundit trajton pasojat e paqëllimshme të globalizimit dhe përfshin historinë katërqindvjeçare të një familjeje përfaqësuese indiane si këtu, edhe në atdhe.

Unë dua të pastroj ajrin e përçmimit të pamerituar ndaj letërsisë amerikane, tani jo më nga murgeshat irlandeze apo intelektualët indianë, por nga shumë njerëz përparimtarë indigjenë me synime të mira. Mbrojtja ime mund të tingëllojë e ashpër dhe mund të shkaktojë keqkuptime. Në vitet

'70 e '80 kemi dëgjuar shumë kritika nga lexuesit (nga kategoritë e njerëzve parimorë që i miratojnë përherë përzgjedhjet e çmimit Nobel) se shkrimtarët amerikanë – me pak përsjetime të kuptueshme – i kanë shpërfillur tmerret e llahtarshme të shekullit të 20-të.

Ne shkrimtarët amerikanë kritikohemi për faktin se shqetësohemi për diçka që s'ka të bëjë me mundimet që shkakt-



ton çështja e identitetit. Dhe kur romanet tona trajtojnë format e vuajtjeve, na akuzojnë se luajmë shtypjen-smirën. Autorët dhe lexuesit nga vendet ku një libër mund të çojë në burgosjen ose internimin e autorit pyesin se si të superprivilegjuarit amerikanë mund të flasin me kompetencë për varfërinë, padrejtësinë e korrupsionin. Ç'dinë shkrimtarët ame-

rikanë për shtypjen e shkaktuar nga tradita, familja, feja, shteti dhe pushtuesi i huaj? Amerikanët e zgjidhin një padrejtësi në gjyq. Mund t'i shpëtojnë brutalitetit familjar me divorc. Mund t'i heqin me vota maskarenjtë nga zyra. Mund të blejnë ilaçe të fjalës së fundit për të lehtësuar ankthet dhe përmirësuar ndjenjën e vetërespektit.


Edhe kritiku pjesërisht dashamirës nga Amerika Latine ose nga vendet paskoloniale – kritiku që nuk shpreson se në rrugët tona plot dyqane mund të mbijë një Markes ose një Solzhenjicin, që nuk e përbuz obsesionin e industrisë botuese të SHBA me përparimet e mega-dollarit dhe me turnetë e librave në formë rrethi – dëgjohej të pyesë: «Amerikë, ku i ke shkrimtarët e tu të shqetësuar, me ndërgegje të plagosur?» A ndihesh mirë që s'ke shkrimtarë të barasvlershëm me gjermanët e pas-Luftës si Grasi e Bëli, me afrikanojugorët e bardhë si Gordimeri e Koetzi, me izraelitët si Grosmani e Ozi, apo me australianët e mrekullueshëm si Maloufi dhe Kënili? (Përgjigja e shkurtër është se ne kemi shumë dhe në pjesën më të madhe, pesha e padrejtësië sociale e historike ka rënë mbi ta personalisht dhe asimetricisht. Përgjigja më e gjatë është: shiko poshtë sipërfaqes së zbrazët, të mirëmbajtur. Edhe nën një sipërfaqe të vogël zhgjëndre mund të fshihet një damar i pasur padrejtësië.)

Me fjalë të tjera, ç'ke bërë ti si shkrimtar për shoqërinë ku mungojnë institucionet dhe traditat demokratike, një opozitë luajale, një shtyp i lirë, një gjyqësor i pavarur dhe

një shërbim civil i ndershëm? Çfarë përgjegjësish ndieni ju si shkrimtar i prozës artistike për vendet që kanë qenë të shtypura nga fuqitë koloniale, lufta, sëmundjet masive, intoleranca fetare e klanore, policia, gjykatësit dhe gazetarët e korruptuar, apo për shoqëritë e mbipopulluara, me nivel të ulët arsimor, pa kushte shëndetësore dhe psikologjiksht të plagosura? Përgjigja për këtë është: shumë pak. Si eseiste, qytetare e shqetësuar dhe udhëtare e botës unë jam krejtësisht e vetëdijshme për influencën e vendit tim në botë për të mirë apo për të keq. Unë e njoh historinë e gjatë të angazhimit dhe të inkurajimit amerikan në forcat globale, gjë që shpesh rezultojnë në shkatërrime masive (ose në shkrajime të heshtura apo aktive që sjellin të njëjtat pasoja) dhe përiqem të flas, të veproj e të votoj si duhet. Në vendet ku individit nuk gëzon mjete të sigurta për të gjetur drejtësi, shpesh shkrimtarët futen me detyrim në shërbim si dëshmitarë të parë ose si mjeti i fundit. Por në demokracitë liberale me institucione të stabilizuara, shkrimtarët e prozës artistike mund të sigurojnë një minimum besimi vigjilent duke e çliruar veten për t'i shpallur botës lavditë e ngulitura në ndërgegjen individuale. Prandaj Xhojsi dhe Prusti, Ulfi, Borgesi dhe Nabokovi nuk e morën kurrë çmimin Nobel. Ndofta prandaj Vargas Losa, Kundera, Ousi, Apdajku dhe Rothi do të presin më kot.

**N**uk është se jemi frikacakë, të struktur, ose me ndërgegje të cunguar; shkrimtarët, me disa përjashtime, janë fis i një mendësië. Në rrafshin ndërkombëtar unë kam ndeshur shkrimtarë seriozë universalisht skeptikë ndaj autoritetit, ironikë e dashamirës ndaj të humburve e të hutuarve. Ata vëzhgojnë me kënaqësi kontradiktoren dhe absurden; ata nuk vonojnë të vlerësojnë veprën e tjetrit dhe të njohin forcat e ndryshme që e plazmojnë atë. Nadine Gordimer ka thënë se donte të shkruante satira shoqërore, por situata shtypëse në Afrikën e Jugut e bëri të pamundur. Kineasti bengalez Satiakhit Rai donte të bënte filma me fantazi dhe filma fantastiko-shkencorë, por Kalkuta, me të gjitha problemet e magjepsjet e saj, nuk e lejonte. Kërkimi i përshtatshmërisë dhe i angazhimit i merr një shkrimtari të paktën po aq sa i jep.

Në kohën kur erdha në Shtetet e Bashkuara 40 vjet më parë si studente pasuniversitare në Universitetin e Ajovës, i parakohshmi Filip Roth botoi esenë e tij të mirënjohur «Shkrimi i Prozës Amerikane». Përmbajtja e asaj eseje mbetet aktuale, pasi ai shtroi në të shqetësimet parësore të një brezi të ri shkrimtarësh amerikanë: si rivalizon imagjinata private me mendjelehtësinë, absurditetin e skajshëm, vulgaritetin, dhunën dhe aftësinë e jashtëzakonshme të kulturës amerikane për riprodhim? Vetë çudia e saj kërcënon të tallet me çdo përpjekje për ta shpi-



kur atë. Dhe këtu kemi një ndryshim të madh midis prozës amerikane dhe thujasë asaj të çdo vendi tjetër: këtu nuk ka asgjë të dhënë, të përhershme; çdo gjë është në ndryshim, e sfidueshme. Nuk ka histori, nuk ka barriera, tabu, asnjë vendim ligjor nuk mund të ndërmerret dhe asnjë polici e fshehtë nuk të troket në derë. (Ose, duke parashikuar kundërshtimet që do të nxirnin teoricienët kolonialë ndaj pohimeve të tilla të përgjithshme: nëse ajo troket në derën tuaj – dhe askush nuk thotë se nuk e ka bërë në të kaluarën dhe se nuk do të provojë përsëri – ju, të paktën, keni mjete për zhdëmtim.)



Shumë shkrimtarë në botë vuajnë nga tepria e paracaktimeve, e realiteteve të trashëguara me pasojë që s'falin, e mundësive të cuniguara dhe e horizonteve të mbyllura. Ky fakt pasuron prozën e tyre, shton gjasat dhe ngre interesat. Kurse shkrimtarët amerikanë shprehin hutim në një xhungël lirie, në një domen të gjerë improvizimi spontan ku shanset janë të shumta që përpjekja më e mirë

të mos jetë as në lartësinë e satirave të radhës në lajmet e CNN. Cili satirist i marrë planifikoi zgjedhjet 2000 në të cilën një fletëvotimi e sajuar keq luajti një rol vendimtar në përcaktimin e presidentit të ri amerikan? A është vallë i përfytyrueshëm një veprim i tillë komik diku gjatë në botë? Dhe cila do të kishte qenë rrjedhoja e përgjakshme e tij?

Proza amerikane shkruhet në kontekstin e një pafajësie relative, një realitet që është sa kufizues, aq edhe çlirues. Nëse proza amerikane ka rëndësi në botë, kjo është për pafajësinë e saj të çuditshme që ka në qendër. Gjë që është veçanërisht e vërtetë për prozën e imigrantit indian, pasi shumë prej nesh erdhëm këtu pas luftërave kulturore e politike të viteve 1960 dhe nuk i përjetuam luftërat për të drejtat civile ose qëndresën e Vietnamit. Ne jemi përfituesit e shumë vuajtjeve dhe të një heroizmi të madh dhe nuk na është bërë thirrje për të paguar kuotat tona. Derisa ta bëjmë këtë, pafajësia jonë do të jetë e përkohshme, liria jonë ende e kushtëzuar.

Unë kam qenë me fat që jeta ime si krijuese qëlloi në një kohë me ardhjen e të tjerëve si unë, madje unë kisha mbërritur pak më herët dhe kështu u urova mirëseardhjen. Unë e fillova karrierën time duke shkruar në stilin komik – një tipar që e kam trashëguar nga normat e shkollimit indo-britanik – sepse vitet e para të jetës sime indiane në këtë kontinent dukeshin të freskëta e të harlisura, të pangopura, ambicioze, të këndshme e të ngathëta. Duket se kam qenë dëshmitare e një intervali të bekuar, e një apo dy brezave në bashkësinë e imigrantëve përpara se kujtimet e Botës së Vjetër të zhdukeshin krejt dhe bashkë me to edhe kodet e normat që kanë rregulluar e kufizuar shprehjen e vetvetes për mijëra vjet. Unë e di se kur ndryshoi kjo për mua. Më

1985, një avion i Air India i nisur nga Toronto dhe Montreal me 329 pasagjerë në bord bashkë me ekipazhin u bombardua nga qielli 110 milje larg bregut të Irlandës. Deri në bombardimin e Qendrës Tregtare Botërore ai ka qenë akti terrorist më i përgjakshëm në epokën moderne; ai ende mbetet sulmi i vetëm ajror më fatal. Thujasë të gjitha viktimat ishin kanadezë me origjinë indiane e po të tillë edhe shkaktarët (kalistanë – separatistë Sikh). Ne njihnim disa nga viktimat nga të cilat shumica qenë nëna me fëmijë që shkonin në atdhe për verë. Lulja e atij brezi, e lindur në Kanada, u vra gjatë shpërthimit. Në valën moderne të brutalitetit të ditëve tona, imigrantët indianë, «pakica model», njerëz të papërlyer në krime, me arritje të larta, qenë të parët që u goditën nga akti terrorist masiv në këtë kontinent.

Im shoq dhe unë shkruam një hulumtim mbi këtë tragjedi, *Brengë dhe Terror* (Viking-Penguin 1987) dhe gjatë procesit të intervistave me të afërmit e viktimave, me policinë, avokatët e madje me vrasësit dhe mbështetësit e tyre, kuptimi im për shanset e imigracionit ndryshoi përgjithnjë. Ai nuk është thjesht komik, thjesht letrar, ai është një histori e madhe, e tillë që amerikanët do ta shkruajnë në dekadat e ardhshme. ■

**B**arati Mukerxi, autore dhe profesoreshë e anglishtes në Universitetin e Kalifornisë, Berkli, është e mirënjohur si prozatore dhe analiste sociale. Romani i saj më i fundit është *Bija* e Dëshirueshme (*Hyperion*, 2002). Romane të tjera të saj janë *Mbajtësi i Botës* (1993), *Jasemini* (1989), *Gruaja* (1975) dhe *Bija e Tigris* (1971). *Tregimet e saj gjenden në Ndërmjetësi* dhe *Tregime të Tjera* (1988) dhe *Errësira* (1985). *Publicistika e saj përfshin Brengë dhe Terror: Trashëgimia e Ankthshme e Tragjedisë së Air India, e shkruar me Klark Blejsin* (1987) dhe *Ditë dhe Net në Kalkuta po me Klark Blejsin* (1986).

*Mukerxi ka marrë gradën D.F. (Ph.D.) në anglisht dhe në letërsinë krahasuese nga Universiteti i Ajovës më 1969. Në vitet 1970 ka dhënë mësim në Universitetin McGill, Montreal, Kanada. Në vitin 1980 shkoi në Shtetet e Bashkuara dhe që nga viti 1989 jep mësim në kolegje të ndryshme si dhe leksione në Universitetin e Kalifornisë në Berkli. Pjesa më e madhe e krijimit të saj është kronikë për anët e ndryshme të përvojës së imigrantëve.*

*E lindur më 1940 në Kalkuta, Indi, në një familje profesionale, Mukerxi mori arsim klasik në traditën britanike, siç ajo shkruan në esenë e saj. Mes viteve 1948 dhe 1951 ka jetuar me familjen në Angli. U diplomua nga Universiteti i Kalkutës më 1959 dhe më 1961 mori gradën Master në anglisht dhe në Kulturën e Lashtë Indiane. Një vizitë që bëri në Universitetin e Ajovës më 1961 për të ndjekur Seminarin e Shkrimtarëve ndryshoi jetën e saj dhe e përqendroi fuqimisht në atë çka ajo kishte ëndërruar të bëhej: shkrimtare profesioniste. Mukerxi kishte planifikuar të kthehej në Indi, po kur ishte në Ajovë u njoh e u martua me Klark Blejsin, një shkrimtar kanadez/amerikan, një vendim që i siguroi se që atëherë e tutje jeta e saj do të ishte pjesë e dy botëve. Një kritik shkruan: «Mukerxi e ka afirmuar veten si një anëtare e fuqishme e skenës letrare amerikane; veprat e saj më të spikatura pasqyrojnë jo vetëm trashëgimë e saj indiane, por edhe kënaqësinë e saj nga përqaftimi i Amerikës.»*



# Nai

## Nejemi Shibab



### JETA E NJË SHKRIMTAREJE, E KALUARA DHE ETASHMJA I.

Në qendër të Shteteve të bashkuara, në mes të shekullit të 20-të, shumë njerëz kishin ardhur nga diku gjetkë dhe vrisnin mendjen se si t'i vinin gjërat në vijë.

Kanadezët francezë kishin udhëtuar drejt jugut në St. Luis me një

karrocë të madhe rrapëllitëse të mbushur me fëmijë e triko. Një familje italiane miqësore kishte mbjellë drurë të vegjël të rumbullakët në kopshtin e saj. Njerëzit e saj u treguan të sapoardhurve se ku mund të blenin zarzavate e farëra të mira. Anëve të një rruge gjithë gropa, pa trotuare, familjet ngrinin banesa të thjeshta, çpакetonin lugët dhe makinat qepëse dhe bashkoheshin jashtë në të perënduar të diellit. Përpara muzgut gjithçka bëhej e butë dhe ëndërrimtare, ajri plot me aksente dhe aroma. Përgjatë rrugës, fermerët që përdornin plehra organike flisnin për gjyshërit e tyre imigrantë nga Gjermania që kishin ëndërruar për të zotëruar një copë tokë në Botën e Re.

Hidhja sytë rrotull. A ishte e re kjo? Mua gjithçka më dukej e vjetër.

Fillova të shkruaja poezi në moshën gjashtë vjeçe për të parë atë që ekzistonte prej kohe. Aksentet dhe shkrirjet e këndshme.

Ku ishin indianët? Dikush gjithmonë do të mungonte. Unë i ndieja ata te gurët dhe drurët, te lumi i thellë i quajtur Misisipi – me një emër indian – që rridhte në heshtje.

Babai im palestinez erdhi në Shtetet e Bashkuara më 1951 me një anije dhe përpara se anija të qëndronte në mol në qytetin e Nju Jorkut, ai i hodhi në ujë pantallonat e ngrëna qysh në Xheriko. Meqë do të niste një jetë të re, ç'i donte pantallonat e vjetra? Si student universitar me bursë ai kishte kërkuar një shkollë «në mes të Amerikës» duke menduar se një pozicion i tillë gjeografik do t'i jepte mundësi për të hyrë lehtë kudo. Ai nuk e kishte idenë se sa i madh ishte ai vend. Vetëm pas shumë vjetësh pa Kaliforninë.

Kur mbërriti në Amerikë nuk i shkonte në mend se mund të martohej me një amerikane (me origjinë gjermane/zvicerane). Shtetet e Bashkuara ishin plot me të papritura.

Megjithëse e merrte malli shumë për vendlindjen dhe shpesh e shihte në ëndërr, u zhyt në jetën e re me entuziazëm. Ai tregonte rrëfenja popullore gazmore nga Lindja e Mesme dhe këndonte në arabisht. Ne hanim *hummus* (pure qiqrash), kurse komshinjtë hanin hamburgera dhe spageti. Im atë i donte Shtetet e Bashkuara për optimizmin e njerëzve të këtij vendi dhe për mikpritjen që i kishin bërë atij, siç u kishin bërë edhe miliona imigrantëve përpara tij.

Çdo gjë ishte e mundur në Shtetet e Bashkuara – dhe kjo nuk ishte një fjalë goje, por e vërtetë. Ai mund të mos bëhej i pasur brenda natës, por mund të shiste siguracione, të importonte dhurata shumëgjyrshe nga vendet e tjera të botës, të hapte dyqane të vogla, të bëhej gazetar. Ai mund të bënte *çdo gjë*. Kjo ishte kënaqësia që i jepte ky vend dhe këtë ndjenjë e ruante në zemër si një gjë të shtrenjtë. Ai e donte këtë vend dhe ishte krenar që ishte bërë shtetas i tij, edhe pse nuk e kishte menduar këtë gjë kur kishte ardhur së pari. Por pas një kohe të shkurtër ky vend, Shtetet e Bashkuara, të hyjnë në trup e në gjak, bëhen pjesë e ëmbël e melodisë dhe e historisë suaj dhe ju doni t'u përkisni atyre po aq sa ato juve.

Ime më, e rritur në një familje amerikane me një baba të rreptë luterian dhe me një nënë të ndrojtur e të ndrydhur ishte e gatshme të shijonte kënaqësitë e një bote më të gjerë – Receta të Reja, Ide të Reja! Ajo shkoi në një shkollë arti ku studioi me disa nga artistët më të mëdhenj



të shekullit të 20-të. Ajo na merrte në mbledhjet e kuake-rëve dhe në Shoqatën Vedanta ku neve më shumë na pëlqente Suami Satprakashananda me të cilin, prej vitesh, hanim puding orizi në ditëlindjen e tij. Ne shkoni në një kishë moderne të hapur për të gjithë të quajtur Unity që thoshte se çdo rrugë ishte një rrugë e nderuar. Im atë i vizitonte këto vende adhurimi bashkë me ne, megjithëse që rritur musliman.

Prindërit e mi pajtoheshin me çështjet më të rëndësishme – se kishte shumë rrugë për tek e vërteta. Dhe, në fakt, kishte shumë rrugë. Pse të pretendosh ndryshe? Asnjë rrugë nuk është e vetmja rrugë. Kushdo që thoshte se vetëm një fe ose një kulturë ishte «e vetmja e drejtë» të zhgënjente dhe dukej qesharak. Ditët e organizimit fisnor dhe të përjashtimisë parimore kishin marrë fund, ishin vjetruar. Ato *duhej* të merrnin fund. Për të jetuar me drejtësi, tashmë të gjithë qytetarët e botës po përziheshin me shoqi-shoqin. Gjatë kësaj rruge ne mësonim të respektonim gjithë të tjerët, *veçanërisht* ata që nuk ishin tamam si ne. Kjo ishte e vetëkuptueshme, thelbësore.

Megjithëse tashmë integrimi kishte nisur në Shtetet e Bashkuara, shumë njerëz e kishin ditur prej kohe se ne ishim të gjithë të lidhur. Se nuk mund të thoshe «të drejta të barabarta» dhe «proces i rregullt gjyqësor» dhe të përjashtojë dikë. Vetëm se sistemeve zyrtare u duhej një kohë më e gjatë për t'i realizuar. Gjatë viteve jam kthyer shpesh në ato lagje modeste dhe i kam gjetur VËRTEET të përzier, familje zezakësh e të bardhësh që jetojnë krah për krah ashtu siç kisha dëshiruar që kur kisha qenë e vogël.

E kam pasur përherë të vështirë për të kuptuar se ku i vizitonin njerëzit kufijtë e tyre.

Unë mbase kam filluar të shkruaj thjesht për të parë se *ku ndodheshim ne* – ku ndodhej grupi simpatik i personazheve të mi të apasionuar – lidhur me nevojat, shpresat, mbjelljet dhe pritjet e tyre, me jetën e tyre në ngastrat qendrore në qytetin e tyre qendror. Qendror ishte madje edhe emri i shkollës ku shkoni ne. Ajo është edhe sot, një ndërtesë solemne me tulla të kuqe, e lashtë e krenare. Në korridor është ende portreti solemni i Xhorxh Uashingtonit. Unë e shikoja në sy dhe e pyesja me vete: *a jeni i kënaqur me vendin tuaj?*

Cili ishte kuptimi i të qenit në mes të gjithçkaje? I thosha vetes, *ky është vetëm një vend, ky nuk është bota! Boll mendove se je kaq i rëndësishëm!*

Por hollësitë e çdo dite të rëndomtë më dukeshin të rëndësishme e të çmuara në shkurtësinë e tyre të këndshme. Gjërat e vogla që njerëzit e tjerë i shpërfillnin më dukeshin si thesare e zbulësia. I mbaja shënim që të mos i harroja. Por nuk është se unë fillova të shkruaja ngaqë përfytyroja një «karrierë të ardhshme.»

Askush nuk më tha ndonjëherë: *Atë nuk duhet ta thoni. Nuk duhet ta thoni ashtu.*

Shkruaja me lapsa të verdhë në fije letre, në shpinat e geseve të letrës. Nganjëherë poezitë e mia ua jepja të tjerë-

ve. Një mësuese më tha: «Zëri yt do të jetë instrumenti yt më i fuqishëm» dhe i besova. Shkoja në shkollë dhe kthehesha në shtëpi ku më prisnin fjalët. Shpejt fillova të shkruaja në anët e faqeve të fletoreve të punës, në anët e fletoreve të matematikës. Luaja me fjalët, i stivosja dhe i riorganizoja. Poezia më dukej e bukur për shkak të atij boshllëku të madh rreth saj. Të shkruarit ishte një mënyrë për të hedhur spirancën, për të parë se çfarë të gozhdonte.

Në lagjen tonë ku jeta gjallonte këndshëm me atë përzjerje aromatike historish, njerëzit i donin të mirën njëri-tjetrit, këmbenin të rejat e ditës, përfytyronin të mirat që do të vinin në ditët e ardhme. Askush nuk kishte shumë para, por secili kishte shpresë. Kurse unë kisha bibliotekën që ishte më e mirë se një valixhe me flori. Rabindranat Tagora, poeti i madh bengalez, kishte shkruar se si i kishte vënë fjalët në një varkë të vogël duke i dërguar të notonin përgjatë rrjedhës duke pyetur veten nëse dikush, në një «vend të largët», mund t'i lexonte dhe të dinte se kush ishte ai. «Unë e di!» thirra unë që përtej detit. «E di se kush je dhe më pëlqen! Unë jam shoku yt i largët!».

Të njëjtën përgjigje ia sokëllita edhe Margaret Uajz Braunit, Emili Dikinsonit, Uollt Uitmanit, Karl Sendbërgut, Lengston Hjuzit, Uiliam Blejkut, Luiza Mei Askotit, poetit japonez Basho. Lista do të shtohet e do të shtohet. Unë isha përherë duke kërkuar zëra nga përtej oqeanit, nga ato botë të misterhme dhe të rëndësishme për të cilat kishim dëgjuar. Më dukej se leximet po e zgjeronin horizontin tim duke e bërë më të gjerë se horizontin e hapësirës. Kuptimi i zbulimit të revistave që ftonin fëmijët t'u dërgonin krijime ishte se dikush, që nuk e njihje, donte të të dëgjonte zërin. Po të ta botonin vjershën tënde, bota jote do të zgjerohej përtej gjithçkaje që mund të të kapte syri.

Por vetë të shkruarit ishte fuqia, shpallja e përditshme e pavarësisë që thoshte: unë jam pjesë e kësaj larmie dhe stofi të ndërthurur, por prapë, *nuk* jam kaq. Jam më shumë se kaq. *Jam ajo që jam.* Gjithçka ishte e mundur në faqen e fletores.

Unë qëndroja jashtë rrethit për të parë se çfarë po ndodhte. Unë isha syri vëzhgues, dokumentuesi i miniaturës dhe i së harruarës. Ajo që ishte thënë e kishte humbur, do të kumbonte në veshët e mi.

**T**ë shkruarit ishte një mënyrë për ta ngadalësuar kohën, për të rivendikuar një çast dhe një hapësirë në tokë, për parë BRENDA gjërave, jo dukjen e tyre. Po të shikonim thjesht në sipërfaqen e gjërave do të ndiheshim menjëherë të ndarë nga të tjerët. Duke kapur kuptimet dhe ndërlikimet më të thella, mundësitë metaforike të çdo skene, njeriu mund të gjejë një pafundësi fijesh të ndritshme e të lidhura.

Hollësitë që mbaja shënim jo doemos ishin të kuptimshme ose dramatike – ato mund të ishin një kukafshehti në mes të pishave, aroma e kedrit në qilarin e gjyshit, apo rrugicat e trishtuara, të harruara, nëna e shoqes sime në një karrocë invalidi që më fliste për trimërinë, për lajthatat e

lulëzuara, për kovat me qershi me të cilat bënim byrekë, për mësuesen që kishte 50 vjet që i donte nxënësit dhe që na thoshte të mos pushonim kurrë së besuari në zërin tonë, për djalin në shtëpinë e komshiut për të cilin thuhej se kur bëhej shtatë vjeç, *nuk do të rritej më*. U ndodhëm atje kur të prindërit e tij i kumtuan lagjes: nuk do të rritet më. Ai ndodhej bashkë me ne kur ata e thanë këtë gjë dhe unë pashë thellësinë e syve të tij të dhimbshëm.

Ku mund ta çojë këtë kumt nëse nuk do të shkruaje?

Në kujtesë, sigurisht, por unë doja të kisha mundësi që t'i rikthehesha, të mendoja për kumbimet e tij, ta mbaja në duar, ta vështroja.

Unë kisha nevojë të gjurmoja më shumë për gjërat e vështira: për përmallimet e papërbushura, rëniat shpirtërore, zhgënjimet, ankthet, konfliktet.

Nëse të shkruarit ishte patericë, unë kisha nevojë të ecja.

## 2.

Ka kaluar kaq kohë që nga fëmënia, por unë ende ndihem më afër fëmijëve se të rriturve. Ç'është ajo që gjendet në atë mënyrë të hershme të të shikuarit dhe që vazhdon të na drejtojë edhe kur sytë i kemi të lodhur, edhe kur kemi dëgjuar aq lajme të këqia sa që na bëjnë të strukemi e të mblidhemi lëmsh?

A i kanë arritur njerëzit ëndrrat e tyre më të mira për atë që qeniet njerëzore mund të bëhen? A e kemi ndihmuar sa duhet njëri-tjetrit? Sa herë i dëgjojmë vërtet të tjerët? A jemi vërtet aq të interesuar sa të japim opinionet tona kur të tjerët janë duke folur? A nisemi nga lakmia për shumë nga vendimet tona?

A nuk duhet të dëgjojmë një zë të ri të paktën çdo javë?

Shkrimtarët amerikanë udhëtojnë shumë në Shtetet e Bashkuara. Ne udhëtojmë edhe në vende të tjera ku bisedojmë, dëgjojmë, zbulojmë shkrimtarë për të cilët duam të dimë më shumë. Kush do të kishte menduar se shkrimtarët do të ishin endacakë të tillë? Ne na ftojnë për t'u folur studentëve, për të mbajtur fjalime, për të ndjekur konferencat.

Unë vizitova një shkollë të mrekullueshme në Bahrein nga ku një vajzë e vogël më dërgoi letrën më të bukur që kam marrë që prej shumë kohe. Ajo pyet: «Çfarë ju shkakton juve keqardhje?» M'u desh thujse një ditë e tërë për t'iu përgjigjur.

Padëshira e dikujt për të komunikuar të shkakton keqardhje. Ne duhet ta nxitim përherë njëri-tjetrit që të përdorim zërat tanë në situata të vështira. Nëse njerëzit do të kishin më shumë besim te Fuqia e Zërit, a do të kishte kaq dhunë në botë?

Shkrimtarët amerikanë ndihen me fat kur dikush do që t'i dëgjojë – tekefundit, ne kemi një histori kaq të shkurtër. Ne ndihemi me fat që ulemi me lapsa e letër duke vëzhguar e përsiatur. Kjo ka qenë ëndrra ime më e mirë për të ardhmen. Në ëndrrën time nuk kishte kompjutera, por edhe ata janë bërë miqtë tanë.

Gjer më sot askush nuk më ka thënë: *Ju nuk duhet ta thoni atë*. Mund të më kenë thënë: *Faleminderit, por ne nuk duam*

*ta botojmë këtë gjë, ose: Kjo sigurisht mund të përmirësohet, por nuk më kanë thënë: Ju nuk duhet ta thoni atë.*

Liria e fjalës është dhurata më e madhe që Amerika na ka dhënë të gjithëve, gjë që unë do ta ruaj përherë si një thesar dhe do të vazhdoj t'i porosis njerëzit që të mos e harrojnë, sepse ndodh që kur e ke një gjë përgjithmonë, nuk e kupton që e ke.

Ne ndiejmë përgjegjësi për të folur për veten tonë dhe për bashkësitë për të cilat interesohemi. Përkthimet kanë hapur kaq shumë botë ndërmjet vendeve – është privilegj dhe përgjegjësi që ta lexojmë njëri-tjetrit.

Kudo – kjo është qendrore.

Ne duhet ta mbajmë mend këtë dhe ta realizojmë.

Vitet e fundit, shumë shkrimtarë amerikanë kanë shkruar, ose, si fillim, kanë redaktuar libra mbi kultura që nuk kanë qenë të tyre. Duke jetuar në një lagje kryesisht hispanike në qendër të San Antonios, Teksas, unë mora një kulturë që nuk ishte imja për nga origjina, po për të cilën unë kujdesem veçanërisht shumë. Mbase duhej të jetoja në një



qytet hispanik që të mësoja se ç'do të thotë vërtet të jesh arabo-amerikane – se sa i çmuar është spektri i aromave, në sa mënyra të shumta ato ndërthuren e shkrihen së bashku.

Kohët e fundit, një gazetar afro-amerikan e mbylli rubrikën e tij mbi një serë tragjedish vendore koreane duke thënë: «Duhet të mos harrojmë: jemi të gjithë koreanë.»

Një skenë nga disa javë më parë.

Vend i veprimt: Festivali i dytë i Poezisë Skagit Rivër, La Konër, Uashington, një orë e gjysmë në veri të Siatllit, përgjatë kanaleve të ndritshme ujore që të çojnë te ishujt San Juan dhe te balenat udhëtare.

Anëtarët e fisit Suinomish (amerikanë autoktonë – të ashtuquajturit indianë amerikanë që përherë doja t'i shikoj kur isha e vogël) janë duke tërhequr trungje të thatë e të mëdhenj për t'i çuar te zjarret e ndezura në shtëpitë e tyre të shenjta të tymit ku qindra njerëz rrinë ulur në shkallët e drunjta për të dëgjuar lexime poezish.

**S**onte ky fis amerikan autokton ka pjekur në zjarr salmon të freskët, ka gatuar fasule në poçe të mëdha dhe ka ftuar qindra njerëz për darkë. Ne hamë së bashku në tryeza të gjata në një shtëpi takimesh përtej rrugës.

Mbrëmja e leximit hapet me daulle e këngë. Njerëzit me astmë qëndrojnë pranë derës që të mos thithin shumë tym. Një plakë Suinomish në të tetëdhjetat, me një shall mbi supe, ngrihet e tregon një rrëfenjë për të na uruar mirëseardhjen.

Janë këtu Pet Mora (latine), Li-Jang Li (kinezo-amerikane), Eduard Hirsh (izraelito-amerikan), Xhoi Harxho (amerikan vendas), Kurtis Lemkin (afro-amerikan, që u bie veglave të afrikanëve autoktonë kur reciton poezitë e tij), Kolin Mëkellroi (afro-amerikan), Medlin Dëfris (murgeshë për më shumë se 30 vjet përpara se të largohej nga urdhri i saj), hokatari Tomas Luks dhe Devid Li, që shkruan në të folmen e bisedore të qytetit të vogël. Ky festival duket si një kuvend ngaqë të gjithë jemi takuar më parë, kemi lexuar krijimet e njëri-tjetrit dhe vlerësojmë mbi gjithçka fuqinë e komunikimit. Unë shikoj rreth hapësirës së madhe me tym poetët dhe dëgjuesit e të gjitha moshave dhe mendoj: *e pabesueshme*. Çdo zë është i mirëpritur. Askush nuk thotë: përdor stilin tim. Unë mendoj: *kjo është familja ime e dytë*.

*Familja që më ka adoptuar*. Bota e fjalëve që më ka ndihmuar që të bëj një hartë të kësaj jetese të mistershme. Sa të larmishëm jemi në këtë trevën tonë të allasojshe, të shumëngjyrshme, me gjurmët tona që pikëzojnë kaq shumë peizazhe, kultura e histori gjer më sot!

Po qe se do të zgjidhja një fjalë për të përshkruar këtë botë, ajo do të ishte *pranim*.

Në një familje kaq të gjerë zërash askush nuk mund të përjashtohet. A më dëgjoni? Varkat e vogla po lundrojnë drejt jush. ■

**N**jë jemi Shihab Nai u rrit në St. Luis dhe Jeruzalem dhe jeton në San Antonio, Teksas, me të shoqin, fotografën Majkëll Nai, dhe djalin e tyre. E diplomuar në Universitetin Triniti, në librat e saj të fundit përfshihen 19 Varietete të Gazelës, Eja me Mua: Poezi të një Udhëtimi, Karburant (poezi) dhe Habibi (roman për të rinj që ka fituar 6 çmime të Librit më të Mirë). Bijë e një babai palestinez dhe e një nëne amerikane, ajo ka redaktuar gjashtë antologji poetike për lexues rinj që kanë fituar çmime, përfshirë I Njëjti Qiell, Drurët Janë më të Vjetër se Ju, Hapësira Midis Gjurmëve Tona: Poezi dhe Vizatime nga Lindja e Mesme, Ç'Ke Humbur? dhe Kripë në Oqean. Ajo ka punuar si shkrimtare vizitore në shkollë e bashkësi për 28 vjet dhe ka bërë udhëtime të shumta jashtë vendit në bazë të programit Arts America të ish-Agjencisë së Informacionit të Shteteve të Bashkuara. Ka fituar një bursë Gugenheim dhe një bursë Uitër Bajner të Bibliotekës së Kongresit dhe sot është anëtare e Këshillit Kombëtar të Fondacionit Kombëtar për Lëndët Shoqërore.



# Robert Pinski



U rrita në një qytet të vogël, ku njëri nga gjyshërit e mi kishte një bar të mirënjohur përtej Bashkisë së Qytetit në të cilin politikanë e policë mblihdeshin për të pirë. Kur isha dhjetë vjeç më kujtohet shefi i policisë së Long Brançit, një burrë që kishte qenë një nga punonjësit e gjyshit në vitet 1920, kur biznesi i alkoolit ishte i pa-

ligjshëm. Gjyshi tjetër lante dritaret e shumë dyqaneve në Long Branç, Nju Xhërsi. Im atë, syzabërës, ishte një atlet i njohur vendor, i votuar si Djali më i Pashëm i klasës në Shkollën e Mesme të Long Brançit, ku u njoh me nënën time kur ishin nxënës në atë shkollë në të cilën kanë mësuar edhe tezet, xhajallarët, kushërinjtë, vëllai, motra ime dhe unë.

Në një vend të tillë ka shumë histori. Historitë janë, si të thuash, në ajër – a i kishte ndodhur kjo babait tim apo dikujt tjetër për të cilin ai kishte dëgjuar; kishte ndodhur në brezin e tij apo të një tjetri? Duket sikur historitë janë të gjalla, kurse njerëzit enë të përkohshme, gjë që ngjan, si të thuash, me ornamentet që mbajnë të vdekurit. Plezhër Bei është një zonë e Long Brançit, afër rrugës së klasës së mesme të ulët në të cilën si im atë, edhe unë, kemi jetuar kur qemë fëmijë (shtëpitë i kemi në të njëjtin bllok):

## NË PLEZHËR BEI

*Në shelgjet përgjatë lumit në Plezhër Bei  
Një hutin këndon, kurrë dy herë një frazë.  
Këtu, nën pishat pak larg nga rruga  
Më 1927, Shefi i Policisë  
Dhe Znj. W. vranë veten të dy bashkë,  
Ulur në një roudstër. Shtylla të lashta, të forta  
Dhe copëra të nënujshme tullash ende me llaç  
Me forma si pjesë të një rebusi, mbulonjë truallin  
Ku dikur ndodheshin Hoteli dhe Teatri Prajs.  
Pikërisht këtu anijet lëshonin dy sinjale, që rojtari  
Të lëvizte urën rrotulluese. Ai përkulej mbi ingranazhet  
Si një manovruer në kabinën e mekanizmave  
Dhe ura rënkonte e rrotullohej në këmbën e mesit  
Për të lejuar anijet të ecnin. Në mes të verës,  
Dy ose tri vetura prisnin që armatesa e hekurt  
Të rrotullohej mënjanë, me një fëmijë që ndofta shikonte  
Emrat në pupat e tyre shkruar verdhë-e-zi mbi të bardhë,  
Sandpiper, Patsy Ann, Do Not Disturb,  
The Idler. Nëse qëllonte që një anije mbarthe uiski,  
Ura kërciste e mbyllej teksa anija kalonte  
Dhe hapej sërish, ngadalë, si një orë diellore,  
Përherë e ndalur përgjysmë, për skafin e Rojës Bregdetare.  
Shtrati i rrugës i tërë, por i hapur, si një ndërçelës,  
Dhe lumi që rridhte duke e gjetur udhën përmes këmbëve.  
Pa kënduar kurrë dy herë të njëjtën frazë, hutini mbush  
Mbrëmjen e lagësht të gushtit pranë mëngës së detit  
Me një muzikë të huazuar që ai e shkrin dhe e ndryshon.  
Pilivësat dhe flebotomët, zhabat në kallama, dy trupa  
Që nuk lëvizin në veturën e hapur në mes të pishave,  
Një cifël historie. Tenori i Hotelit të Prajsit,  
Me kostum klouni, shpalos në rrudhat pranë fytit  
dhe manshetave, dhimbjen e grumbulluar. Notat e larta  
Që rrinë si llapashitje drite mbi ujën e errët,  
Frazat mbyllëse të aries ndryshuan e u shuan.  
Dhe pas një çasti qetësie ovacionet e duartrokitjet  
Dëgjohen gjer te shtëpitë përtej lumit dhe  
Disa nga dëgjuësit qajnë si të qenë shkrirë*



Brenda muzikës. Kurrë e njëjta gjë. Në Berlin,  
 Vajza e një lordi anglez në dashuri me Adolf Hitlerin,  
 Me të cilin është njohur. Ajo është duke zënë  
 Apartamentin e një çifti të pasur dhe të moshuar  
 Izraelitësh. Ata kanë mbijetuar nga lufta  
 Për t'u vendosur këtu, në Bei. Zonja plakë jep mësimë  
 në piano, por e gjithë bota dridhet e hapet  
 nën këmbët e tyre, kur një vajzë dhe një nazist i lartë  
 Ekzaminojnë mobiljet, qelqurinat, pikturat,  
 Historinë elegante që ishte e tyre dhe që tani është  
 Pjesë e saj. Pak muaj më vonë, anglezët hyjnë në luftë  
 Dhe ajo vret veten në park, ajo, një vajzë mendjeprishur,  
 E klasës së lartë, me jetën që kalon  
 Në jetët e të tjerëve ose diku në një vend.  
 Kjo marrja e jetëve – Shefi dhe Znj. W.  
 U dhanë fund për të qëndruar bashkë si fantazma vendore.  
 Shkulmet e fundit të puthjeve, gryka e revokverit,  
 Copëra të një ngjarjeje që një fëmijë mund ta dëgjojë  
 Dhe ta mbajë mend përgjysmë. Zëra në kallama,  
 Një këngë nëpër shelgje. Nga përtej lumit, nota  
 Të dobëta muzike, dy herë të njëjtat fraza dhe sërish,  
 Duke bredhur e ndërtuar. Mbi urën e re të lartë  
 Vrulli i trafikut drejt shtëpisë nga pista e garave,  
 Dhe një anije duke uturirë poshtë harqeve, nga jashtë  
 E padiktuar përmes Plezhër Beit gjer në det të hapur.  
 Këtu njerëzit kanë qëndruar për të parë teatrin  
 Duke u djegur mbi ujë. Gjithë natën skafet e zjarrfikësve  
 Vazhduan lojën e currilave të ujit drejt e në flakë.  
 Në mëngjes, shtyllat dhe trarët ende duke nxjerrë tym.  
 Erë shkrumbi për javë të tëra dhe gërmadhat, tashmë,  
 Duke u zhytur sërish në ujë e lumit. Pasi vdisni,  
 Ju rri në flauri pranë tavanit, mbi trupin tuaj,  
 Dhe shikoni të përzishmit për një çast. Kalojnë ca ditë  
 Dhe lundroni mbi kokat e atyre që njihnit  
 Duke i parë mes muqësirës. Dhe teksa terri trashet  
 Çapiteni ngadalë duke gjetur rrugën për te lumi  
 Dhe shllapuriteni gjer përtej. Në anën tjetër,  
 Ajri i natës, shelgjet, aroma e lumit dhe një masë  
 Trupash të përgjumur gjatë gjithë bregut,  
 Një lloj këngëzimi që del nga kallamishtja  
 Ju thërret për të shkuar më larg drejt errësirës.  
 Ju shtrihen dhe përqafoni një trup. Gfymtyrët,  
 Të rënduara nga gjumi, zgjaten ethshëm dhe ju rrokin  
 Dhe ju bëni dashuri gjersa shpirti mbushet gjer në buzë  
 Dhe digjet i çliruar prej jush duke u gufuar e derdhur  
 Gjer tek ai trupi tjetër, dhe ju  
 E harroni jetën që kishit dhe filloni sërish  
 Tek i njëjti vah kalimi – mbase si një fëmijë që kalon  
 Përmes të njëjtit vend. Por kurrë dy herë njësoj.  
 Këtu, në dritën e ditës, hutini nëpër shelgje,  
 Kafeneja e re me taracë dhe sheshpushim,  
 Bretkosat në dyrzakë ku dikur qe ura rrotulluese –  
 Këtu ju mund të keni rrëshqitur përmes ujit  
 Kur keni qenë vetëm një prani, në Plezhër Bei.

Si e gjykoj unë mënyrën në të cilën shkalla historike e nazizmit duket e zhduket nga poezia? A mund të hedh poshtë stereotipin e amerikanëve si njerëz që jetojnë pa qenë në rezonancë me historinë, duke e mbushur të tashmen me një vetëkënaqësi fëminore, me një arrogancë prej mendjelehti, që nuk reflekton? Unë jam kujdesur që të jetoj brenda dhe jashtë së kaluarës duke përsiatuar për të, por kjo nuk është saktësisht mbrojtje: ç'është më johistorike se sentimentet e nostalgjisë?

Shpresoj se poezia ime është për humbjen, jo nostalgjinë; se tenori që këndon arien italiane sugjeron një dimension historik të humbjes, ashtu si shtyllat e shkatërruara të teatrit. Këtë mund ta bëjnë gjëra të vogla: në poezinë e madhe të Çeslav Milozhit «Këngë për Porcelanin», një poezi për periudhën fill pas Luftës së Dytë Botërore në Poloni, ku pati miliona të vrarë, ku çdo familje ishte në zi dhe Varshava në gërmadha, Milozhi shkruan:

*Nga të gjitha gjërat e thyera e të humbura  
 Porcelani më bën më shumë të vuaj.*

Më kujtohet se kjo poezi është fishkëllyer një herë në Berkli. Mendoj se personi që e bëri këtë gjest do të kishte dashur më mirë që Milozhi të thoshte se nga të gjitha gjërat e humbura e të thyera, çifutët e vdekur e shqetësonin më shumë.

Po kjo nuk ka nevojë të thuhet dhe asaj do t'i mungonte pikërisht dimensionin historik i porcelanit të thyer, produktit të Evropës së vjetër që e përfytyronte veten të qytetëruar, që i pikturonte barinjët në filxhanët e çajit dhe që e goditi, e theri dhe e copëtoi vetveten.

Unë i shtroj këto pyetje në poezinë time dhe evokoj një krahasim shumë të rreptë për të, pjesërisht në dritën e shqetësimit kombëtar në lidhje me një datë. Në javët e para pas 11 Shtatorit 2001, një lexues dashamirës i krijimtarisë sime më sugjeroi se ndonjë poet amerikan duhet të gjejë një emër për sulmet vetëvrasëse që i kthyen avionët 767 në armë të mbushura me njerëz duke i përplasur në Qendrën Botërore të Tregtisë e Pentagon. Por fill pas këtyre ngjarjeve u bë e qartë se atyre tashmë u ishte dhënë emri. Emri është data e caktuar nga një konsensus i frikshëm, përtej vullnetit të atyre që e shkruajnë, sikurse edhe përtej një dekreti zyrtar.

Kjo mund të jetë diçka e re për ne. Rrugët dhe sheshet e Evropës dhe ato të Amerikës Latine emërohen sipas datave, kurse tonat jo. Ka madje vende ku emri i një muaji si «Tetori» apo «Gushti» evokon një rrëfenjë të tërë të fatit publik, një grusht të thurur nga kataklizma dhe turpi, heroizmi dhe zemërimi.

Përveç 4 Korrikut, emërtime të tjera sipas datës nuk janë praktikuar në shkurtesat qytetare amerikane. Kalimet e përgjakura të Luftës sonë Civile quhen sipas këtyre emrave të vendeve: Antietam, Getisberg, Shiloh, Andersonvil. Luftërat e punëtorëve për të drejtat e tyre dhe ato për të drejt-

tat civile evokohen nga emrat e protagonistëve: Sako e Vanceti, Roza Parks, Çeni dhe Shverneri. Data 22 Nëntor si dhe simetria e saj numerike që mbahet mend lehtë, 11/22, ka njëfarë force, por rëndësia e kësaj dite, e cila më 1963 u duk se ishte humbje e shpresave të mëdha politike e kulturore, është bërë diçka si më personale apo më familjare, një shpalsje kyçe në ikonografinë tonë kombëtare, më fort një çështje simbolesh se realitetesh. Vetëm katër shifrat e vitit 1968, viti i vrasjeve, i çrregullimve dhe i një gare presidenciale që përcollti si tragjedinë, edhe farsën, mund të kenë forcën e qëndrueshme emocionale që ringjall kujtesën epike nga lënda thjesht lakonike e kalendarit. Në periudhën midis vitit 1776 dhe ditëve tona, viti 1968 vjen më afër statusit të një fjale si fjalët 1789 dhe 1848 [vite revolucionesh në Evropë]. «Pashka e Madhe 1916» e Jitsit nuk tingëllon si titull amerikan. A ka të ngjarë që ne në Shtetet e Bashkuara t'u shmangemi shkurtësive monumentale të datave e të viteve për shkak të një pëlqimi kombëtar intuitiv për të vagulltën, për parajsën pakohësore të nostalgjikës?

Unë nuk e pres me qejf një mundësi të tillë. Unë e mendoj veten si të kem pirë pak histori që nga fëmënia. Një nga kotësitë e mia të padukshme ka qenë të pasurit gjithmonë njëfarë ndjesie për të kaluarën, jam lindur me këtë ndjesi – edhe pse rudimentare dhe ëndërrtare që më vendoste, kur isha fëmijë, në një veturë nga ku shikoja rrotullimin e ngadaltë të urës rrotulluese, atë ndërprerje funksionale të rrugës lineare siç ndërpret poezia konceptimin linear të kohës.

Stërgjyshërit e mi kanë qenë imigrantë çifutë nga Evropa Lindore. Mbase kjo histori imigrantësh përfshin një dëshirë imanente për të fshirë datat dhe hollësitë. Si të egrit në veprat e Folknerit që aspironin të themelonin dinasti, imigrantët – mbase imigrantët çifutë në veçanti – nganjëherë i kthejnë shpinën së kaluarës.

Për shumë amerikanë, historia jonë më qendrore e moralizuar, tregimi ynë thuhet më epik i asaj çka në Rilindje quhej «histori e vërtetë» në kuptimin historik moralizues ose arsimues, është historia se si është e mundur që të bëhesh amerikan gjatë një brezi ose më pak se një brezi. Një pjesë jo e vogël e ndarjes racore në vendin tonë, ajo që ka të bëjë me kontrastin midis kësaj historie dhe historisë së skllëverve afrikanë, e ka mohuar atë proces për aq gjatë, sa që vetëm kohët e fundit dhe pas shumë tentativash fjala e ndarë me vijëz «afro-amerikan» arriti që ta çante rrugën në gjuhën tonë.

Për mua si fëmijë, historia e imigrantëve çifutë dhe e grupeve të tjera shkrihej me historinë e mrekullueshme të qytetit tonë. Le të bëhem për një çast ai që italianët e quajnë *campanilista*, një person që u tregon të ardhurve kabanoret apo objektet e tjera vendore.

Plazhin Long Branç në Nju Xhërsi e ka vizituar edhe Abraham Linkoln. Në Long Branç, bixhozçinjtë e famshëm të shekullit të 19-të sponsorizonin kompanitë zjarrfikëse që mbanin emrat e tyre, siç bënin për kolegjet njerëz të shquar më të qytetëruar. Në Long Branç, VIP-i sportiv

Dajëmond Xhim Bredi shoqëronte Lilian Rasëllin në shëtitje përgjatë oqeanit në muzg në një veturë elektrike të hershme, e cila e kishte kompartimentin prej kristali të pasagjerëve të ndriçuar, kurse vendin e shoferit të errët, në mënyrë që dashnorët truphedhur, të veshur me rroba ekstravagante, mund të shiheshin nga njerëzit si të ndodheshin në një vetrinë të lëvizshme supermarketi. Pas tyre ecnin tri makina të tjera rezervë, vetëm me shoferët, në rast se vetura kryesore prishej.

Në të njëjtën shëtitore presidenti Grant ngau ekipin e kuajve të tij të shpejtë. Për të tërhequr turmat e modës, në trotuarin me dërrasa të Long Brançit revista Harper's ngarkoi Uinslou Homerin, piktura e madhe «Long Branch, New Jersey» e të cilit varet në Muzeun e Arteve të Bukura në Boston. Kur presidenti Garfield u qëllua me armë në njërin nga qershorët e kaluar në një stacion treni në Uashington nga një i çmendur i politizuar me emrin Guito, ai ishte në rrugë e sipër për në Long Branç për pushime. Guitoja e kishte ndjekur deri në kishën e Long Brançit, sot e njohur si «Kisha e Gjashtë Presidentëve.» Pasi u qëllua, Garfieldi qëndroi për disa javë në Uashington, i torturuar nga vapa dhe nga mjekët që ende nuk e njihnin sepsisin dhe që ishin të etur për lavdinë se kishin vënë gishtat në plagët e Garfieldit në kërkim që një plumbi që mungonte. Kënetat e Potomakut bëhen malarike dhe për të shmangur vapën e pamëshirshme, presidentin e transportuan me gjithë dyshek duke e kaluar më kot përpara çarçafëve prej musline të lagur me ujë të akullt që vareshin në Shtëpinë e Bardhë, deri te një vagon treni të posaçëm të mbushur me akull dhe me balestra të posaçme. Vagoni mbërriti në bregun e Long Brançit, ku njerëzit punuan gjithë natën për të ndërtuar një degëzim hekurudhe nga stacioni i Elberonit, në një vilë bregdeti. Nga hotelet, njerëzit u sillnin punëtorëve kafe dhe senduicë dhe degëzimi mbaroi në kohën kur Garfieldi do të transportohej në po atë dyshek nga vagoni te vila, ku kaloi javët e fundit i ngushëlluar nga flladet e Atlantikut.

Mund të vazhdoja më tej. Të tilla janë fijet e historisë provinciale për një *campanilista* që i njeh mirë. Periudha e dytë e lavdishme e qytetit zë fill në dekadat e para në shekullit të 20-të, kur ai ishte një vend i begatë dhe azil për familjet e klasës së mesme nga Nju Jorku dhe Filadelfia. Varkat nga Nju Jorku sillnin pasagjerë në Hotelin e Prajsit për netët teatrore dhe darkat bregdetare. Një numër i madh nga këta vizitorë ishin çifutë ose italianë si dhe tregtarë lokalë. Vendi karakterizohej nga njëfarë vulgariteti për shkak të pistës së garave që përmenda te «Plezhër Bei».

Në fëmëninë time qyteti kishte rënë nga shkëlqimi i shekullit të 19-të dhe begatia e viteve 1920 në gjendjen e viteve '50 duke u kënaqur me trotuarin me dërrasa që po prishej, baret e midhjeve, biçikletat e fëmijëve, rrotat e fatit, sallonet e minibildardove dhe tezgat e karamelëve. Në pjesën më të madhe të vitit, vendet e pushimeve ve-

rore janë të trishtuara dhe një vend pushimi që i ka lënë pas ditët e tij më të mira është dyfish i trishtuar. «Qyteti nuk është më ai që ka qenë.» Unë u rrita duke e dëgjuar shpesh këtë fjali të shqiptuar me përvuajtje, këtë psherëtimë korale, dhe një tipar i squllur, por i prekshëm, në inteligjencën time më pengonte të dalloja qartë rënien e biznesit nga vdekja e presidentëve.

Bari i gjyshit tim, Pinski, me emrin Taverna Broduei, ndodhej në të njëjtin bllok me hotelin Garfield-Grant. Reputacioni qytetar dhe historik i presidentëve të vdekur, emrat e të cilëve vazhdon t'i mbajë hoteli ende elegant,



shkrihej në mendjen time me emrin «Broduei», një emër që dukej sikur vraponte nga Manhatani në derën e tavernës që kundërmonte nga era e pijeve alkoolike. Në vitet e begata '20, përpara hapjes së barit, familja ime ishte marrë me biznesin e kontrabandës dhe të shpërndarjes së pijeve alkoolike në mënyrë të paligjshme. Rrëfenjat e ditëve të gangsterëve ndërthureshin me historitë kur Shtëpia e Bardhë Verore ndodhej në qytetin tonë.

Kjo e kaluar e vagullt, e mjegullt dhe e papërcaktuar duket si e kundërt me datat. Por edhe datat, tekefundit, mund të sentimentalizohen bujshëm, të shfrytëzohen politikisht, të shtrembërohen duke i stërholluar e sheqerosur ose të përqendrohen në armë vdekjeprurëse. Rrëfenja për dashnorët provincialë Paolo e Françeska në automobilin e tyre veror, rrëfenja për çiftin e moshuar që mbijetoi, emrat e anijeve, aria, teatri mbi ujë – të gjitha janë historike, të gjitha vijnë nga errësira ose nga burimet e ndritshme për-pjetë lumit deri tek ne dhe të gjitha janë të rrënjosura edhe në dëshirat e kënaqësitë tona, edhe në atë çka Uiliam Shekspiri e quan «nata pa datë e vdekjes.» ■

**R**obert Pinski jep mësim në programin pasuniversitar të krijimitarisë letrare në Universitetin e Bostonit. Është redaktor i poezisë në revistën Slate të Internetit dhe reciton poezi si kontribues në televizionin publik The Newshour with Jim Lehrer.

*Libri i tij më i fundit me poezi, Shiu i Xhërsit, është botuar nga Farrar, Straus & Giroux në 2000. Një vëllim tjetër me poezi, Rrota e Përfytyruar: Poezi të Reja dhe të Zgjedhura 1966–1996, ishte caktuar për çmimin Pulicer dhe ka marrë çmimin Lenore Marshall dhe çmimin e Librit Ambasador të Unionit të Anglishtfolësve. Në çmimet e tij të tjera përfshihen çmimi Shelley Memorial, çmimi William Carlos Williams, çmimi i Librit Los Angeles Times dhe çmimi Howard Morton Landon i Përkthimeve për përkthimin më të shitur, Ferri i Dantes. Është anëtar i Akademisë Amerikane të Arteve dhe Shkencave dhe i Akademisë së Arteve dhe Letrave.*

*Pinski është bashkëredaktor i librit Poezi të Zgjedhura Amerikane dhe i librit më të fundit Poezi për Lexim, që të dy antologji që dolën nga Projekti i tij i Poezive të Zgjedhura. Ndër librat e tij me prozë bëjnë pjesë Tingujt e Poezisë: Udhëzues i Shkurtër, dhe libri i kohëve të fundit Demokracia, Kultura dhe Zëri i Poezisë.*

*Gjatë mandatit të tij si poet laureat i Shteteve të Bashkuara në periudhën 1997–2000, Pinski ka krijuar Projektin e Poezive të Zgjedhura për të dokumentuar, nxitur e ngritur lart vendin e poezisë në kulturën amerikane. Përveç antologjive, projekti ka prodhuar 50 video-segmente që tregojnë amerikanët që lexojnë e flasin për poezitë që duan si dhe një uebsajt në [www.favoritepoem.org](http://www.favoritepoem.org) që jep videot dhe përmban një forum për mësuesit dhe studentët.*

*Jeton në Kembrixh, Masaçusets, me të shoqen, Dr. Ellen Pinski.*



**OFFICE OF INTERNATIONAL INFORMATION PROGRAMS  
U.S. DEPARTMENT OF STATE**

<http://usinfo.state.gov>



*Shkrimtarët mbi Amerikën*